

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2019



40

PRISHTINË
2020

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

VJETARI 2019

40



**PRISHTINË
2020**

**KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

YEAR-BOOK 2019

40

**Editor: Correspondent member Myzafere Limani,
Scientific Secretary**



**PRISHTINA
2020**

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

VJETARI 2019

40

**Redaktor: Anëtare korrespondente Myzafer Limani,
Sekretare shkencore**



**PRISHTINË
2020**


Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

PËRBËRJA E AKADEMISË	1
KRYESIA	1
ANËTARËT E AKADEMISË	3
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	3
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	3
SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	3
SEKSIONI I ARTEVE	4
ANËTARËT IN MEMORIAM	4
ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS	4
ANËTARËT E JASHTËM	4
ANËTARË NDERI	5
SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE DHE TEKNIKE	5
RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2018	7
KUVENDI	9
KRYESIA	15
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	36
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	41
SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	43
SEKSIONI I ARTEVE	44
SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE	45
RAPORTI I PERFORMANCËS FINANCIARE PËR VITIN 2018	61
PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2019	59
PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS	83
KRONIKA E VITIT 2018	95

PËRBËRJA E AKADEMISË

KRYESIA



Akademik
Nexhat Daci
Kryetar
(1.1.2018 - 26.7.2019)




Akademik
Mehmet Kraja
Kryetar
(3.10.2019 – vazhdim)



Akademik
Jusuf Bajraktari
Nënkryetar



Anëtare
korrespondente
**Justina
Shiroka Pula**
*Sekretare e
Seksionit të
Shkencave
Shoqërore*



Anëtare
korrespondente
Myzafere Limani
*Sekretare
shkencore*



Anëtar
korrespondent
**Fetah
Podvorica**
*Sekretar i Seksionit
të Shkencave të
Natyrës*



Akademik
Eqrem Basha
*Sekretar i
Seksionit të
Gjuhësisë dhe
të Letërsisë*



Anëtar
korrespondent
Luan Mulliqi
*Sekretar i
Seksionit të
Arteve*

ANËTARËT E AKADEMISË

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):
Ali Aliu (1934), i zgjedhur më 2000,
Eqrem Basha (1948), i zgjedhur më
2004,
Idriz Ajeti (1917), i zgjedhur më 1975,
Mehmet Kraja (1952), i zgjedhur më
2008,
Rexhep Ismajli (1947), i zgjedhur më
1996,
Rexhep Qosja (1936), i zgjedhur më
1975,
Sabri Hamiti (1950), i zgjedhur më
2008.
Zejnullah Rrahmani (1952), i zgjedhur
më 2016.

b) Anëtarët korrespondentë:
Bardh Rugova (1974) i zgjedhur më
2016,
Kujtim Shala (1974), i zgjedhur më
2016,
Mehmet Halimi (1937), i zgjedhur më
2012.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):
Anton K. Berishaj (1954), i zgjedhur më
2016,
Ekrem Murtezai (1931), i zgjedhur më
2000,
Hivzi Islami (1946), i zgjedhur më 2000,
Isa Mustafa (1951), i zgjedhur më 2012,
Jusuf Bajraktari (1948), i zgjedhur më
2016.

b) Anëtarët korrespondentë:
Arsim Bajrami (1960), i zgjedhur më
2012,
Edi Shukriu (1950), e zgjedhur më 2012,
Frashër Demaj (1973), i zgjedhur më
2016,
Gjyljeta Mushkolaj (1963), e zgjedhur
më 2016,
Justina Shiroka Pula (1953), e zgjedhur
më 2016,
Muhamedin Kullashi (1949), i zgjedhur
më 2016.

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):
Fejzullah Krasniqi (1953), i zgjedhur më
2012,
Feriz Krasniqi (1931), i zgjedhur më
2000,
Isuf Krasniqi (1948), i zgjedhur më
2012,
Minir Dushi (1929), i zgjedhur më 1979,
Nexhat Daci (1944), i zgjedhur më
1996.

b) Anëtarët korrespondentë:
Arsim Morina (1956), i zgjedhur më
2012,
Fetah Podvorica (1968), i zgjedhur më
2016,
Myzafer Limani (1954), e zgjedhur më
2016,
Qamil Haxhibeqiri (1949), i zgjedhur më
2012,
Salih Gashi (1944), i zgjedhur më 2012.

SEKSIONI I ARTEVE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Rauf Dhomi (1945), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Ferri (1937), i zgjedhur më
2000,
Tahir Emra (1938), i zgjedhur më 2008,
Zeqirja Ballata (1943), i zgjedhur më
2000.

b) Anëtarët korrespondentë:

Luan Mulliqi (1953), i zgjedhur më
2012,
Xhevdet Xhafa (1934), i zgjedhur më
2012.

ANËTARËT IN MEMORIAM

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Agim Çavdarbasha,
Ali Hadri,
Ali Podrimja,
Besim Bokshi,
Dervish Rozhaja,
Engjëll Berisha,
Esat Stavileci,
Enver Gjerqeku,
Esad Mekuli,
Fehmi Agani,
Gazmend Zajmi,
Jashar Rexhepagiq,
Latif Susuri,
Mark Krasniqi,
Muharrem Berisha,
Musa Haxhiu,
Muslim Mulliqi,
Osman Imami,
Pajazit Nushi,
Remzi Bakalli,
Syrja Popovci,
Vladeta Vukoviq,
Vukasin Filipoviq.

b) Anëtarët korrespondentë:

Anton Pashku,
Eshref Ademaj,
Hajredin Hoxha,
Ibrahim Rugova,
Ruzhdi Pllana.

ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Sinan Hasani (letërsi), Serbi, i zgjedhur
më 1986.

b) Anëtarët korrespondentë:

Zef Mirdita (histori), Kroaci, i zgjedhur
më 1991.

ANËTARËT E JASHTËM

Aleksandar Stipčević (histori), Kroaci, i
zgjedhur më 1983,
Ismail Kadare (letërsi), Shqipëri, i
zgjedhur më 1991,
Wilfried Fiedler (gjuhësi), Gjermani, i
zgjedhur më 1991,
Eric Hamp (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur
më 1991,
Shaban Demiraj (gjuhësi), Shqipëri, i
zgjedhur më 1996,
Gunnar Svane (gjuhësi), Danimarkë, i
zgjedhur më 1996,
Kristian Gyt (histori e kulturës), Francë,
i zgjedhur më 1996,
Gjelosh Gjokaj (art figurativ), Gjermani,
i zgjedhur më 1996,
Leonard Newmark (gjuhësi), SHBA, i
zgjedhur më 2000,
Robert Elsie (letërsi), Kanada, i zgjedhur
më 2000,

Michel Roux (gjeografi, gjeopolitikë), Francë, i zgjedhur më 2000,
 Muhamedin Kullashi (filozofi), Francë, i zgjedhur më 2000,
 Tomë Berisha (elektroteknikë), Kroaci, i zgjedhur më 2000,
 Noel Malcolm (histori), Angli, i zgjedhur më 2004,
 Victor Friedman (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2004,
 Emin Riza (arkitekturë), Shqipëri, i zgjedhur më 2008,
 Françesko Altimari (gjuhësi), Itali, i zgjedhur më 2008,
 Muhamet Mufaku (histori), Jordan, i zgjedhur më 2008,
 Alajdin Abazi (elektroteknikë), Maqedoni, i zgjedhur më 2012,
 Kolec Topalli (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2012,
 Oliver Schmit (histori), Austri, i zgjedhur më 2012,
 Radoslav Katičić (gjuhësi), Kroaci, i zgjedhur më 2012,
 Bahri Beci (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2016,
 Matteo Mandala (gjuhësi), Itali, i zgjedhur më 2016,
 Mentor Petrela (mjekësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2016,
 Kristaq Prifti (histori), Shqipëri, i zgjedhur më 2016.

ANËTARË NDERI

Ferid Murati, nobelist, jeton në SHBA, i zgjedhur më 2000.

SHËRBI MI ADMINISTRATIV, PROFESIONAL E TEKNIK

Lendita Juniku Pula, sekretare e Akademisë,
 Ali Caka, drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale dhe Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve,
 Vjollca Hykolli, drejtoreshë e Departamentit për Buxhet dhe Financa,
 Hilmi Zogjani, drejtor i Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivit,
 Furtuna Naka, udhëheqëse e prokurimit,
 Xhemshit Brajshori, zyrtar i lartë për marrëdhënie ndërkombëtare,
 Hasime Maliqi, zyrtare certifikuese,
 Lirijeta Bunjaku, zyrtare e lartë për buxhet dhe financa,
 Lidije Kelmendi, zyrtare e librarisë,
 Rejhane Ajeti Islami, zyrtare e lartë për bibliografi dhe hulumtim shkencor
 Bedri Pllana, zyrtar bibliotekar,
 Taulant Veseli, administrator i lartë i sistemeve të TIK-ut,
 Gerta Çuna, zyrtare e TI-së për përkrahje,
 Burim Rexhepi, zyrtar i lartë i redaktimit teknik,
 Nitë Krasniqi, zyrtare e logjistikës
 Alban Bytyçi, vozitës-korrier,
 Valbona Olluri, zyrtare teknike.

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2019



KUVENDI

Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe i Arteve të Kosovës në vitin 2019 ka mbajtur katër mbledhje. Mbledhja e parë më 21 shkurt (XCVI), mbledhja e dytë më 6 qershor (XCVII), mbledhja e tretë (XCVIII) më 27 qershor dhe mbledhja e katërt (XCIX) më 3 tetor.

1. Në mbledhjen e parë të vitit 2019 (XCVI), përveç miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, Kuvendi shqyrtoi edhe pikat: Miratimi i raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2018 dhe miratimi i raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2018.

Mbledhjen e hapi kryetari Daci.

Kuvendi shqyrtoi raportin e punës së ASHAK-ut për vitin 2018, me radhë sipas seksioneve. Kryetari Daci tha se materialet janë ndarë me kohë dhe tani do ta shqyrtojmë raportin e punës sipas radhës duke filluar nga Kuvendi, Kryesia, seksionet dhe shërbimi profesional, administrativ e teknik.

Gjatë shqyrtimit të raportit të punës të Kryesisë së ASHAK-ut diskutuan S. Hamiti, M. Dushi, H. Islami, N. Daci, M. Kraja, Z. Ballata.

S.Hamiti paraqiti disa vërejtje për përmbajtjen e raportit, duke thënë se duhet t'i jepet rëndësi formulimeve, meqë raporti është dokument i punës njëvjeçare, botohet në Vjetari dhe propozoi që në perspektivë duhet të

ndryshohet përmbajtja e tij. Ai po ashtu tha se promovimi i të gjitha botimeve të Akademisë duhet të pasqyrohet në Kronikën vjetore të Akademisë.

M. Dushi diskutoi për projektet e Akademisë, dy prej tyre të Seksionit të Shkencave të Natyrës: "Kadastrri i ndotësve të ujërave efluentë në recipientë dhe trajtimi i tyre (me biosorbentë dhe osmozë reverse)" dhe "Parametrat e jashtëm projektues të klimës për disa qytete të Kosovës", si dhe një i Seksionit të Shkencave Shoqërore "Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës (Tablloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale)" - Qendrat urbane.

Pas fjalës së M. Dushit, kryetari Daci në fjalën e tij tha se diskutimi i M. Dushit nuk ka të bëjë me rendin e ditës dhe nuk do të duhej të përfshihej në procesverbal, por duke qenë se kemi konsideratë ndaj akademik Dushit, kësaj radhe e dëgjuam diskutimin e tij, po herëve të tjera do t'i përmbahemi vetëm rendit të ditës. Ai më pas tha se propozimet për projekte i kanë kaluar të gjitha procedurat e rregullta nëpër seksione, Kryesi dhe Kuvend dhe janë miratuar në pajtim me aktet normative të ASHAK-ut.

M. Dushi më pas u paraqit edhe një herë për diskutim dhe tha se ky është Kuvend pune dhe këtu diskutohet ecuria e punës së Akademisë e këtu hyjnë edhe projektet për të cilat u diskutua.

Në vazhdim diskutoi H. Islami, i cili duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve, paraqiti sqarimet e detajuara për projektin: “Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës (Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale)” - Qendrat urbane, i cili i ka kaluar të gjitha procedurat e rregullta të miratimit nëpër instancat e Akademisë.

Më pas filloi shqyrtimi i raportit të punës së seksioneve. M. Kraja propozoi që në të ardhmen raporti i punës së ASHAK-ut të diskutohet fillimisht nëpër seksione e më pas në Kryesi, sepse kur seksionet e kanë raportin e përgjithshëm e kanë të mundur të bëjnë vërejtje dhe sugjerime dhe të eliminohen paqartësitë para se raporti të paraqitet në Kuvend. Ai më pas paraqiti disa vërejtje për raportin e punës së Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Seksionin e Arteve. Pas diskutimit të M. Krajës, J.Pula dhe L. Mulliqi thanë se pajtohen me vërejtjet dhe se do ta plotësojnë raportin, të cilin do t’ia dërgojnë Sekretares së Akademisë.

Për raportin e punës diskutoi edhe Z. Ballata, i cili propozoi që pikat e propozuara duhet të precizohen dhe të realizohen sipas planit.

Raporti i punës së ASHAK-ut për vitin 2018 u miratua me plotësimet që u propozuan. Raporti është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe do të botohet në Vjetari 2018.

Më pas u shqyrtua raporti financiar i Akademisë për vitin 2018.

M. Kraja në diskutimin e tij tha se raporti financiar si i tillë është vështirë të diskutohet, meqë nuk ka parametra krahasues, kjo për arsye se planifikimi i buxhetit nuk ka kaluar nëpër seksione. Ai propozoi që në të ardhmen planifikimi i buxhetit të kalojë nëpër seksione e jo vetëm në Kryesi, sepse kur seksionet marrin pjesë në planifikimin e buxhetit mund të caktohen më mirë prioritetet. Me propozimin u pajtua edhe kryetari Daci, i cili njëherësh njoftoi se Kryesia ka vendosur që tani e tutje edhe propozimet për Programin e punës për vitin vijues të shoqërohen me vlera financiare. L. Mulliqi në diskutimin e tij tha se pajtohet me propozimin e M. Krajës. Ai tha se duhet të bëhet një parallogari nga të gjitha seksionet, sepse që nga fillimi i vitit sekretarja shkencore ka kërkuar nga sekretarët e seksioneve shënimet për të filluar procedurat e tenderimit për botimin e librave dhe asnjëri nuk i ka paraqitur shënimet e plota. Edhe vitin që shkoi ka qenë kërkesa që pikat e Programit të punës të shoqërohen me vlera financiare, por kjo kërkesë nuk është përmbushur në tërësi dhe nëse vazhdohet në këtë formë nuk mund të kemi planifikim të mirë të buxhetit dhe nuk mund të kemi edhe realizim të mirë të aktiviteteve.

Pas diskutimeve, Kuvendi miratoi raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2018, i cili është pjesë përbërëse e këtij

procesverbali dhe do të botohet në Vjetari 2018.

2. Në mbledhjen e dytë të Kuvendit për vitin 2019 (XCVII) u shqyrtuan këto pika të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCVI të Kuvendit të Akademisë; caktimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë; votimi për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë dhe shpallja e rezultatit të votimit dhe çështje vijuese.

Kryetari Daci para miratimit të rendit të ditës kërkoi nga L. Pula të paraqesë shënimet për prezencën e anëtarëve të Akademisë. L. Pula e njoftoi Kuvendin se në sallë janë të pranishëm 34 anëtarë të Akademisë nga 37 sa janë gjithsej. Akademikët Isa Mustafa dhe Zeqirja Ballata mungojnë dhe për këtë kanë njoftuar paraprakisht.

Për akademik R. Qosjen, në bazë të Statutit të Akademisë, neni 29, paragrafi 14, ajo tha se është vendosur në mbledhjet paraprake të mos përfshihet në kuorum, ndërsa për akademikët I. Mustafa dhe Z. Ballata i mbetet Kuvendit të vendosë. Nëse nuk vendoset ndryshe kuorumi mbetet 19. Pra 19 vota duhet t'i fitojë kandidati për t'u zgjedhur në pozitën e kryetarit të Akademisë.

Kuvendi konstatoi që kuorumi mbetet 19.

Para miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, M. Dushi kërkoi që procesverbali të shtyhet për miratim

në një mbledhje të radhës. Ai tha se për procesverbalin ka mjaft për të diskutuar dhe meqë kjo mbledhje është zgjedhore të mos zgjatet me diskutime të tjera.

Kryetari Daci kërkoi qëndrimin e Kuvendit. Diskutuan S. Hamiti, Z. Rrahmani H. Islami dhe pas diskutimeve ai konstatoi që rendi i ditës i miratuar në fillim të mbledhjes mbetet i njëjtë, ashtu siç është paraqitur në materialet e mbledhjes, pa ndryshime, ndërsa M. Dushi për çështje pune mund të diskutojë në një mbledhje tjetër.

Procesverbali i mbledhjes XCVI i Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Më pas Kryetari Daci propozoi Feriz Krasniqin, kryetar dhe Eqrem Bashën e Luan Mulliqin, anëtarë të Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë.

Propozimi u miratua njëzëri nga Kuvendi.

Para fillimit të procesit të votimit, L. Pula me kërkesë të kryetarit Daci e njoftoi Kuvendin se sipas Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë në votimin e parë votohet për të dy kandidatët.

Nëse në votimin e parë asnjëri nga kandidatët nuk e fiton numrin e nevojshëm të votave, votimi përsëritet për kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave apo për kandidatët që kanë numër të njëjtë të votave.

Më pas u shpërndanë fletëvotimet.

Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë votuan 34 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 26 fletëvotime të vlefshme dhe 8 fletëvotime të pavlefshme.

1. Akademik Anton K. Berishaj mori 14 vota,
2. Akademik Mehmet Kraja mori 12 vota.

Pas votimit të parë kryetari Daci njoftoi se votimi duhet të përsëritet edhe një herë. Para nisjes së votimit të dytë, diskutuan A. Aliu dhe L. Mulliqi. A. Aliu propozoi që para se të shkohet në votimin e dytë të hapet një debat i diskutimit për pasqyrën dhe mënyrën e votimit, rezultatet dhe për kandidatët, ndërsa L. Mulliqi në fjalën e tij tha se në votimin e dytë është mirë të votohet, të mos ketë vota të pavlefshme dhe të ketë rezultat pozitiv.

Kryetari Daci tha se e vlerëson propozimin e A. Aliut, por procesi ka filluar dhe nuk mund të pranohen diskutimet. Diskutoi edhe R. Ismajli, i cili tha se në raste të tilla nuk mund të ketë diskutime, procesi ka filluar dhe le të vazhdojnë procedurat.

Pas diskutimeve u ndanë fletëvotimet për votimin e dytë.

Pas votimit me vota të fshehta,

Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë votuan 34 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 28 fletëvotime të vlefshme dhe 6 fletëvotime të pavlefshme.

1. Akademik Anton K. Berishaj mori 14 vota,
2. Akademik Mehmet Kraja mori 14 vota.

Pas shpalljes së rezultatit të votimit kryetari Daci tha se zgjedhjet nuk patën sukses dhe tani do të vazhdojmë me procedurat ligjore.

Ai më pas kërkoi nga L. Pula sqarimet ligjore. L. Pula e njoftoi Kuvendin se në bazë të akteve normative të ASHAK-ut, zgjedhja e kryetarit të Akademisë konsiderohet e dështuar. Tani i mbetet Kryesisë që brenda javës që vjen të marrë vendim për veprimet e radhës. Seanca zgjedhore e radhës duhet të thirret gjithnjë së paku 30 ditë përpara.

Në fund diskutoi H. Islami. Ai tha se Kuvendi nuk rezultoi pozitivisht, por procesi ishte demokratik, gjëra të tilla ndodhin dhe janë normale. Ai tha se Akademia e ka Kryesinë legjitime dhe puna nuk ndalet. Sipas akteve normative të ASHAK-ut, kryetari aktual më 26 korrik i ndërpritet ushtrimi i funksionit udhëheqës dhe atë pas datës 26 korrik e deri në zgjedhjen e kryetarit e zëvendëson nënkryetari i Akademisë.

3. Në mbledhjen e tretë për vitin 2019 (XCVIII) Kuvendi, pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, shqyrtoi Programin e punës së Akademisë për vitin 2020.

Kryetari Daci në fjalën e tij tha se Programi i punës u është ndarë me kohë të gjithë anëtarëve të Akademisë bashkë me materialet e mbledhjes dhe tani jemi këtu për ta shqyrtuar dhe miratuar atë.

Ai më pas tha se gjatë shqyrtimit të Programit të punës me radhë, sipas seksioneve, sekretarët e seksioneve janë të lirë të japin sqarime nëse e konsiderojnë të nevojshme edhe pse, siç tha ai, secili seksion e ka shqyrtuar dhe miratuar Programin e punës së tij në mbledhjet e rregullta.

Kuvendi njëzëri e miratoi Programin e punës së Akademisë për vitin 2020, i cili i bashkëlidhet këtij procesverbal dhe do të botohet në Vjetari 2019.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës kryetari Daci, pasi mori konfirmimin nga Kuvendi se nuk ka asgjë për të diskutuar e shpalli të mbyllur me sukses mbledhjen e Kuvendit.

Pas fjalës së kryetarit, fjalën e mori M. Dushi, i cili tha se do të diskutojë për procesverbalin e mbledhjes XCVI dhe e filloi diskutimin. Me këtë rast reagues H. Islami, A. Aliu, R. Ismajli, J. Bajraktari, të cilët thanë se procesverbalin e mbledhjes XCVI është miratuar unanimisht nga Kuvendi, sipas rregullit

në mbledhjen XCVII dhe kjo çështje konsiderohet e mbyllur.

Më pas kryetari Daci tha se kjo mbledhje filloi sipas rregullit, rendi i ditës u miratua unanimisht dhe në kuadër të pikës së fundit - Çështje vijuese, Kuvendi u deklarua unanimisht se nuk ka asgjë për të diskutuar, prandaj mbledhja konsiderohet e përfunduar.

4. Mbledhjen e katërt të Kuvendit të Akademisë (XCIX) e hapi nënkryetari akademik Jusuf Bajraktari, i cili në bazë të shënimeve që u morën konstatoi se në sallë janë të pranishëm 33 anëtarë të Akademisë. Ai njoftoi se përveç akademik Rexhep Qosjes, i cili nuk përfshihet në kuorum, mungojnë edhe: akademik Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrespondente Edi Shukriu dhe Myzafer Limani dhe se të tretë kanë njoftuar me kohë se nuk mund të jenë prezentë sot.

Ai propozoi që Kuvendi të marrë vendim për mospërfshirjen në kuorum të anëtarëve të lartpërmendur dhe kërkoi nga sekretarja e Akademisë të paraqesë bazën ligjore.

L. Pula e njoftoi Kuvendin se Statuti i Akademisë, neni 29, paragrafi 14, përcakton: "Kuvendi në mbledhjen përkatëse mund të vendosë që në kuorum të mos përfshihen anëtarët të cilët për shkak të sëmundjes së gjatë ose për ndonjë arsye tjetër janë të penguar të marrin pjesë në punën e Akademisë".

Bazuar në Statutin e Akademisë, J. Bajraktari më pas propozoi që

akademik Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrespondente Edi Shukriu e Myzafere Limani të mos përfshihen në kuorum.

Propozimi u miratua nga Kuvendi.

Ai para fillimit të shqyrtimit të pikave të rendit të ditës kërkoi edhe një herë nga sekretarja e Akademisë sqarimet përkatëse.

L. Pula tha se pas vendimit të Kuvendit që në këtë mbledhje të mos përfshihen në kuorum katër anëtarë të Akademisë, konstatohet se kuorumi për sot është 17, pra për kryetar të Akademisë konsiderohet i zgjedhur kandidati që fiton 17 vota.

Nëse për funksionin e caktuar asnjëri nga kandidatët nuk fiton mbi gjysmën e numrit të votave (17), votimi përsëritet për kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave, ose për kandidatët që kanë numër të njëjtë të votave.

Më pas Kuvendi miratoi rendin e ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCVIII të Kuvendit të Akademisë; caktimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë; votimi për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë dhe shpallja e rezultatit të votimit dhe çështje vijuese.

Procesverbali i mbledhjes XCVIII i Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje. Pas miratimit të procesverbalit M. Dushi e kërkoi fjalën, por nënkryetari tha se rendi i ditës dhe procesverbali u miratuan me shumicën e votave të Kuvendit dhe tani do t'i

përmbahemi rendit të ditës, meqë kjo seancë ka karakter jo vetëm zgjedhor, por edhe solemn.

Kuvendi njëzëri caktoi Komisionin e zgjedhjeve me këtë përbërje: Feriz Krasniqi, Justina Pula dhe Luan Mulliqi.

Më pas u ndanë fletëvotimet.

Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë votuan 33 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 31 fletëvotime të vlefshme dhe 2 fletëvotime të pavlefshme.

1. Akademik Isuf Krasniqi mori 8 vota;
2. Akademik Mehmet Kraja mori 23 vota.

Akademik Mehmet Kraja u zgjodh kryetar i Akademisë.

Kryetari i zgjedhur e fillon mandatin menjëherë dhe e ushtron atë deri në zgjedhjet për Kryesinë e re, deri në fund të vitit 2021.

Pas përfundimit të procesit zgjedhor nënkryetari Bajraktari e uroi akademik Krajën për zgjedhjen e tij dhe e ftoi për një fjalë rasti.

Akademik Kraja falënderoi të gjithë për besimin e dhënë dhe tha se do të bëjë përpjekje të kryejë me sukses detyrën që iu besua.

KRYESIA

Kryesia e Akademisë gjatë vitit 2019 ka mbajtur 15 mbledhje, në të cilat është marrë me shqyrtimin e çështjeve, duke u bazuar në kompetencat e parapara me Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera normative të Akademisë.

1. Kryesia në mbledhjen e parë të vitit 2019, sipas rendit mbledhja XIV, mbajtur më 6 shkurt, pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse shqyrtoi Raportin e punës dhe Raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2018. Kryetari Daci tha se në Raportin e punës është përmbledhur puna njëvjeçare e të gjitha seksioneve dhe Shërbimit profesional, administrativ e teknik të Akademisë dhe si i tillë është mjaft voluminoz. Sa i përket Raportit financiar, ai tha se është i plotë dhe transparent.

Raporti i punës dhe Raporti financiar i ASHAK-ut për vitin 2019 u miratua njëzëri dhe u tha se do t'i dërgohen Kuvendit të Akademisë për miratim përfundimtar.

Raportet janë pjesë përbërëse të procesverbalit.

Në vazhdim të kësaj mbledhjeje J. Pula e njoftoi Kryesinë se Seksioni i Shkencave Shoqërore në mbledhje të rregullt ka propozuar që Akademia të prononcohet për gjendjen aktuale në Kosovë, duke marrë parasysh zhvillimet e fundit politike. J. Bajraktari sqaroi se Seksioni i Shkencave Shoqërore e ka

përgatitur një draft të prononcimit të cilin ua ndau të gjithëve.

Kryetari Daci në fjalën e tij tha se e përkrah këtë ide. Ai propozoi që anëtarët e Kryesisë ta shqyrtojnë draftin e prononcimit dhe deri nesër gjatë orarit të punës, përmes Sekretares së Akademisë të njoftohet sekretarja e Seksionit të SHSH-së. Nëse nuk ka kundërshtime prononcimi të publikohet.

Kryesia vendosi të thërrasë mbledhjen XCVI të Kuvendit të Akademisë më 21 shkurt, në orën 11:00 dhe e miratoi rendin e ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCV të Kuvendit të Akademisë; miratimi i Raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2018; miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2018; çështje vijuese.

Në kuadër të pikës 6 të kësaj mbledhjeje, Kryesia shqyrtoi raportin vjetor të punës (janar-dhjetor 2018) të projektit “Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës (Tablloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale)” - Qendrat urbane, faza e dytë. U tha se raporti është shqyrtuar dhe është miratuar fillimisht nga SSHSH. Kryesia e miratoi raportin në fjalë dhe mori vendimi për pagimin e paushallëve për personat e angazhuar në projekt.

Në vazhdim u shqyrtua propozimi i Seksionit të Shkencave Shoqërore për organizimin e Konferencës shkencore “Ndërhyrja e NATO-s dhe çlirimi i Kosovës”. M. Limani në diskutimin e saj

tha se ky propozim është dashur të hyjë në Programin e punës për vitin 2019, sepse organizimi i Konferencës ka implikime financiare të cilat nuk janë planifikuar dhe mund ta rëndojnë buxhetin e Akademisë. Ajo propozoi të mbahet një tryezë shkencore me temë më të ngushtë. Kryetari Daci tha se tema është e rëndësishme, por ka një problem se nuk është përfshirë në Programin e punës me kohë. Ai po ashtu tha se tema në fjalë mund të hapë shumë diskutime në këtë fazë dhe propozoi që organizimi i një konference të tillë të shtyhet për më vonë. J. Pula tha se shpenzimet financiare nuk janë paraqitur, meqë është menduar të miratohet së pari nga Kryesia, por nuk mund të jenë të larta, meqë propozimi është që konferenca të jetë njëditore dhe të ftohen më së shumti tre veta jashtë vendit.

Diskutoi edhe J. Bajraktari, i cili u pajtua se propozimi është dashur të përfshihet në Programin e punës, por në bazë të Statutit të Akademisë, Kryesia mund të vendosë të përfshihen në Program të punës propozime të cilat konsiderohen të rëndësishme, siç është ky që tani po shqyrtohet dhe se organizimi i një konference nuk mund të ketë shpenzime të larta financiare.

Pas diskutimeve Kryesia nuk e miratoi kërkesën në fjalë dhe u tha që organizimi i saj të shtyhet për një kohë më të përshtatshme.

Kryesia më pas:

- Shqyrtoi njoftimin e akademik Rexhep Ismajlit për vizitën e anëtarit të

Akademisë Amerikane të Arteve dhe të Shkencave prof. dr. Brian Joseph në Akademinë tonë më 19-23 shkurt 2019. U tha se Profesori është i mirëseardhur dhe atij t'i mbulohen shpenzimet e qëndrimit nga ASHAK-u;

- Shqyrtoi kërkesën e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin në Akademinë Austriake të Shkencave në Vjenë për dy javë. Kërkesa u miratua dhe u tha që shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit t'i mbulohen duke u bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit të ASHAK-ut me Akademinë Austriake;

- Mori vendim për realizimin e pagesës së kuotës së anëtarësisë së ASHAK-ut në Unionin Akademik Ndërkombëtar (UAI), në bazë të faturave përkatëse;

- Caktoi listën e lektorëve për lekturimin e botimeve të ASHAK-ut, si në vijim: Shefqet Riza dhe Bahri Koskoviku;

- Shqyrtoi kërkesat e disa personave jashtë Akademisë, për përfshirjen e dorëshkrimeve dhe projekteve të tyre në programin e punës së ASHAK-ut. U tha se të gjithëve, nëse e kërkojnë përgjigjen me shkrim, t'ju thuhet se ASHAK-u e miraton Programin e punës duke u bazuar në buxhetin e miratuar vjetor dhe se nuk mund të përfshijë aktivitete, botime dhe projekte të tjera, meqë nuk ka mjete të mjaftueshme financiare;

- Shqyrtoi kërkesat për lejimin e xhirimeve në mjediset e ASHAK-ut. U tha se edhe në këto raste kërkuesve t'u

kthehet përgjigje negative, meqë ASHAK-u gjatë vitit ka aktivitete të ndryshme, vizita të bashkëpunëtorëve nga brenda dhe jashtë vendit dhe se nuk mund të pengohet puna;

- U njoftua nga L. Pula se janë alokuar mjetet financiare nga buxheti për janar 1/12-ta dhe për shkurt 2/12. Administrata ka filluar realizimin e aktiviteteve të parapara në bazë të disponimit të mjeteve financiare. Procedurat e tenderimit për shtypjen e botimeve nuk mund të fillojnë pa hyrë në fuqi Ligji i buxhetit. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të buxhetit do të fillojnë edhe procedurat e rekrutimit për plotësimin e pozitave të miratuara të punës. Fillimisht ato që duhet zëvendësuar dhe më pas edhe të tjerat, sipas planit të rekrutimit të dërguar në MAP. Te pozita Zyrtar i logjistikës, nëse kërkohet nga MAP-i, duhet të bëhet një plotësim në mënyrë që të harmonizohet koeficienti me gjendjen në BDMS-2019.

Kryesia u pajtua që të bëhen plotësimet e nevojshme dhe punët të vazhdojnë sipas dinamikës së paraparë.

2. Në mbledhjen XV, mbajtur më 13 mars, pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja paraprake Kryesia e shqyrtoi draftin e Kornizës afatmesme të shpenzimeve - KASH, 2020-2022. L. Pula e njoftoi Kryesinë se në KASH 2020-2022 duhet të paraqitet avancimi i anëtarëve korrespondentë dhe pranimi i anëtarëve të rinj, sepse kanë kosto financiare duhet të planifikohen që tani. Diskutuan me radhë shumica e

anëtarëve të Kryesisë. U tha që kërkesa për avancime të paraqitet për të gjithë anëtarët e Akademisë dhe të kërkohet shtimi i stafit akademik për 10 anëtarë të rinj. Për të dy këto kategori të kërkohen mjetet shtesë.

Më pas L.Pula e njoftoi Kryesinë se pas mbledhjes do ta plotësojë draftin dhe do t'ia dërgojë edhe një herë Kryesisë, me postë elektronike, për të paraqitur vërejtjet apo plotësimet eventuale. Ajo po ashtu njoftoi se dokumenti i finalizuar duhet t'i dërgohet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës më 15 mars 2019.

Në kuadër të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës u hap diskutimi për çështjen e mirëmbajtjes së objektit të Akademisë, meqë, siç u tha, mund të ndërlidhet me çështje financiare. J. Bajraktari shprehu shqetësim për mirëmbajtjen e objektit. Ai tha se përkundër kërkesave të shumta që i janë dërguar Ministrisë së Administratës Publike (MAP), nuk ka ndryshuar gjendja. Me këtë rast L.Pula e njoftoi Kryesinë se gjatë qëndrimit të auditorëve në Akademi, ata kanë propozuar që ASHAK-u të fillojë procedurat dhe t'i drejtohet me kërkesë MAP-it për bartjen e objektit të ASHAK-ut në pronësi të tij, meqë tani objekti konsiderohet se është vetëm në shfrytëzim. M. Limani propozoi që Kryesia fillimisht të marrë vendim për këtë çështje dhe më pas të fillojë komunikimi me MAP-in. Ajo tha se çështja e pronësisë është e përfshirë edhe në Planin strategjik të ASHAK-ut. L. Mulliqi në diskutimin e tij propozoi

që Kryesia të caktojë një grup me përbërje prej anëtarëve të Akademisë, i cili më pas do të komunikojë me MAP-in. Sekretarja e Akademisë vazhdimisht iu ka shkruar dhe ka apeluar për gjendjen në objekt, por kjo nuk ka sjellë rezultat. Kjo çështje duhet të ngritet në nivel më të lartë, madje nuk mbetet zgjidhje tjetër përpos të ftohen mediat dhe të alarmohet gjendja. Kryetari Daci tha se kjo çështje duhet të zgjidhet me biseda e jo me medie. Ai tha se duhet të merret vendimi dhe më pas të bëhet shkresa për MAP-in. Me shkresën duhet të merren anëtarët e Kryesisë. U vendos që për çështjen e bartjes së pronësisë të fillojnë procedurat dhe t'i dërgohet kërkesa MAP-it, ndërsa për çështjen e mirëmbajtjes së objektit të caktohet një grup me përbërje prej anëtarëve të Akademisë, i cili do të komunikojë me MAP-in.

Në vazhdim Kryesia e shqyrtoi kërkesën e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe mori vendim për realizimin e pagesave për personat e angazhuar në projektin “Korpusi i shqipes së folur në Kosovë”.

Shënimet për personat e angazhuar do t'i paraqiten DBF-së nga anëtari korrespondent Bardh Rugova, bartës i projektit.

Në kuadër të pikës 4 të rendit të ditës Kryesia propozoi anëtarët korrespondentë Fetah Podvoricën dhe Bardh Rugovën për anëtarë të komisionit për vlerësimin e tenderit për “Shërbime të shtypjes e të libërimit të publikimeve dhe të materialeve të tjera

të ASHAK-ut”. Anëtari i tretë do të caktohet nga Administrata e ASHAK-ut.

Më pas kryetari Daci tha se është koha të fillojnë përgatitjet për Programin e punës të ASHAK-ut për vitin 2020. Ai apeloj te sekretarët e seksioneve të ASHAK-ut që t'i përmbahen Rregullores për veprimtari botuese në mënyrë që të propozohen për botim vetëm dorëshkrimet e gatshme.

M. Limani dhe L. Mulliqi propozuan që Kryesia të marrë vendim për të gjitha propozimet për botime, për projekte dhe aktivitete shkencore e artistike për Programin e punës së Akademisë t'u bashkëngjitet vlera e shpenzimeve financiare, meqë vetëm në këtë mënyrë mund të ketë planifikim të mirë të buxhetit. Propozimi u miratua.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditë ditës, Kryesia:

a) Me kërkesë dhe arsyetim të sekretares së SSHSH (për shkak të gabimit teknik) u pajtua të plotësohet vendimi nr. 70/2, dt. 6 shkurt 2019, ashtu që në vend të z. Imri Musliu paushalli t'i paguhet z. Vullkan Terziut;

b) Miratoi kërkesën e anëtarit korrespondent Muhamedin Kullashi, njëherësh anëtar i Këshillit për bashkëpunim ndërkombëtar, që të ftohet një akademik nga Akademia Franceze (AIBL), i cili në kuadër të Marrëveshjes së nënshkruar në vitin 2016 në ASHAK, të mbajë një ligjëratë në ASHAK;

Njëherësh në kuadër të po kësaj pike të rendit të ditës J. Bajraktari propozoi që për mbledhjen e ardhshme të Kryesisë, sekretarja e Akademisë të përgatisë propozim-agjendat për mbledhjet e kuvendeve të Akademisë në mënyrë që në mbledhjen e radhës të Kryesisë të shqyrtohen dhe të miratohen agjendat. Ai më pas tha se deri në fund të qershorit, në bazë të Ligjit dhe Statutit të Akademisë, duhet të mbahen mbledhjet e dy kuvendeve (Kuvendit zgjedhor dhe Kuvendit për miratimin e Programit të punës). Duke qenë se për dy kuvendet duhet të mbahen dy rrathë të mbledhjeve, ka pushime për festa zyrtare dhe ka udhëtime të parapara, do të ishte mirë që tani të fillojnë përgatitjet. E. Basha tha se do të ishte mirë që mbledhjet e Kuvendit të kryhen në qershor. Ai kujtoi një Kuvend që është mbajtur në korrik dhe tha se nuk do të ishte mirë të përsëritet kjo përvojë. Diskutoi edhe L. Mulliqi dhe J. Pula, të cilët u pajtuan me propozimin e J. Bajraktarit që mbledhjet e kuvendeve të mbahen sipas Ligjit. Kryetari Daci tha se nuk ka nevojë për dy kuvende, mjafton një Kuvend. L. Pula sqaroi se bazuar në Ligjin dhe Statutin e Akademisë, Kuvendi zgjedhor dhe Kuvendi i punës nuk mund të përmbliidhen në një kuvend, meqë procedurat dhe afatet për mbajtjen e njërit dhe tjetrit kuvend janë të ndryshme.

Kryetari Daci në fund tha se kuvendet e punës duhet të përgatiten si duhet, brenda afateve kohore e nëse ka nevojë edhe dy, edhe tre kuvende, por

tani për tani një kuvend është i mjaftueshëm.

3. Në mbledhjen XVI, mbajtur më 11 prill, Kryesia u mor me një varg çështjesh.

Para miratimit të rendit të ditës kryetari Daci propozoi të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës - shtimi i tirazhit të Monografisë Kosova, versioni në gjuhën angleze. Propozimi u miratua.

J. Bajraktari po ashtu kërkoi të diskutohet në pikë të veçantë të rendit të ditës çështja e nisjes së procedurës për thirrjen e seancës zgjedhore të Kuvendit të Akademisë sipas Ligjit, Statutit dhe rregullores përkatëse.

Kryetari Daci tha se kjo çështje është diskutuar edhe në mbledhjen e fundit të Kryesisë, figuron edhe në procesverbal, pra nuk ka Kuvend tjetër këtë vit përveç Kuvendit të punës. J. Bajraktari më pas tha se bazuar në aktet normative të Akademisë, të cilat e kemi obligim t'i zbatojmë, procedura e zgjedhjes duhet të fillojë tre muaj përpara, prandaj tani është koha të miratohet agjenda dhe të fillojnë procedurat. Në diskutimet e tyre E. Basha, J. Pula, L. Mulliqi u pajtuan me propozimin e nënkryetarit dhe kërkuan nga sekretarja e Akademisë interpretimin e Ligjit dhe Statutit për çështjen në fjalë. L. Pula e njoftoi Kryesinë se në bazë të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Statutit të Akademisë dhe Rregullores për propozimin dhe

zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, Kryesia e Akademisë më së largu deri më 26 prill duhet të nisë procedurën e zëvendësimit të kryetarit të Akademisë dhe në mbledhje të rregullt të saj të miratojë agjendën e aktiviteteve parazgjedhore dhe të thërrasë seancën zgjedhore të Kuvendit të Akademisë. Më pas J. Bajraktari, E. Basha, J. Pula dhe L. Mulliqi kërkuan që sekretarja e Akademisë të përgatitë materialet e nevojshme (njoftimin dhe propozim-agjendën) dhe më pas ato t'ua përcjellë në kopje elektronike të gjithë anëtarëve të Kryesisë. Pas konfirmimit të caktohet mbledhja e radhës më së largu deri më 26 prill në të cilën do të miratohet agjenda dhe do të nisin procedurat e parapara me aktet normative.

Kryetari Daci tha se kjo mbledhje e Kryesisë të vazhdojë sipas rendit të ditës që e kemi në materiale dhe se nuk ka nevojë që çështja e zgjedhjeve të diskutohet në pikë të veçantë. Ai tha se pajtohet që të ndiqen të gjitha procedurat.

Pas miratimit të procesverbalit, Kryesia e shqyrtoi raportin e punës për projektin "Matja e ekonomisë informale në Kosovë dhe përcaktuesit e saj" (Faza e parë). J. Pula e njoftoi Kryesinë me rrjedhën e punës dhe paraqiti materialet e mbledhura. Ajo po ashtu tha se raporti është shqyrtuar dhe është miratuar paraprakisht në mbledhjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore.

Kryesia e miratoi raportin dhe mori vendim për realizimin e pagesave për personat e angazhuar në projekt.

Në fund Kryesia:

- Mori vendim për shtimin e tirazhit të Monografisë Kosova - versioni në gjuhën angleze. U tha se kopjet e librit janë harxhuar, është libër që kërkohet vazhdimisht nga institucionet e vendit, nga libraritë dhe shitet mjaft nëpër panaire të ndryshme. Numri i kopjeve që do të shtypen u vendos të jetë 500 copë.

- Miratoi raportin e anëtarit korrespondent Arsim Bajrami për qëndrimin e tij në Salzburg më 1-4 mars 2019 me qëllim të pjesëmarrjes në mbledhjen e rregullt të Asamblesë së Përgjithshme të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve.

4. Në mbledhjen XVII të datës 25 prill, Kryesia:

- Miratoi agjendën e aktiviteteve parazgjedhore për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë;

- Vendosi të thërrasë seancën zgjedhore të Kuvendit të Akademisë (XCVII) më 6 qershor 2019 në orën 11:00 dhe caktoi këtë rend të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCVI të Kuvendit të Akademisë; caktimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë; votimi për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë dhe shpallja e rezultatit të votimit si dhe çështje vijuese;

- Shqyrtoi propozimin e Komisionit për blerjen e veprave artistike të ASHAK-ut dhe mori vendim të blihet vepra artistike e autores Alie Vokshi, pikturë, me titull “Dy Fytyra”, dimensionit 100 x70 cm, vaj në pëlhurë, 2002.

- Shqyrtoi kërkesën e Fetah Podvoricës, dt. 19 prill 2019, dhe vendosi që t’i bëhet kompensimi (rimbursimi) i mjeteve financiare, të cilat i ka paguar për blerjen e biletës së aeroplanit. U tha që vendimit t’i bashkëngjitet arsyetimi dhe fatura përkatëse.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditë ditës, L.Pula e njoftoi Kryesinë se avokati z. Bajram Morina është ftuar nga Gjykata përkatëse për çështjen e z. Shaip Ollurit. U tha që avokati të vazhdojë me punë ashtu siç kërkohet dhe t’i bëhet kompensimi sipas akteve normative përkatëse.

5. Në mbledhjen XVIII të datës 15 maj, si zakonisht pas miratimit të procesverbalit, Kryesia shqyrtoi raportet e seksioneve për rezultatet e propozimeve të kandidatit për kryetar të Akademisë si më poshtë:

1. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë ka propozuar akademik Mehmet Krajën për kryetar të Akademisë;

2. Seksioni i Shkencave Shoqërore ka propozuar akademik Anton K. Berishajn për kryetar të Akademisë;

3. Seksioni i Shkencave të Natyrës nuk ka kandidat të vetin për kryetar të Akademisë;

4. Seksioni i Arteve ka propozuar akademik Anton K. Berishajn për kryetar të Akademisë.

U tha se në mbledhjen II votohen vetëm kandidatët e propozuar në mbledhjen I.

Në vazhdim Kryesia:

- Propozoi Myzafer Limanin dhe akademik Isuf Krasniqin për anëtarë të komisionit për vlerësimin e tenderit “Avancimi i sistemit të zërimit të ASHAK-ut”. Anëtari i tretë caktohet nga Administrata;

- Mori vendim për kompensimin e mbushjeve telefonike për punonjëset Nitë Krasniqi, zyrtare e logjistikës, dhe Gerta Çuna, zyrtare e IT-së për përkrahje.

- Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të M. Limanit për qëndrimin e saj në Bern të Zvicrës, me qëllim të pjesëmarrjes në Asamblenë e përgjithshme të ALLEA-s më 8-10 maj 2019.

6. Në mbledhjen XIX, mbajtur më 11 qershor, Kryesia e shqyrtoi Programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2020. Sekretarët e seksioneve raportuan me rend, secili për seksionin e tij. Kryetari Daci në diskutimin e tij tha se programi i punës është i mirë dhe i pasur, por, siç tha ai, është mirë që një anëtar i Akademisë të ketë vetëm një propozim, meqë ky është një parim që duhet të zbatohet.

L. Mulliqi propozoi të merret vendim që të sanksionohet se një autor mund të paraqesë vetëm një propozim për programin vjetor të punës. Diskutuan F. Podvorica, M. Limani, J. Bajraktari, J. Pula. Gjatë diskutimeve u tha se deri më tani është respektuar ky parim, por ka disa raste kur ka projekt dhe në kuadër të projektit ka tubim shkencor, prandaj duhet të ketë një sqarim për raste të tilla. Kryetari Daci propozoi që me këtë çështje të merret Këshilli botues i ASHAK-u, ashtu që në të ardhmen të vendoset një rregull për të gjitha seksionet. Propozimi u miratua.

Më pas, pas shqyrtimit të Programit të punës në tërësi, u tha që te Seksioni i Shkencave Shoqërore të riformulohet pika 5 dhe 6 te botimet dhe u vendos që propozimi i akademik Zeqirja Ballatës "Vepra solistike instrumentale" të mës përfshihet në Programin e punës për vitin 2020, meqë dorëshkrimi nuk është i gatshëm.

U vendos që Programi i punës për vitin 2020 t'i dërgohet për miratim përfundimtar Kuvendit të Akademisë.

Në vazhdim Kryesia shqyrtoi dokumentin e shpërndarjes së buxhetit për shpenzim, sipas Qarkores së parë buxhetore 2020-2021. U tha se dokumenti u është dërguar të gjithë anëtarëve të Kryesisë përmes postës elektronike më 16 maj 2019.

Shpërndarja e buxhetit për shpenzim, sipas Qarkores së parë buxhetore 2020-2021 u miratua me një plotësim: mjetet në vlerë prej 1000 eurove për

veshmbathje të transferohen te kodi botimet e publikimeve.

Në kuadër të pikës 4 të rendit të ditës, Kryesia vendosi të thërrasë mbledhjen XCVIII të Kuvendit të Akademisë dhe caktoi këtë rend të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCVII të Kuvendit të Akademisë; miratimi i Programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2020 dhe çështje vijuese.

Më pas u mor vendimi për pagimin e paushallëve për pjesëmarrësit e koncertit solemn me vepra muzikore e poetike të autorëve mbarëkombëtarë e të huaj për nder të 20 vjetorit të çlirimit të Kosovës.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje, Kryesia diskutoi për thirrjen e Seancës zgjedhore për zgjedhjen e Kryetarit të ASHAK-ut. L.Pula me kërkesë të kryetarit Daci e njoftoi Kryesinë se në takimin që kanë pasur me kryetarin, më 7 qershor kanë biseduar për rrjedhën e punës në vazhdim. Kryetari ka kërkuar që Seanca zgjedhore të mbahet në korrik në mënyrë që të përfundojë brenda mandatit të tij deri më 26 korrik, por nëse kjo nuk mund të realizohet, të shtyhet pas pushimeve. Më pas ajo tha se i ka përgatitur dy propozim-agjenda sipas afateve të parapara me Statut, njëren për shpalljen e zgjedhjeve në qershor dhe mbajtjen e seancës në korrik, si dhe tjetrën për shpalljen e zgjedhjeve në shtator dhe mbajtjen e seancës në tetor. Duke marrë parasysh se muaji korrik dhe gusht janë muaj të pushimeve verore, iu kemi dërguar

shkresën zyrtare dhe propozim-agjendën e aktiviteteve parazgjedhore të gjithë anëtarëve të Akademisë, me ç'rast është kërkuar konfirmimi i propozim-agjendës. Gjatë kohës së paraparë vetëm 4 anëtarë të Akademisë e kanë konfirmuar propozim-agjendën, 14 anëtarë kanë njoftuar përmes postës elektronike dhe 2 anëtarë e kanë njoftuar gojariisht asistenten ekzekutive se nuk janë në Kosovë në datat e propozuara. Ajo tha se tani i mbetet Kryesisë të vendosë.

Kryetari Daci në diskutimin e tij tha se procedurat zgjedhore të fillojnë menjëherë. Askush prej nesh nuk mund të ndalë askënd të shkojë në pushim, por duhet ta kryejmë obligimin ligjor e statutar. Duhet të tentojmë, nëse ka sukses kryhet, nëse nuk ka sukses shtyhet për shtator. Vendimi për vazhdimin e procesit nuk e obligon askënd që procesi duhet të përfundojë. Ne kemi obligim ta konstatojmë se e kemi ndjekur procedurën, por nuk janë mbajtur mbledhjet se nuk ka pasur kuorum.

Datat e mbledhjeve caktohen e nëse nuk mund të mbahen mbledhjet e parapara, konstatojmë që nuk janë mbajtur. Po ashtu edhe nëse nuk ka kuorum për Seancë zgjedhore, konstatojmë se dështon procesi, nuk mund të mbahet Kuvendi. J. Pula në diskutimin e saj tha se ajo nuk mund të thërrasë mbledhjen, sepse nuk i ka anëtarët e Seksionit. Kryetari Daci tha se ajo duhet të thërrasë mbledhjen, nëse nuk ka kuorum e konstaton se nuk mbahet mbledhja. L. Mullqi po ashtu

tha se nuk mund ta mbajë mbledhjen e Seksionit, sepse nuk i ka shumicën e anëtarëve të Seksionit. Ai kërkoj që të mos zgjaten diskutimet, por të dalë në votim propozim-agjenda, nëse nuk miratohet, atëherë të votohet e dyta.

F. Podvorica tha se anëtarët e Akademisë në konfirmimet përmes postës elektronike janë deklaruar për mosprezencën në muajin korrik, por jo në muajin qershor. Kuvendi i punës është caktuar të mbahet më 27 qershor, që i bie se gjatë qershorit anëtarët e Akademisë janë këtu dhe mund të mbahen mbledhjet. Në aktet normative të Akademisë nuk është e precizuar koha e pushimeve vjetore. Ai tha se konfirmimi është kërkuar vetëm për Kuvend. Por L.Pula sqaroi se anëtarëve të Akademisë u është kërkuar konfirmimi i propozim-agjendës e në atë dokument janë paraqitur datat për mbledhje të seksioneve dhe data e mbledhjes së Kuvendit. Këtë propozim-agjendë e kanë konfirmuar vetëm 4 vetë. J. Bajraktari në diskutimin e tij tha se procedurat zgjedhore i kemi filluar me kohë, Kuvendi tani më dihet që dështoi. Tani duhet të punojmë në drejtim të zgjidhjes së problemit e jo të shtojmë problemet. Të gjithë e dimë se muajt korrik dhe gusht janë muajt të pushimeve verore. Në Kuvend patëm ndarje të elektoratit dhe dështoi procesi. Prandaj ne si Kryesi tani duhet të jemi të përgjegjshëm dhe të bëjmë përgatitjet për mbajtjen e Kuvendit të radhës në mënyrë që zgjedhja e kryetarit të përfundojë në atë Kuvend. Nuk jam ithtar i asaj që të dështojë

edhe një Kuvend, sepse ka pasoja. E kemi rastin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë sa polemikat kanë dalë, pra nuk është mirë që Akademia të bëhet pasqyrë e gjuajtjeve joparimore si në aspektin ligjor, ashtu edhe në aspektin profesional, politik, etj. Në patëm kandidatë dhe kuorumin, por nuk e zgjodhëm kryetarin, prandaj në këtë fazë është mirë të përgatitemi dhe të mos shtojmë antagonizma. Pra sot duhet të marrim vendim për vazhdimin e punës, në shtator të fillojnë përgatitjet në mënyrë që të mbahet Kuvendi brenda afateve ligjore.

M. Limani tha se e kemi një kushtëzim që brenda afateve të fillojmë procedurat. Ne duhet të marrim vendim që procesi të fillojë e më pas të caktohen datat e mbledhjeve.

N. Daci tha se procesi duhet të vazhdojë patjetër, të dokumentohet se janë caktuar datat, nëse nuk mbahen mbledhjet të konstatohet në procesverbal se nuk është mbajtur për shkak se nuk ka pasur kuorum.

L. Mulliqi ndërhyri duke thënë se që tani është i informuar se i mungojnë shumica e anëtarëve të Seksionit të Arteve dhe nuk mund të mbajë mbledhje.

M. Limani propozoi që sot të merret vendimi për fillimin e zgjedhjeve, meqë në Statut e kemi së paku 30 ditë përpara; kjo nënkupton se mund të caktohet edhe 60 ditë përpara, prandaj sot mund të caktohet

data e mbajtjes së Kuvendit. Meqë tani po e dimë që në korrik nuk mund të mbajmë mbledhje të Kuvendit, marrim vendim për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit në tetor.

L. Pula sqaroi se në marrëveshje me kryetarin i ka përgatitur dy propozim-agjenda, njëra për zbatimin e procedurave zgjedhore në qershor-shtator dhe tjetra për periudhën shtator-tetor. Kryesia sot duhet të miratojë njërën prej tyre, sepse nëse miratohet propozim-agjenda për periudhën qershor-korrik, nesër, më 12 qershor, duhet të njoftohen anëtarët e Akademisë dhe t'u dërgohen materialet për mbledhje.

Kryetari Daci edhe një herë theksoi se duhet të merret vendim që procedurat zgjedhore të fillojnë dhe atë para datës 26 korrik, brenda mandatit të tij, pra të caktohen datat e mbledhjeve dhe Kuvendi të mbahet në shtator ose tetor. Ndërsa F. Podvorica kërkoi që në arsyetimin e vendimit të ceket arsyeja e shtyrjes së mbledhjes për muajin tetor.

Pas diskutimeve Kryesia njëzëri mori këtë vendim që:

I. Procesi zgjedhor për zgjedhjen e kryetarit të ASHAK-ut të fillojë brenda afateve ligjore;

II. Miratohet agenda parazgjedhore dhe caktohet data e Kuvendit zgjedhor më 3 tetor 2019;

III. Akademik Nexhat Daci më 26 korrik 2019 (Statuti i Akademisë, neni 31, paragrafi 5, nënparagrafi 5.1) i ndërpritet ushtrimi i funksionit të kryetarit të ASHAK-ut;

IV. Kryetarin e ASHAK-ut nga data 27 korrik 2019 e deri në zgjedhjen e kryetarit të ri e zëvendëson nënkryetari i Akademisë, akademik Jusuf Bajraktari;

V. Vendimit i bashkëngjitet agjenda parazgjedhore.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës të po kësaj mbledhjeje Kryesia miratoi:

- Raportin e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin e tij në Vjenë më 29 prill deri më 12 maj 2019 me qëllim të vazhdimin e hulumtimeve në Arkivin e shtetit dhe në Lubjanë më 12-14 maj 2019, vizitë në Institutin e gjuhësive të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë;

- Raportin e anëtarit korrespondent Fetah Podvorica për qëndrimin e tij në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi në Podgoricë më 16 deri më 18 maj 2019, me qëllim të pjesëmarrjes në Konferencën shkencore "Approaching 20??";

- Raportin e anëtarit korrespondent Fetah Podvorica për qëndrimin e tij në Londër më 28 deri më 30 maj 2019, me qëllim të pjesëmarrjes në konferencën e 5-të të vendeve të Ballkanit Përendimor me titull "Fresh

Expectations for Research and Education across Europe" e organizuar nga Akademia e Shkencave të Birtanisë së Madhe, Royal Society dhe Akademia Nazionale e Shkencave të Gjermanisë, Leopoldina;

- Plotësimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

7. Mbledhjen XX, mbajtur më 2 shtator, e kryesoi nënkryetari i Akademisë akademik Jusuf Bajraktari, i cili fillimisht e falënderoi kryetarin Daci për punën e tij gjatë mandatit të Kryetarit të Akademisë, duke i uruar shëndet e suksese në punën e mëtejme.

Në këtë mbledhje Kryesia shqyrtoi, diskutoi dhe vendosi për çështjet si në vijim:

- Vendosi të thërrasë seancën zgjedhore XCIX të Kuvendit të Akademisë më 3 tetor 2019. L. Pula e njoftoi Kryesinë se në një nga mbledhjet e Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe në mbledhjen e parafundit të Kuvendit të Akademisë akademik Minir Dushi ka bërë vërejtje dhe ka kërkuar që në mbledhjet e seksioneve dhe të Kuvendit, të cilat kanë karakter zgjedhor të mos ketë miratim të procesverbaleve, por ato të shtyhen për mbledhjet e radhës. Diskutuan J. Bajraktari, M. Limani, F. Podvorica e E. Basha dhe pas diskutimeve njëzëri u tha që procesverbalet e mbledhjeve paraprake gjithnjë miratohen në

mbledhjet vijuese. Shtyrja e miratimit të tyre ndodh vetëm në rastet kur caktohen mbledhje urgjente.

- Caktoi këtë rend të ditës për mbledhjen e radhës së Kuvendit të Akademisë: 1. Miratimin e procesverbalit të mbledhjes XCVIII të Kuvendit të Akademisë; 2. Caktimin e Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë; 3. Votimin për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë dhe shpalljen e rezultatit të votimit dhe 4. Çështje vijuese.

- Në bazë të Rregullores për honoraret e autorëve të veprimtarisë botuese, neni 4, vendosi që z. Valbon Bytyqi t'i paguhet paushalli për punët e kryera në cilësinë e dizajnerit të botimit të Leksikonit "Vendbanimet rurale të Kosovës", vëllimi II (A-LL).

- Shqyrtoi kërkesën e Seksionit të Shkencave Shoqërore për organizimin e punëtorisë për projektin "Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës". - Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale. M. Limani në diskutimin e saj tha se e përkrah organizimin e punëtorisë dhe propozoi që sekretarja e SSHSH-së të paraqesë shumën e mjeteve financiare. J. Pula tha se Seksioni ka propozuar që pjesëmarrësve t'u mbulohen shpenzimet e udhëtimit, fjetjes dhe ushqimit, si dhe shpenzimet e tjera për punë teknike, pa mëdijtje shtesë. Kërkesa u miratua njëzëri.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

- U njoftua nga L.Pula se pas përfundimit të mandatit të kryetarit Daci janë kryer procedurat e parapara për ndërprerjen e shtesës funksionale dhe pagesës së telefonisë mobile;

- Shqyrtoi shkresën e punonjësit z. Xhemshit Brajshori. Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë, me ç'rast u tha se Kryesia nuk e ka për detyrë të shqyrtojë shkresa të tilla, meqë z. Brajshori është shërbyes civil dhe i përgjigjet sekretarit të Akademisë. Z. Brajshori e ka marrë përgjigjen në një kërkesë të ngjashme, e ka pranuar dhe e ka nënshkruar aktemërimin dhe çështja e tij ka përfunduar. Kryesia apeloj që z. Brajshori duhet t'i kryejë detyrat e punës sipas Rregullores përkatëse dhe formularit të detyrave të punës. U tha po ashtu se ka vërejtje për punën e tij sa i përket fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare, sepse nuk ua ka përcjellë anëtarëve të Këshillit për bashkëpunim ndërkombëtar të ASHAK-ut njoftimet me kohë për pjesëmarrje në disa takime ndërkombëtare.

Pas diskutimeve u vendos që z. Brajshori t'i kthehet përgjigje me shkrim.

- U njoftua nga L. Pula se sot në orën 15:15 është caktuar orari për paraqitje të ASHAK-ut në dëgjimin buxhetor në Ministrinë e Financave. L.Pula paraqiti gjendjen e deritashme të shpenzimit të

buxhetit për vitin 2019 dhe njoftoi po ashtu se buxheti edhe për vitin tjetër është i njëjtë. Sa i përket mjeteve financiare në kategorinë shpenzime kapitale, ajo tha se ASHAK-u i ka kërkuar vetëm për vitin 2019, ato janë ndarë, është zhvilluar procedura e tenderimit dhe tani sipas afateve kohore të përcaktuara do të shpenzohen mjetet.

Kryesia u pajtua që për vitin vijues ASHAK-u nuk ka nevojë të kërkojë mjete financiare shtesë. Mjetet e ndara në kategorinë shpenzime kapitale për vitin 2020 tani më nuk nevojiten.

8. Në mbledhjen XXI të Kryesisë të datës 13 shtator, nënkryetari Jusuf Bajraktari fillimisht shprehu ngushëllime për vdekjen e anëtarit të jashtëm të ASHAK-ut Wilfried Fiedler dhe e ftoi Kryesinë për një minutë heshtje në nderim të veprës së tij.

Para miratimit të rendit të ditës M. Limani propozoi që pika e tretë e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër të Kryesisë dhe kërkoj që kërkesa për çështje të tilla të paraqitet së pari nga secili sekretar i Seksionit përkatës në Këshillin botues të ASHAK-ut, të shqyrtohet në mbledhje të Këshillit dhe më pas propozimi i Këshillit t'i dërgohet për miratim Kryesisë së Akademisë. Propozimi u përkrash.

Më pas, pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, nënkryetari Bajraktari e njoftoi Kryesinë se mbledhjet I të seksioneve janë mbajtur

sipas agjendës së miratuar. Ai më pas kërkoj nga L. Pula ta njoftojë Kryesinë për rrjedhën e deritanishme të procesit zgjedhor.

L. Pula e njoftoi Kryesinë me rezultatin e mbledhjeve I të seksioneve të ASHAK-ut si në vijim:

- Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë ka propozuar akademik Mehmet Krajën për kryetar të Akademisë;

- Seksioni i Shkencave Shoqërore ka propozuar akademik Mehmet Krajën për kryetar të Akademisë;

- Seksioni i Shkencave të Natyrës ka propozuar akademik Isuf Krasniqin për kryetar të Akademisë dhe

- Seksioni i Arteve nuk ka kandidat të vetin për kryetar të Akademisë.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia miratoi raportet e udhëtimeve zyrtare:

- Raportin e akademikëve Rexhep Ismajli dhe Eqrem Basha për qëndrimin e tyre në Vjenë, në Akademinë e Shkencave të Austrisë, me qëllim të pjesëmarrjes në përurimin e tri veprave të ASHAK-ut më 11-13 qershor 2019;

- Raportin e akademik Nexhat Dacit për qëndrimin e tij në Tiranë, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, më 1-3 gusht 2019;

- Raportin e akademik Jusuf Bajraktari për qëndrimin e tij në Tiranë, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në mbledhjen e Këshillit organizativ "Shqiptarët dhe Koalicioni Antifashist në Luftën e Dytë Botërore" kushtuar 75-vjetorit të fitores së LANÇ-së, mbajtur më 8-9 shtator 2019;

- Raportin e akademikëve Ali Aliu, Mehmet Kraja dhe Eqrem Basha për qëndrimin e tyre në Ohër (Maqedoni e Veriut), me qëllim të pjesëmarrjes në përrurimin e antologjive respektive të të dy akademive me titull "Poetët akademikë", mbajtur më 20-21 gusht 2019;

- Raportin e anëtares korrespondente Justina Pula për qëndrimin e saj në Tiranë, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, me qëllim të realizimit të takimit për çështje të aktiviteteve të përbashkëta të SSHSH-së më 30 qershor – 3 korrik 2019;

- Raportin e punonjëseve të SHPAT për qëndrimin e tyre në Tiranë, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në takimet e përbashkëta ASHAK-ASHSH, mbajtur më 5-8 qershor 2019 dhe më 30 qershor -3 korrik 2019.

9. Në mbledhjen XXII të mbajtur më 8 tetor, Kryesia u kryesua nga kryetari i ri i Akademisë, akademik Mehmet Kraja.

Pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes pararendëse, kryetari e

njoftoi Kryesinë se është koha të mbahen mbledhjet e seksioneve për shqyrtimin e shkallës së realizimit të Programit të punës të ASHAK-ut për vitin 2019 në mënyrë që të bëhet një vlerësim i gjendjes se çfarë është kryer dhe çka mbetet të kryhet deri në fund të vitit. Ai më pas tha se është mirë të përurohen botimet e ASHAK-ut dhe propozoi që secili sekretar të planifikojë organizimin e promovimit të librave për seksionin e tij, më pas të caktohet data dhe në bashkëpunim me administratën të bëhen përgatitjet e nevojshme. Kryetari po ashtu propozoi që Seksioni i Arteve të angazhohet për organizimin e një koncerti për fundvitin.

Në kuadër të pike 3 të rendit të ditës, me kërkesë të kryetarit, L. Pula e njoftoi Kryesinë se ASHAK-u e ka hartuar Planin për menaxhimin e rrezikut për vitet 2017-2019 dhe tani është koha të hartohet Planin për menaxhimin e rrezikut për vitet në vazhdim.

Kryesia caktoi Grupin punues për hartimin e Planit të menaxhimit të rrezikut të ASHAK-ut në këtë përbërje:

1. Anëtare korrespondente Myzafere Limani, kryetare;

2. Anëtare korrespondente Justina Pula, anëtare;

3. Anëtar korrespondent Fetah Podvorica, anëtar;

4. Lendita Pula, anëtare;

5. Vjollca Hykolli, anëtare.

Në vazhdim Kryesia shqyrtoi shkresat e akademik Hivzi Islamit (nr. 680/1, dt.16.9.2019 dhe nr.740/2, dt.7.10.2019).

U tha se shpërndarja e dokumenteve financiare në mënyrë selektive dhe pa procedurë nuk duhet të përsëritet. Diskutuan J. Bajraktari, L. Mulliqi dhe pas diskutimeve Kryesia mori vendim që:

I. Dokumentet finaciare dhe dokumentet e tjera zyrtare nuk mund t'u jepen në përdorim personave të paautorizuar, brenda dhe jashtë Akademisë, pa kërkesë me shkrim dhe pa miratimin e Kryesisë së Akademisë;

II. Qasja në dokumente zyrtare dhe lejimi i tyre bëhen në pajtim me Ligjin për qasje në dokumente publike, Ligji nr. 06/L-081;

Po ashtu u tha që akademik Islamit t'i kthehet përgjigje me shkrim dhe të njoftohet me vendimin e Kryesisë.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia vendosi:

- Që komunikimi i jashtëm i ASHAK-ut të bëhet nën mbikëqyrjen e sekretares së Akademisë nga asistentja ekzekutive. Të gjitha njoftimet që lidhen me bashkëpunimin

ndërkombëtar t'i përcillen Këshillit për Marrëdhënie Ndërkombëtare të ASHAK-ut;

- Që veturat zyrtare të ASHAK-ut të përdoren vetëm për punë zyrtare. Të gjithë anëtarët e Akademisë mbi moshën 75-vjeçare do të mund t'i shfrytëzojnë veturat e Akademisë për vajtje-ardhje në Akademi, për kontrolle mjekësore dhe për angazhime të tjera, në kuadër të aktivitetit të tyre në institucione të ndryshme, sipas një radhe dhe evidence që do ta mbajë Administrata e Akademisë;

- Të themelohet çmimi për vepër jetësore në vlerë prej 5.000,00 €.

Nënkryetari i Akademisë të merret me organizimin e punës për hartimin e draftrrregullores, e cila do të miratohet në Kuvendin e Akademisë.

Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës t'i dërgohet kërkesa për transferin e mjeteve financiare në vlerë prej 5,000.00€;

- Që ta miratojë raportin e anëtarit korrespondent Fetah Podvorica për qëndrimin e tij në Francë, me qëllim të pjesëmarrjes në konferencën "Greffage de molecules organiques", të organizuar nga Universiteti i Saclay- it në Qendrën e Energjisë Atomike në Saclay të Francës më 25-29 shtator 2019.

Njëherësh në kuadër të po kësaj pike të rendit të ditës kryetari Kraja propozoi:

- Të organizohet pjesëmarrja e të gjithë anëtarëve të Akademisë në Panairin e librit në Tiranë;

- Të organizohet një vizitë e Kryesisë së Akademisë sonë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe realizimit të Protokollit ASHAK-ASHSH;

- Të mbledhet Këshilli botues i ASHAK-ut për shqyrtimin e realizimit të planit botues, mbarëvajtjen e botimit të revistave shkencore dhe rishikimin e dukjes së botimeve të ASHAK-ut.

Propozimet u miratuan njëzëri nga Kryesia.

10. Në mbledhjen XXIII të datës 15 tetor, procesverbali i mbledhjes XXII i Kryesisë së Akademisë u miratua me një plotësim te pika e fundit e rendit të ditës (shtohet miratimi i raportit të udhëtimit zyrtar i F. Podvoricës).

Në vazhdim kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se ditë më parë jemi informuar se Ligji për pagat i Republikës së Kosovës ka disa paqartësi sa i përket shpërblimit të anëtarëve të Akademisë dhe propozoi që të caktohet një grup punues nga ASHAK-u i cili do të merret me çështjen në fjalë.

Propozimi u miratua dhe Kryesia e caktoi Grupin punues për zbatimin e Ligjit për paga me këtë përbërje:

1. Akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar i Akademisë, kryesues;

2. Anëtar korrespondent Arsim Bajrami, anëtar;

3. Anëtare korrespondente Justina Pula, anëtare;

4. Lendita Pula, sekretare e Akademisë, anëtare.

Kryesia diskutoi çështjen e lidhjes së gazetave ("Koha ditore" dhe "Zëri"). Kryetari Kraja tha se lidhja e gazetave ka kosto dhe ka zënë hapësirë të konsiderueshme në mjediset e Bibliotekës së Akademisë. Duke qenë se të njëjtat ndodhen edhe në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës dhe në Arkivin e Kosovës, propozoi që të ndërpritet lidhja e tyre. Propozimi u miratua. U vendos të ndërpritet lidhja e gazetave dhe u tha që gazetatat e lidhura që gjenden në fondin e Bibliotekës së ASHAK-ut të sistemohen në një vend të veçantë apo të dhurohen në formë donacioni.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryetari propozoi:

- Që vizita në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë të realizohet më 6-8 nëntor 2019. Ai kërkoi nga sekretarët e seksioneve të përgatiten për takim, duke i hartuar me shkrim shënimet për pikat e bashkëpunimit, pavarësisht pikave që janë të përfshira në Protokollin ASHAK-ASHSH 2018-2020;

- Kërkoj të bëhen përgatitjet për pjesëmarrjen e anëtarëve të Akademisë në Panairin e librit në Tiranë;

- Kërkoj që secili sekretar të merret me përgatitjet për promovimin e botimeve të seksionit të tij;

- Kërkoj nga sekretari i Seksionit të Arteve të merret me përgatitjet për organizimin e koncertit të akademik Rauf Dhomit;

- E njoftoi Kryesinë se Ministria e Administratës Publike, pas vërejtjeve të shumta nga ASHAK-u, ka filluar të bëjë disa ndërhyrje në objekt. Ai kërkoj nga sekretarët e seksioneve të përcjellin gjendjen dhe për të gjitha parregullsitë që i vërejnë ta njoftojnë sekretaren e Akademisë.

Kryesia po ashtu:

Mori vendim që dy anëtarë të Seksionit të Shkencave të Natyrës të marrin pjesë në përrurimin e librit “Fjalori i termave bazë të kimisë” në ASHSH;

U njoftua nga nënkryetari Bajraktari se është hartuar drafti i Rregullores për ndarjen e çmimit për vepër jetësore. U tha se drafti do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës të Kryesisë;

U njoftua nga L. Pula se deri më tani punët kanë vajtur mbarë dhe nuk është evidentuar ndonjë rrezik financiar.

11. Mbledhja XXIV u mbajt më 28 tetor. Në këtë mbledhje Kryesia e shqyrtoi shpërndarjen e buxhetit për shpenzim sipas Qarkores II buxhetore 2020-2021. Me kërkesë të kryetarit Kraja, L.Pula e njoftoi Kryesinë se kufijtë buxhetorë janë të njëjtë dhe nuk mund të kalohen. Pas kërkesës së Kryesisë drejtuar Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës, nga kategoria mallra dhe shërbime në kategorinë transfere dhe subvencione janë transferuar mjetet financiare në vlerë prej 5.000,00 € për ndarjen e çmimit për vepër jetësore të ASHAK-ut. Ajo tha se shpërndarja e buxhetit sipas Qarkores II ka disa ndryshime të vogla nga ajo sipas Qarkores I.

F. Podvorica në diskutimin e tij paraqiti nevojën e qasjes në revista elektronike, duke thënë se ideja është të bashkëpunohet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe me Universitetin e Prishtinës. Kryetari Kraja tha se e përkrah propozimin dhe se është mirë të fillojnë bisedimet me institucionet përkatëse për çështjen në fjalë. M. Limani po ashtu tha se qasja në revista elektronike nuk është e thënë të bëhet vetëm në objektin e ASHAK-ut, por ne mund të bëhemi pjesë e tyre duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse. F. Podvorica më pas tha se duke qenë se në buxhetin e paraparë nuk ka mjete financiare në kategorinë shpenzime kapitale, a mund të kërkohen mjete financiare shtesë? L. Pula sqaroi se për vitin 2020 nuk mund të kërkohen mjete financiare shtesë në këtë kategori, sepse nuk ka projekt të gatshëm. Mund

të bëhen përgatitjet që tani në mënyrë që për vitin 2021 të përgatitet projekti me shkrim dhe me specifika përkatëse, i cili më pas do t'i prezantohet Ministrisë së Financave.

Pas diskutimeve Kryesia e miratoi shpërndarjen e buxhetit për shpenzime, sipas Qarkores së dytë buxhetore 2020-2021.

Në kuadër të pikës vijuese të rendit të ditës u diskutua për dinamikën e punëve të veprimtarisë botuese. Kryetari Kraja tha, meqë po i afrohem fundit të vitit, është mirë të dorëzohen dhe përgatiten për shtyp dorëshkrimet e parapara për këtë vit. Ka mjete financiare të mjaftueshme për shtypjen e librave dhe ato duhet të shpenzohen sipas planifikimit. Për shkak të finalizimit me kohë të botimeve të ASHAK-ut, ai propozoi që afati kohor për dorëzimin për shtyp të dorëshkrimeve të aprovuara për botim, pjesë e programeve të punës të seksioneve të ASHAK-ut, të jetë deri më 11 nëntor 2019.

Propozimi u miratua njëzëri.

Më pas kryetari Kraja tha se sekretarët e seksioneve të ASHAK-ut, që janë edhe redaktorë të botimeve, të marrin përgjegjësitë e tyre dhe të merren me redaktimin e secilit botim të seksionit përkatës. Autori i dorëshkrimit duhet të komunikojë vetëm me sekretarin e seksionit përkatës deri në dorëzimin e dorëshkrimit për shtyp. Po ashtu kryeredaktorët e revistave shkencore

të ASHAK-ut të marrin përgjegjësitë dhe të merren me përgatitjen e revistave nga fillimi deri në fund. Ai kërkoi që Këshilli botues të mblidhet dhe të propozojë marrjen e vendimeve për disa çështje:

- Të propozojë mënyrën e pagesës për kryeredaktorët e revistave, meqë ata kanë përgjegjësi më shumë se anëtarët tjerë të redaksisë dhe nuk mund të vazhdohet si deri më tani, të paguhet njëjtë me anëtarët e tjerë;

- Të marrë vendim që të standardizohet dukja e revistave të ASHAK-ut.

Në vazhdim Kryesia vendosi që z. Zeni Ballazhi të caktohet dizajner për dizajnimin e dorëshkrimit "Tregime të zgjedhura të shkrimtarëve akademikë (I-IV)". Paga e paushallit për z. Ballazhi do të miratohet nga Kryesia pas propozimit të Këshillit botues të ASHAK-ut.

Në kuadër të pikës vijuese të rendit të ditës, para miratimit të raporteve të udhëtimeve zyrtare, kryetari Kraja kërkoi:

- Nga sekretarët e seksioneve që pas përfundimit të çfarëdo aktiviteti të seksionit përkatës, si: konferencë, tryezë, simpozium, etj., të paraqitet raport me shkrim në seksion dhe më pas në Kryesi;

- Që raportet e projekteve të seksioneve të shqyrtohen dhe të miratohen së pari nëpër seksione dhe

më pas t'i dërgohen Kryesisë për miratim përfundimtar.

Më pas Kryesia i miratoi këto raporte të udhëtimeve zyrtare:

- Raportin e anëtares korrespondente Gjyljeta Mushkolaj për qëndrimin e saj në Paris nga 9 deri më 12 shtator 2019 me qëllim të pjesëmarrjes në Simpoziumin e 8-të të të drejtave të njeriut dhe shkencës”, që është bashkorganizuar nga komisionet për të drejtat e njeriut të Akademisë Franceze të Shkencave dhe të Akademisë Gjermane të Shkenvae-Leopoldina me temë: “ Të drejtat e njeriut dhe edukimi shkencor”;

- Raportin e anëtarëve korrespondentë Salih Gashi dhe Fetah Podvorica për qëndrimin e tyre në Tiranë, në ASHSH, me qëllim të pjesëmarrjes në përrurimin e botimit ”Fjalori i termave bazë të kimisë (shqip-anglisht) më 22-23 tetor 2019.

12. Mbledhja e Kryesisë (XXV) u mbajt më 20 nëntor. Kryesia mori vendim për pagimin e paushalleve për pjesëmarrësit e koncertit solemn me vepra të akademik Rauf Dhomit.

Në kuadër të pikës vijuese u shqyrtua raporti i punës së projektit ”Matja e ekonomisë informale në Kosovë dhe përcaktuesit e saj”, (Faza II). J. Pula, bartëse e projektit e njoftoi Kryesinë se projekti është shqyrtuar edhe në Seksionin e Shkencave Shoqërore dhe është miratuar.

Kryesia e miratoi Raportin dhe mori vendim për realizimin e pagesave për personat e angazhuar në projekt.

Në vazhdim Kryesia mori këto vendime:

- Z. Zeni Ballazhit i paguhet paushalli për punët e kryera në cilësinë e dizajnerit të Katalogut për ekspozitën e akademik Agim Çavdarbashës;

- Z. Zeni Ballazhit i paguhet paushalli për punët e kryera në cilësinë e dizajnerit të dorëshkrimit ”Përzgjedhje me tregime”;

- Akademik Eqrem Bashës i paguhet paushalli për punët e kryera në cilësinë e kuratorit të Katalogut për ekspozitën e akademik Agim Çavdarbashës.

Në fund J. Bajraktari e njoftoi Kryesinë se më 25 nëntor 2019, në orën 10:00, në sallën e madhe të ASHAK-ut Ambasada e Hungarisë do të promovojë librin për Skënderbeun. Ai kërkoi nga sekretarët e seksioneve t'i njoftojnë anëtarët e tyre në mënyrë që të ketë pjesëmarrje më të madhe të anëtarëve të Akademisë.

13. . Në mbledhjen XXVI, mbajtur më 4 dhjetor, Kryesia diskutoi për rezultatin e testit PISA. Kryetari Kraja në fjalën e tij tha se njoftimi që u bë dje për testin PISA ishte shqetësues dhe ASHAK-u nuk mund të qëndrojë indiferent karshi një problemi kaq të madh. Ai tha se e ka përgatitur draftin e njoftimit për opinion dhe ua la në dispozicion anëtarëve të Kryesisë për ta lexuar dhe

për të paraqitur propozime apo vërejtje eventuale. Pasi e lexuan dhe e shqyrtuan draftin e njoftimit, diskutuan të gjithë anëtarët e pranishëm. Teksti u miratua njëzëri dhe u tha që t'u dërgohet mediave dhe anëtarëve të Akademisë.

14. Mbledhja XXVII e Kryesisë u mbajt më 10 dhjetor. U miratuan procesverbalet e dy mbledhjeve, XXV dhe XXVI. I pari u miratua me një plotësim. U tha që shumat financiare të mos paraqiten në procesverbale. Në raste kur ka vendime me emra dhe shumata, ato t'i bashkëlidhen procesverbaleve.

Në vazhdim Kryesia shqyrtoi shkallën e realizimit të Programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2019, me radhë sipas seksioneve. Raportuan me radhë sekretarët e seksioneve. Gjatë shqyrtimit të shkallës së realizimit të Programit të punës së Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, kryetari Kraja tha se në të mungon raporti i konferencës shkencore "Studime albanistike në Itali". Ai kërkoi që për të gjitha aktivitetet shkencore që i organizon Akademia kryesuesit e këshillave organizuese të paraqesin raporte me shkrim. L. Mulliqi në diskutimin e tij tha se në planin botues për vitin 2019 është përfshirë dorëshkrimi "Bashkësi gjuhësore, njësi, varietet". Ky dorëshkrim nuk ka qenë në Programin e punës dha tani po figuron. Sipas Rregullores për veprimtari botuese asnjë dorëshkrim nuk përfshihet në Program të punës pa

qenë i gatshëm; Rregulloret vlejné për të gjithë dhe se duhet të respektohen njëjtë nga seksionet. Ai e përmendi rastin e akademik Ballatës dhe tha se katër ditë para mbledhjes së Kuvendit e ka sjell dorëshkrimin, por si sekretar i Seksionit më është dashur t'i them se është vonë, sepse janë ndarë materialet për mbledhjen e Kuvendit. Unë si sekretar po tregohem i padrejtë me Seksionin tim, sepse nuk po jemi parimorë. M. Kraja sqaroi se sivjet jemi vonuar me dorëzimin e dorëshkrimeve, disa nuk janë gati fare, prandaj është dashur të bëjmë zëvendësime në mënyrë që të shfrytëzohen mjetet financiare. Ai tha se gjithnjë e kemi thënë se dorëshkrimet origjinale duhet të kenë përparësi, prandaj edhe për dorëshkrimin e akademik Ballatës mund të bisedojmë në një mbledhje të Kryesisë dhe të marrim vendim.

Gjatë shqyrtimit të shkallës së realizimit të Programit të punës të Seksionit të Shkencave Shoqërore, M. Kraja tha se te botimet e materialeve të aktiviteteve shkencore ka mangësi dhe gabime të cilat duhet të përmirësohen nga viti vijues. M. Limani në diskutimin e saj tha se dorëshkrimet e ASHAK-ut kanë mangësi serioze, të cilat i vëren, por nuk ka ku t'i adresojë, meqë nuk ka rregullore përkatëse. Ajo tha se duhet të hartohen me shpejtësi rregulloret për aktivitetet shkencore, për projektet dhe për revistat e ASHAK-ut.

M. Kraja propozoi që dorëshkrimet të cilat tani janë të gatshme të shkojnë në shtyp, ashtu siç janë, sepse nuk ka kohë

për përmirësime, por nga viti vijues kjo çështje të rregullohet. Propozimi u miratua njëzëri.

Në kuadër të pikës vijuese të rendit të ditës, Kryesia vendosi që materialet e aktiviteteve shkencore (tryeza, simpoziume, konferenca, etj.) të dorëzohen për shtyp gjashtë muaj pas mbajtjes së aktivitetit, në të kundërtën të hiqen nga plani botues, ndërsa për çështje të tjera të veprimtarisë botuese, të aktiviteteve shkencore dhe të projekteve u tha të pritët nxjerrja e rregulloreve përkatëse.

Më pas Kryesia caktoi grupin punues për hartimin e rregulloreve të ASHAK-ut për projektet shkencore, revistat shkencore dhe organizimin e aktiviteteve shkencore me këtë përbërje: Myzafer Limani, kryesuese, Eqrem Basha, Justina Pula, Fetah Podvorica, Luan Mulliqi dhe Lendita Pula, anëtarë.

Po ashtu Kryesia vendosi që z. Zeni Ballazhi nga viti vijues të angazhohet në cilësinë e dizajnerit për dizajnimin e të gjitha botimeve të ASHAK-ut. Kryetari Kraja tha se dizajneri do të dizajnojë të gjitha botimet e Akademisë, duke bashkëpunuar me Këshillin botues të ASHAK-ut, si dhe të bartë më pas ekzekutimin e punimeve të zyrtarët kompetentë të ASHAK-ut.

Në kuadër të pikës vijuese kryetari Kraja tha se dorëshkrimi "Bashkësi gjuhësore, njësi varietet" nuk është paraqitur me kohë nga sekretari i

Seksionit të GJL-së që të përfshihet në kontratën e botimit të librave për vitin 2019. Duke pasur parasysh se dorëshkrimi është original, i rëndësisë së veçantë dhe se zëvendëson një tjetër botim që është përfshirë në kontratë dhe nuk është i gatshëm, propozoi që të shkojë në shtyp. Propozimi u miratua.

Në vazhdim Kryesia:

- U njoftua nga L. Pula, se punonjësesh të IZUM-it i vazhdohet kontrata edhe për vitin 2020, sipas marrëveshjes ASHAK-IZUM;

- Mori vendim për pagimin e shpenzimeve të telefonisë mobile për vitin 2020.

Në fund u miratuan këto raporte të udhëtimeve zyrtare:

- Raporti i Jusuf Bajraktarit dhe Frashër Demajt për qëndrimin e tyre në Tiranë, në ASHSH, me qëllim të pjesëmarrjes në Konferencën shkencore ndërkombëtare "Shqiptarët dhe Koalicioni Antifashist në Luftën e Dytë Botërore" kushtuar 75-vjetorit të fitores së LANÇ-së, mbajtur më 13 nëntor 2019;

- Raporti i qëndrimit të Kryesisë së ASHAK-ut dhe L. Pulës në Tiranë, në ASHSH, më 6-8 nëntor 2019;

- Raporti i anëtarëve të Akademisë dhe punonjësve të saj për qëndrimin në

Tiranë prej datës 14-16 nëntor 2019 me qëllim të pjesëmarrjes në Panairin e librit Tirana 2019.

Njëherësh në kuadër të po kësaj pike të rendit të ditës kryetari Kraja propozoi që, me qëllim të transparencës, anëtarët e Akdemisë të njoftohen me vendimet e Kryesisë. Njoftimin ta bëjnë sekretarët e seksioneve në mbledhjet e tyre.

15. . Mbledhja e fundit e Kryesisë XXVIII për vitin 2019 u mbajt më 24 dhjetor. Në të Kryesia e shqyrtoi dhe e miratoi njoftimit për opinionin publik për procesin “Minishengeni ballkanik”.

U tha që njoftimi t’u dërgohet mediave dhe anëtarëve të Akademisë.

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTE

1. Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe. – Vazhdimi i punës së Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, që është edhe më tutje në programin e bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH, i përfshirë edhe në Protokollin për Zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor midis dy akademive për periudhën 2018/2020, është konfirmuar edhe në takimin e dy kryesive (ASHAK dhe ASHSH) me 7 nëntor 2019. Në këtë takim është kërkuar që veprimtaria e Këshillit të jetë e vazhdueshme dhe të

kërkohej riformatimi për shkak se një pjesë e anëtarëve të tij janë tërhequr ose nuk jetojnë më. Puna e Këshillit në të vërtetë ka stagnuar, edhe pse konsiderohej se kishin mbetur shumë çështje për t’u diskutuar. Në planifikimin e vitit të kaluar patëm parashikuar përgatitjen e materialeve për botimin, i cili nuk u realizua pikërisht për shkak të këtyre ngecjeve dhe reformimit të ASHSH-së.

2. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. – Projekti kishte paraparë finalizimin e punës rreth Leksikut të përveçëm të revistës “Përparimi” 1955-1968. Dorëshkrimi i gatshëm për shtyp që në vitin 2018, doli në fillim të 2019-tës. Të kujtojmë se më 2016 nga ky projekt ishte botuar Fjalësi shqip i lematizuar i Fjalorit serbokroatisht-shqip të S. Dobroshit i vitit 1953. Skanimit, digjitalizimi i materialeve dhe puna rreth korpusit ka kërkuar angazhime të gjera, me specialistë të fushave dhe kompletimin e kushteve teknike. Tash që janë kapërcyer disa nga vështirësitë rreth aftësisimit teknik të Qendrës Leksikografike Enciklopedike, me sigurimin e skanerit me performanca të sofistikuar dhe vënien e tij në punë, gjatë vitit 2019 nuk u angazhua kuadri që do të merrej me drejtimin e punëve. Është konsideruar se puna duhet të vazhdohet në vitin 2020, gjë që do ta shpinte tutje këtë projekt afatgjatë.

3. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Përgatitja dhe botimi i veprës së albanologut austriak Norbert Jokl po i

afrohet përmbylljes, përkundër vështirësive në mbledhjen dhe sistemimin e materialeve, përkushtimin që të botohet paralelisht në shqip dhe në origjinalin gjermanisht. Deri tani kanë dalë tri vëllime: Studim për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip /Studien zur Albanischen Etimologie und Wortbildung, (2011), përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli dhe Studime historiko-krahasuese për gjuhën shqipe/Historisch-Vergleichende untersuchungen über das Albanische (2017) përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli dhe prof. dr. Heiner Eichner nga Akademia Austriake, si dhe vëllimi i tretë që doli në fillim të 2019-tës, Gjurmime linguistike-historike-kulturore në fushë të shqipes, Linguistisch-Kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen, përkthyer nga Skënder Gashi. Kontakti me Akademinë e Shkencave të Austrisë me të cilën kemi bashkëpunuar deri tash do të na ndihmojë në mbledhjen, sistemimin dhe botimin e kontributeve të tjera të Joklit, që do të përmbledhen në vëllimin e katërt dhe të fundit.

4. Korpusi i shqipes së folur në Kosovë. Projekti i krijimit të një korpusi të folur të shqipes në Kosovë, që nënkupton mbledhjen e materialeve gjuhësore të folura nëpër të gjitha viset e Kosovës dhe që u shërben studiuesve në fushë të gjuhësisë në radhë të parë, por edhe në fusha të tjera, si antropologjia e sociologjia, u iniciua nga fundi i vitit 2017 dhe u inkadrua në programin e vitit 2018. Ekziston një program i detajuar, i dorëzuar kur bëhej gati

programi i punës së Seksionit për vitin 2018. Korpusi shërben për matje kuantitative në fushën e fonetikës e të fonologjisë, të morfologjisë e të sintaksës si dhe të leksikut e të sociolinguistikës. Materialet e mbledhura do të klasifikohen sipas zonave, statuseve shoqërore, moshës, shkollimit, gjinisë dhe do të transkriptohen për lehtësim studimi. Deri tash, në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë dhe të Universitetit të Humboldt (Berlin) ka pasur trajnime kuadri të angazhuar në këtë projekt. Një pjesë e tij janë dërguar në Berlin. Vazhdon puna në terren me intervista dhe me mbledhjen e materialeve si dhe me sistemimin e tyre.

5. Leksikonët e termave të gjuhësisë. - Është inkadruar në programin e punës të vitit 2018. Rëndësia e projekti qëndron para së gjithash në shpjegimin dhe interpretimin e termave të gjuhësisë. Leksikonët do të shërbejnë si mjet i rëndësishëm për studentët, studiuesit dhe të interesuarit e tjerë. Parashihen të realizohet sipas fushave: a. Fonetikë dhe fonologji; b. studime sociolinguistike dhe gjuhësi e tekstit; c. gramatikë. Fjalorët e fushave të veçanta janë autorialë, ndaj edhe botohen veç e veç për çdo fushë. Bartës të projektit janë Rexhep Ismajli dhe Bardh Rugova. Nga mesi i vitit 2019, ashtu siç ishte paraparë, ka dalë nga shtypi Leksikoni i termave të fonetikës dhe të fonologjisë me autor anëtarin korrespondent Bardh Rugova. Gjatë kësaj kohe vazhdon puna rreth

finalizimit të fjalorit të studimeve sociolinguistike, që pritet të dorëzohet për shtyp brenda vitit 2020.

TUBIME SHKENCORE

1. Studimet albanistike në Itali, konferencë shkencore. Në vazhdimësi të dy konferencave shkencore Studimet albanistike në Amerikë, që u mbajt në vitin 2015 dhe Studimet për shqipen në vendet ku flitet gjermanisht, e realizuar gjatë 2017-tës, pothuaj me distancë të njëjtë kohore, u realizua konferenca shkencore Studimet albanistike në Itali me interes jo vetëm për praninë e arbëreshëve, për kulturën, letërsinë dhe studimet albanologjike dhe albanistike, por edhe për rezultatet e shumë studiuesve italianë të gjuhës shqipe në radhë të parë, por edhe të letërsisë, antropologjisë dhe kulturës shqiptare në përgjithësi. Konferenca u mbajt më 22 dhe 23 tetor, me një program të dendur me gjashtë seanca, në dy ditë të plota, në të cilën u parapanë 53 kumtesa dhe u paraqitën 46, prej të cilave 31 kumtesa të studiuesve jashtë Kosovës, me shumë sfida dhe probleme organizimi, por të cilat më në fund u kapërcyen me shumë mund dhe nuk ndikuan në mbarëvajtjen e Konferencës, e konsideruar e suksesshme, pothuaj në nivel të dy të tjerave para saj. Interesimi i madh i atyre që morën pjesë dhe rëndësia e kontributeve që sollën na shtojnë bindjen se aktivitete si ky e meritojnë të jenë pjesë e programeve të ASHAK-ut. Botimi i materialeve të Konferencës është

paraparë në programin e punës së Seksionit për vitin 2020.

BOTIME

1. Romani shqiptar, fillimi i shekullit XXI. - Materialet e Konferencës shkencore që u mbajt në mjediset e ASHAK-ut në Prishtinë më 10 tetor 2018, organizuar nga ASHAK dhe ASHSH si pjesë e Protokollit për bashkëpunim midis dy akademive. Konferenca ftoi kritikë, studiues e dijetarë të letërsisë për të vështruar romanin e fillimit të shekullit XXI, dy dekadat e para, që konsiderohet boshti më dinamik i zhvillimit të tij. Përgatitja e materialeve për botim, 17 kumtesa në dorëshkrimin prej 218 faqesh, u realizua brenda limiteve të parapara kohore dhe libri doli në pjesën e parë të vitit 2019.

2. Materialet e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe. - Me Protokollin për Zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor midis ASHAK dhe ASHSH për vitet 2018/2020 ishte paraparë që Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe të përgatiste për botim aktet e veprimtarisë së këtij Këshilli. Ishte paraparë gjithashtu që botimi i këtyre materialeve, që tashmë janë mbledhur, të përfundonte brenda 2019-tës, por nuk u finalizuan për shtyp për shkak të pritjes së riorganizimit dhe riformatimit të këtij Këshilli (pas përfundimit të periudhës së reformimit të ASHSH-së), i cili do të jepte dritën jeshile.

3. Bardh Rugova, Leksikoni i termave të fonetikës dhe të fonologjisë. – Libri i parë nga Projekti Leksikonët e termave të gjuhësisë, me autor anëtarin korrespondent Bardh Rugova, me mbi 500 terma-njësi, në një vëllim prej rreth 260 faqesh, ka dalë nga shtypi, siç ishte paraparë, në fund të qershorit të vitit 2019. Libri, i recensionuar nga akademik Rexhep Ismajli dhe anëtari korrespondent Mehmet Halimi, është vepër autoriale, hartuar në formë leksikoni, me artikuj të veçantë. Promovim i tij u realizua në ASHAK me 3 dhjetor 2019.

4. Kujtim Shala, Ut heri dicebamus. - Dorëshkrimi që ka për objekt trajtimin veprën e Zef Pllumit, me disa kapërcime të çështjes së kulturës e të jetës sociale të shqiptarëve, që librit i jep status monografie, u dorëzua dhe u përgatit për shtyp në terminët e paraparë me Programin e punës së Seksionit për vitin 2019. I recensionuar nga akademik Ali Aliu dhe akademik Zejnullah Rrahmani, libri me një vëllim 212 faqesh doli nga shtypi nga mesi i nëntorit të vitit 2019.

5. Rexhep Ismajli, Bashkësi gjuhësore, njësi, varietet. - Dorëshkrim me rreth 520 faqe, i recensionuar nga Bardh Rugova e Mehmet Kraja dhe i miratuar për shtyp nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, doli nga shtypi në ditët e fundit të dhjetorit 2019. Libri trajton probleme që kanë të bëjnë me gjuhën standarde dhe realitetin gjuhësor. Është një përmbledhje artikujsh rreth një boshti sociolinguistik, disa nga të

cilët janë paraqitur në Konferenca e revista shkencore, por që pjesa më e madhe e tyre botohen për herë të parë.

6. Tregime të zgjedhura. – Katër vëllime me tregime të zgjedhura të shkrimtarëve anëtarë të ASHAK-ut: Anton Pashku, Eqrem Basha, Mehmet Kraja dhe Zejnullah Rrahmani, ishin paraparë të botoheshin që në vitin 2018, por për shkak të çrregullimeve në financimin dhe ndërhyrjeve të botimeve të tjera të papapara në planin botues të ASHAK-ut u shtynë për më vonë. Dorëshkrimet e finalizuara dolën nga shtypi nga mesi i muajit dhjetor 2019.

7. Revista “Studime” nr. 26. – Nr. 25 i revistës “Studime”, që boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, me kryeredaktor akademik Zejnullah Rrahmanin, ka dalë prej shtypi nga mesi i vitit 2019 me një vëllim rreth 540 faqesh pasi fillimisht ishte prezantuar në web-faqen e Akademisë për shkak të çrregullimeve në ritmin e botimeve. Në kohën e hartimit të këtij raporti të punës së Seksionit për vitin 2019 është duke përfunduar numri 26 i revistës, që parashihet të dorëzohet për shtyp në 2-3 muajtë e parë të këtij viti.

* * *

Në fillim të vitit 2019 kanë dalë nga shtypi disa nga botimet e mbetura nga viti 2018 për shkak të çrregullimeve në ritmin e realizimit të planit botues dhe problemeve financiare: Norbert Jokl, Gjurmime linguistike historike-

kulturore...; pastaj Studime albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, materialet e Konferencës shkencore të mbajtur në tetor të vitit 2017, si dhe libri i Kujtim Shalës, Identiteti i pa/zbuluar, që gjithashtu i takonin Programit të punës për vitin 2018. Një paraqitje e tyre është bërë në Raportin e punës për vitin 2018, duke i paraprirë daljes nga shtypi, meqë dorëshkrimet tashmë ishin dorëzuar dhe një pjesë e tyre ishin paraqitur në web-faqen e Akademisë. Në këtë kohë është botuar edhe numri 25 i revistës shkencore “Studime”.

PËRURIME

1. Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, më 11 prill 2019 është përruar libri i Sabri Hamitit Testamenti, botuar nga SGJL i ASHAK-ut më 2018. Për këtë botim dhe për vëllimin me poezi Kukata e Sokratit folën Ali Aliu, Rexhep Ismajli, Nusret Krasniqi dhe Muhamet Hamiti. Testamenti ishte promovuar edhe në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë më 14 dhjetor 2018, ku kishin folur Floresha Dado, Bashkim Kuçuku, Nysret Krasniqi, Dhurata Shehri, Kastriot Gjika dhe Mark Marku.

2. Më 12 qershor 2019 në Institutin për Kohën e Re dhe Hulumtimin e Historisë Bashkëkohore (Institut für Neuzeit und Zeitgeschichtsforschung Forschungsbereich Balkanforschung) të Akademisë Austriake të Shkencave, në Sektorin e hulumtimeve për Ballkanin u përruan tri botime të

Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të ASHAK-ut: Wilfried Fiedler, Gramatikë e krahasuar e gjuhëve të Ballkanit I. Krahasim morfolo-gjik-tipologjik i shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit/ Vergleichende Grammatik der Balkansprachen.

Morphosyntaktisch-typologischer Vergleich des Albanischen mit den anderen Balkansprachen, Prishtinë 2018; Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht / Albanistische Forschungen in den deutschsprachigen Ländern, Aktet e Konferencës ndërkombëtare shkencore të mbajtur në Prishtinë në organizim të ASHAK-ut dhe ASHSH-së, Prishtinë 2018 dhe Norbert Jokl: Gjurmime linguistike-historike-kulturore në fushën e shqipes / Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereich des Albanischen (1923), gjermanisht e shqip me përkthim të Skender Gashit, Prishtinë 2018. Promovimin e drejtoi O. Schmitt, ndërsa për botimet folën R. Ismajli, W. Fiedler, H. Eichner dhe E. Basha. Në fund u zhvillua një diskutim i gjerë.

3. Më 3 dhjetor 2019 në mjediset e ASHAK-ut u përruan dy botime të reja të Seksionit: Identiteti i pa/zbuluar i Kujtim Shalës dhe Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë i Bardh Rugovës. Për librin e K. Shalës foli prof. dr. Nysret Krasniqi nga Fakulteti Filologjik i UP-së, ndërsa për atë të Bardh Rugovës, akademik Rexhep Ismajli. Përrimin e drejtoi akademik Ali Aliu.

IN MEMORIAM

1. Më 13 shkurt 2019 u nda nga jeta në moshën 102 vjeçare akademik Idriz Ajeti, gjuhëtar e intelektual, pedagog e veprimtar i shquar, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që në ditët e para dhe kryetar i saj në dy mandate. ASHAK, që organizoi përcjelljen dhe homazhet, mbajti mbledhje komemorative në të cilën për jetën dhe veprën e akademik Ajetit foli akademik Rexhep Ismajli, ndërsa në varrimin e tij fjalën lamtumirëse e mbajti akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar i ASHAK-ut.

2. Më 18 shkurt, në moshën 89-vjeçare vdiq albanologu i shquar amerikan, anëtar i jashtëm i ASHAK-ut, Eric Pratt Hamp. Seksioni bëri njoftimet për media dhe shpërndau biografinë dhe bibliografinë e tij.

3. Më 11 shtator 2019 u nda nga jeta studiuesi dhe profesori i nderuar gjerman Wilfried Fiedler, anëtar i jashtëm i ASHAK-ut, njëri nga albanologët më të shquar të kohës sonë. Me këtë rast ASHAK mbajti mbledhje komemorative në të cilën për jetën dhe veprën e prof. Fiedler-it foli akademik Rexhep Ismajli.

Sekretari i Seksionit,

Akademik Eqrem Basha, d.v.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

PROJEKTE

1. Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës. - Tablloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale. - Projekt afatmesëm, faza vijuese.

Gjatë vitit 2018, si dhe gjatë vitit 2019, ka vazhduar puna e fazës së dytë të mbledhjes së materialit për vendbanimet rurale të Kosovës. Është hartuar tashmë modeli në formë të udhëzimit - pyetësorit, si një nga instrumentet kryesore të hulumtimeve në terren për sigurimin e të dhënave burimore dhe origjinale shkencore-enciklopedike mbi vendbanimet e Kosovës në përgjithësi. Gjatë këtij viti është mbajtur një punëtori dhe është bërë punë intensive me shumë ekspertë dhe shkencëtarë të ndryshëm. Është botuar Vëllimi II i projektit dhe vazhdon aktiviteti për Vëllimin III.

Raporti për projektin është dorëzuar dhe është miratuar në mbledhje të rregullt të Seksionit.

2. Hasan Prishtina në prizmin e dokumenteve arkivore. - Projekt afatmesëm.

Gjatë vitit 2019 ka vazhduar puna në këtë projekt dhe deri më tani janë bërë hulumtime në disa arkiva si: Arkivi i Kosovës, Arkivi i Shtetit Shqiptar, Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, Arkivi i

Instituti i Historisë në Prishtinë, Arkivi Nacional në Londër (The National Archives) dhe do të vazhdohet me hulumtime në arkivat tjera që posedojnë fonde për veprimtarinë e Hasan Prishtinës.

3. Matja e ekonomisë informale në Kosovë dhe përcaktuesit e saj. - Projekt njëvjeçar.

Bartëse e projektit: Justina Shiroka Pula, anëtare korrespondente.

Projekti ka përfunduar. Raporti për fazën I është miratuar në Seksion dhe në Kryesi. Në këtë raport është prezantuar realizimi i hulumtimit në terren, procesimi i të dhënave në SPSS dhe analiza e të dhënave statistikore, të cilat kanë dalë nga punëtorja (tryeza) e mbajtur nga ekipi i projektit në prill 2019. Në këtë raport është vendosur edhe për realizimin e pagesave për anketuesit e hulumtimit në terren dhe koordinatorin e të dhënave nga terreni.

Faza II përfshin punëtorinë (tryezën) e diskutimit me akterë relevantë, e cila është mbajtur në qershor 2019. Në të janë prezantuar rezultatet preliminare, përgatitja dhe finalizimi i draftit final të raportit hulumtues, etj. Raporti përfundimtar bashkë me draftin final, si dhe të dhënat për realizimin e obligimeve materiale për bashkëpunëtorët dhe udhëheqësit e projektit është miratuar në Seksion dhe në Kryesinë e Akademisë.

Faza III përfshin punëtorinë (tryezën) përmbyllëse të projektit, ku është

prezantuar drafti final i raportit hulumtues.

Në të kanë marrë pjesë akterë relevantë dhe janë diskutuar të gjitha sfidat e ekonomisë dhe përcaktuesit e ekonomisë informale (ekonomia në hije).

4. Lidhja e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1879-1881). - Projekt dyvjeçar.

Edhe gjatë vitit 2019 projekti vazhdon me hulumtime të dokumenteve për ta pasqyruar edhe qëndrimin e vetë Austro-Hungarisë dhe të vendeve të tjera ndaj çështjes shqiptare.

BOTIME

1. Projekti “Leksikoni Vendbanimet e Kosovës - Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale, Vëllimi II, A-LL” ka dalë nga shtypi në shtator të vitit 2019. Libri përfshinë 737 vendbanime rurale (fshatra), të prezantuara sipas alfabetit nga shkronja A-LL në gjithsej 730 faqe. Përkujtimi i tij është bërë në mjediset e ASHAK-ut me 24.9.2019, në prani të bashkëpunëtorëve të projektit, anëtarëve të Akademisë, punonjësve të shkencës, të kulturës dhe të interesuarve të tjerë.

2. Pas përfundimit me sukses të punëve të parapara në projektin “Matja e ekonomisë informale në Kosovë dhe përcaktuesit e saj” ka rezultuar përgatitja e dorëshkrimit të raportit hulumtues në vëllim të veçantë me

titull “Analiza e Ekonomisë në hije në Kosovë”. Dorëshkrimi në gjuhën shqipe dhe atë angleze është botuar.

3. “Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit”. - Simpozium shkencor ndërkombëtar (i mbajtur me 17. 5. 2018). Dorëshkrimi me kontributet autoriale të simpoziumit është botuar.

4.” Lidhja Shqiptare e Prizrenit (140 vjet mbas)”. - Konferencë shkencore ndërkombëtare (e mbajtur më 8-9. 6. 2018)). Dorëshkrimi me kontributet autoriale të konferencës është botuar.

5 “Filozofia dhe teatri: raportet e teatrit bashkëkohor me teatrin modern”. - Simpozium shkencor ndërkombëtar (i mbajtur me 17.10. 2018). Dorëshkrimi me kontributet autoriale të simpoziumit është botuar.

6. ”Sistemi i arsimit, tregu i punës dhe zhvillimi ekonomik: sfidat dhe perspektivat”. - Konferencë shkencore ndërkombëtare (e mbajtur me 26-27.10.2018). Dorëshkrimi me kontributet autoriale të konferencës është botuar në tetor të vitit 2019. Botimi përfshinë gjithsej 367 faqe dhe 20 punime (autorë me bashkautorë).

7. Revista “Studime shoqërore”, nr. 6. - Revista është botuar.

Sekretare e Seksionit

Anëtare korrespondente Justina Sh. Pula, d. v.

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE

1. Huluntim mbi mundësitë e rishfrytëzueshmërisë së brezeve të reja frekuencore UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela në territorin e Kosovës, paraqitur nga anëtare korrespondente Myzafer Limani, projekt 2-vjeçar. Ky projekt është në kuadër të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve. Sipas planifikimit në kornizën kohore të projektit, gjatë vitit 2019 është përfunduar faza e hulumtimit teorik të modeleve që do të përdoren, është bërë shqyrtimi i publikimeve shkencore të kësaj fushe si dhe studimi i databazave ekzistuese të realizuara në disa vende evropiane dhe botërore, të cilat tani më kanë filluar shfrytëzimin e brezit frkeuncor të TVWS për operimin e rrjeteve heterogjene kognitive pa tela. Nga shqyrtimet dhe hulumtimet teorike, në kuadër të projektit janë publikuar dy punime shkencore, një në revstën Research të ASHAK dhe një në konferencen ndërkombëtare “mmWave in Vehicular Networks: Leveraging Traffic Signals or Beam Design” 2019 IEEE 20th International Symposium on “A World of Wireless, Mobile and Multimedia Networks”, Washington, SHBA.

Raporti i projektit është përgatitur dhe është miratuar në mbledhjen e rregullt të Seksionit më 19 dhjetor 2019.

2. Modifikimi i sipërfaqes së qymyrit me shtresa të holla organike, i paraqitur nga anëtari korrespondent Fetah Podvorica, projekt 2-vjeçar. Ky projekt është në kuadër të fushës së kimisë së materialeve. Qëllimi kryesor i projektit është veshja e sipërfaqes së qymyrit me molekula organike që përmbajnë grupe alkile ose arile, të cilat pastaj e mundësojnë rritjen e performancës së membranave asimetrike heterogjene në ndarjen e substancave të ndryshme. Projekti është zhvilluar deri më tani sipas dinamikës së paraparë për këtë vit. Raporti i projektit është përgatitur dhe është miratuar në mbledhjen e rregullt të Seksionit më 19 dhjetor 2019.

BOTIME

1. Qamil Haxhibeqiri. - Fibracionet, libri ka dalë nga shypi.

2. Komforti termik i akademik Fejzullah Krasniqi dhe prof. dr. Rexhep Selimajt. - Dorëshkrimi është dorëzuar dhe po vazhdojnë procedurat e përgatitjes së tij për shtyp.

3. Materialet kompozitë, kontributet autoriale të Tryezës shkencore. - Dorëshkrimi është botuar.

4. Revista "Resarch-Kërkime" nr. 24. - Dorëshkrimi është botuar.

PËRURIME

Më 18 dhjetor në sallën e Akademisë, në praninë e anëtarëve të Akademisë,

profesorëve universitarë dhe të mysafirëve të shumtë është bërë përrurimi i librit të anëtarit korrespondent Qamil Haxhibeqirit: "Fibracionet". Fjalën e hapjes e mbajti sekretari i Seksionit, anëtari korrespondent Fetah Podvorica, ndërsa për librin foli profesor dr. Minir Efendia. Në fund të pranishmit i përshëndeti edhe vetë autori, i cili e falënderoi Seksioni e SHN-së dhe Akademinë për mbështetjen, si dhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë përrurim

Sekretari i Seksion

Anëtar korrespondent Fetah Podvorica,
d. v.

SEKSIONI I ARTEVE

EKSPOZITA

1. Ekspozitë me veprat e akademik Agim Çavdarbashës. - Ekspozita u hap më 25 tetor 2019 në mjediset e Akademisë. Fjalën e hapjes e mbajti anëtar korrespondent Luan Mullqi, sekretar i Seksionit të Arteve, ndërsa për Ekspozitën foli akademik Eqrem Basha, kurator i saj.

Në Ekspozitë u përfshinë punime të cikleve të ndryshme të krijimtarisë së autorit. Në të përveç anëtarëve të Akademisë morën pjesë edhe një numër i madh i artdashësve.

Gjatë kohës sa ishte e hapur (deri më 18 nëntor) kishte vizitorë të shumtë.

KONCERTE

1. Koncert për nder të 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës. - Koncerti i përgatitur nga akademik Zeqirja Ballata u mbajt më 14 qershor 2019 dhe u realizua me sukses.

Në të u ekzekutuan vepra muzikore e poetike të autorëve mbarëkombëtarë dhe të huaj.

Pjesëmarrësit: Çun Lajçi, Armando Likaj, Melos Buza, Blerim Grubi, Ariana Grubi, Shpend Ballata, Lirika Pula - Kasapolli, Sihana Badivuku - Basha dhe Zana Basha ofruan për të pranishmit momente të këndshme artistike.

Në Koncert morën pjesë anëtarë të Akademisë dhe të ftuar të shumtë.

2. Koncert solemn me vepra të akademik Rauf Dhomit. - Koncerti u mbajt më 16 dhjetor dhe u realizua me sukses. Në një atmosferë festive, veprat e akademik Dhomit u ekzekutuan dhe u interpretuan nga artistë të njohur nga Kosova dhe jashtë saj. Përveç anëtarëve të Akademisë ishin të pranishëm edhe mysafirë të shumtë.

Sekretari i Seksionit,
Anëtar korrespondent Luan Mulliqi,
d.v.

SHËRBIMI PROFESIONAL, ADMINISTRATIV E TEKNIK

Shërbimi Administrativ, Profesional e Teknik (SHPAT) i ASHAK-ut, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale, administrative e teknike u angazhua dhe punoi në realizimin e Programit të punës të Akademisë.

DEPARTAMENTI PËR BUXHET DHE FINANCA – DBF

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019 për ASHAK-un ishte në vlerë totale prej 1.356.427,00 €. Në kategorinë paga e mëditje janë 884.484,00 €, në kategorinë mallra e shërbime 404.943,00 €, në kategorinë shpenzime komunale 5.000,00 € dhe në kategorinë e shpenzimeve kapitale 62.000,00 €.

Përpos mjeteve nga Fondi i Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, ASHAK-u ka pasur depozita mjeteve të bartura nga viti 2018 nga donatori Salbatring International dhe nga Instituti i Shkencave të Informacionit (IZUM), Maribor-Sloveni.

- Vlera totale e mjeteve të donatorit Salbatring Internacional për vitin 2019 ishte 8.636,99 €.

Nga këto mjete 4.636,00 € ishin planifikuar për blerjen e librave dhe 4.000,00 për ndarjen e Çmimit stimulues nga lëmi i shkencave të

natyrës. Mjetet e donacionit nuk janë shfrytëzuar.

- Vlera totale e mjeteve të IZUM-it ishte 5.500,00 €. Këto mjete janë shfrytëzuar për pagesën e punonjësës së angazhuar për programin COBIS.

Në fund të vitit 2019 Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendime për shkurtime të mjeteve buxhetore (Vendimi nr.02/113 i datës 5.11.2019, kursime 2.250,00 € në kategorinë e shpenzimeve komunale). Buxheti përfundimtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës për vitin 2019, pas ndryshimeve të shkaktuara nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, ishte në vlerë totale prej 1.291.292,04 €. Në kategorinë paga e mëditje ishin 821.599,04 €, në kategorinë mallra e shërbime 404.943,00 €, në kategorinë shpenzime komunale 2.750,00 € dhe në kategorinë e shpenzimeve kapitale 62.000,00 €.

Nga shitja e botimeve ASHAK-u gjatë vitit 2019 ka grumbulluar të hyra qeveritare në vlerë prej 10.026,65 €.

DEPARTAMENTI I PÛRKRAHJES PROFESIONALE DHE I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT E KOMUNIKIMEVE - DPPTIK

Departamenti i Përkrahjes Profesionale dhe i Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve – DPPTIK i ASHAK-ut, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve

profesionale të teknologjisë së informacionit e komunikimeve dhe të veprimtarisë botuese përpunoi rreth 694 tabakë shtypi (10.542 faqe) dhe organizoi botimin e 34 titujve të librave e publikimeve me rreth 8,710 kopje duke realizuar planin plotësisht (të gjitha dorëshkrimet e paraqitura sipas programit janë përpunuar dhe shtypur e botuar).

DPPTIK-u ndërlidhur me veprimtarinë botuese, aktivitetet e së cilës i përkrahu drejtpërsëdrejti dhe për shërbimet e tjera teknike ia doli të angazhojë 61.662% ose 287.679,77 € të të gjithë buxhetit të ASHAK-ut (404.943 € + 62.000€) në kategorinë mallra e shërbime dhe në kategorinë shpenzime kapitale.).

DPPTIK-u:

- Përkrahu profesionalisht punën e anëtarëve të Akademisë dhe të Administratës. Në bashkërenditje me shërbimet e tjera të ASHAK-ut, DPPTIK-u përkrahu profesionalisht drejtpërsëdrejti 20 (njëzet) aktivitete të Akademisë (konferenca, tubime, tryeza shkencore, ekspozita, koncerte, nënshkrime marrëveshesh, takime mes akademike, ndarje shpërblimesh, panairë librash, ligjërata, mbledhje komemorative etj.);

- Përgatiti specifikimet teknike dhe inicoi 13 aktivitete prokurimi, gjegjësisht 43.33% të të gjitha kërkesave të prokurimit të ASHAK-ut dhe menaxhoi 6 kontrata afatgjata dhe

kontratat e tjera të cilat kishin të bëjnë me aktivitetet e DPPTIK-ut;

- Përkrahu profesionalisht projektin Shqipja e shkruar e shek. XX dhe projektin Vendbanimet e Kosovës;

- Realizoi projektin e Sistemit të Zërimit të ASHAK-ut dhe certifikoi stafin për përdorim të sistemit;

- Me përpjekje të vazhdueshme për ndërtimin dhe mbindërtimin e kapaciteteve lokale profesionale zbatoi metodat e përkrahjes së drejtpërdrejtë dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe të baraspeshuar me anëtarët e Akademisë dhe me departamentet e tjera, si edhe me operatorët ekonomikë të jashtëm, duke e përmirësuar dhe ngritur vazhdueshëm cilësinë e shërbimeve teknike profesionale dhe të shërbimeve të tjera të përkrahjes profesionale;

- Vazhdoi me organizimin dhe rregullimin e depozitave të Librit si dhe të materialit tjetër harxhues të nevojshëm për funksionimin normal të Administratës dhe Akademisë;

- Mbikëqyri dhe u përkujdes për funksionimin normal të shërbimeve të TIK-ut dhe multimediale, si dhe për funksionimin normal të faqes ueb duke e populluar atë me të dhënat e përditësuara. Organizoi dhe mbikëqyri edhe mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të shërbimeve logjistike për Administratën dhe Akademinë;

- Vazhdoi të kontribuojë në standardizimin e mëtejshëm të bërjes së Librit të ASHAK-ut dhe përgatiti specifikimet teknike të produkteve të veçanta të nevojshme për punën e ASHAK-ut;

DPPTIK-u ndihmoi punën e QLE-së, duke vazhduar me skanimin e mijëra faqeve të librave dhe revistave të vjetra të parastandardit, të nevojshme për projektin Shqipja e shekullit XX dhe u kujdes për pasurimin e fondit të librit të QLE-së.

- Mori pjesë në të gjitha aktivitetet profesionale të Administratës dhe të ASHAK-ut: nëpër komisione profesionale, të rekrutimit, të pranimit të mallit, të përcaktimit të cilësisë etj;

- Përfundoi fazën e parë të riorganizimit të rrjetit strukturor kabllor;

- Përfundoi fazën e parë të riorganizimit të domenit dhe futjen në domenin e ASHAK-ut të stafit administrativ;

DPPTIK-ut iu shtuan dy zyrtarë: Zyrtari i TI-së për përkrahje dhe zyrtari i logjistikës, të cilët filluan punën në maj të vitit 2019.

DEPARTAMENTI I BIBLIOTEKËS DHE ARKIVIT - DBA

Gjatë vitit 2019 kanë vazhduar aktivitetet e rregullta që lidhen më

menaxhimin, mirëmbajtjen dhe riorganizimin e Bibliotekës së ASHAK-ut. Është aranzhuar dhe mirëmbajtur fondi bibliotekar dhe ka vazhduar regjistrimi i të gjithë librave ekzistues dhe atyre të blerë apo të pranuar si dhuratë në ndërkohë.

Biblioteka është pasuruar me një numër të konsiderueshëm botimesh (rreth 700) përmes blerjes, këmbimit dhe dhurimit nga autorët, si dhe është pasuruar me një numër të konsiderueshëm të revistave.

Në shkurt të vitit 2019 ka filluar aplikimi i sistemit COBISS i katalogimit dhe përpunimit bibliografik të fondit bibliotekar. Regjistrimi në sistemin COBISS është duke u kryer nga zyrtarja e DBA-së, e aftësuar dhe e licencuar nga Instituti i Shkencave të Informacionit (IZUM) nga Sllovenia për katalogimin elektronik të monografive (faza e parë) dhe zyrtarja e IZUM-it, e licencuar për katalogimin e monografive dhe revistave, si dhe krijimin e koleksioneve të bibliotekës dhe bibliografive.

Deri në fund të vitit 2019 janë futur në sistemin e bazës CobissKs rreth 1.700 monografi, ndërsa në bazën Conor rreth 1.200 regjistrime të termave të njësuar, si dhe katër seri dhe 873 artikuj. Sipas kalendarit të përcaktuar nga IZUM-i, nga fillimi i vitit 2020 regjistrimet e ASHAK-ut në sistemin COBISS do të jenë të qasshme në Katalogun Publik Elektronik OPAC

(Online Public Access Catalogue) - në CobissKs.

Me kërkesën e Kryetarit të ASHAK-ut akademik Mehmet Kraja, Biblioteka e Akademisë ka filluar realizimin e një projekti afatgjatë për identifikimin, gjetjen dhe mbledhjen e botimeve për Kosovën në gjuhët e botës, të cilat do të jenë pjesë e një koleksioni të veçantë të Bibliotekës. Projekti është paraparë të realizohet përmes një sërë veprimesh, përfshirë blerjen, këmbimin, dhurimin, fotokopjimin etj.

Në muajt e fundit të vitit 2019 janë identifikuar dhe janë ndarë 36 libra, që janë pjesë e fondit të Bibliotekës; janë identifikuar dhe përfshirë një regjistër botimesh në posedim të Bibliotekës së Kongresit Amerikan dhe janë blerë 23 libra me mjetet nga buxheti i ASHAK-ut.

Është arritur, në parim, një marrëveshje me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës (BKK) për lejin e fotokopjimit (për nevoja të brendshme të ASHAK-ut) të botimeve në gjuhë të huaja që janë në fondin e BKK-së. (BKK-së i është bërë kërkesa zyrtare me shkrim nga ASHAK-u, ndërsa BKK-ja është në pritje të përgjigjes nga Ministria e Kulturës për ta miratuar kërkesën.

Ka vazhduar pranimi i revistave të cilat ASHAK-u i merr rregullisht. Janë blerë pesë gazetë ditore ("Bota sot", "Epoka e re", "Koha ditore", "Kosova sot" dhe "Zëri") dhe janë regjistruar të gjitha shkrimet që lidhen me ASHAK-un,

përfshirë shkrime autoriale të anëtarëve të Akademisë. Në shumicën e rasteve materialet janë fotokopjuar.

Gjatë vitit 2019 në shtypin ditor janë regjistruar gjithsej 118 artikuj që lidhen me ASHAK-un.

“Koha ditore” 43 artikuj; “Zëri” 12 artikuj; “Kosova sot” 17 artikuj; “Bota sot” 22 artikuj; “Epoka e re” 24 artikuj.

Botimet e ASHAK-ut janë prezantuar në gjashtë panaire: Panairi i Prishtinës, Panairi i Tiranës, Panairi i Shkupit, Panairi i Frankfurtit, Panairi i Parisit dhe Panairi i Leibzingut. Në tri të parat botimet e ASHAK-ut janë prezantuar nga personeli i ASHAK-ut, ndërsa në Frankfurt e Paris nga Shoqata e Botuesve të Kosovës dhe në Panairin e Leibzingut nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës.

Panairi ndërkombëtar i librit "Salon du Livre de Paris", një nga ngjarjet më të madha të kësaj natyre në Evropë, është mbajtur në Paris nga data 15 deri më 19 mars. Sikurse në vitet e mëhershme, ASHAK-u ka autorizuar Shoqatën e Botuesve të Kosovës të prezantojë botimet e Akademisë. Botimet e ASHAK-ut (20 tituj) janë prezantuar në një stendë të përbashkët me botuesit kryesorë të Kosovës.

Panairi i Leibzingut

Në vitin 2019 Kosova ka marrë pjesë për herë të parë në Panairin e Librit në Leibzing, që njihet edhe si Panairi i

Autorëve dhe Evropës Lindore dhe Juglindore. Panairi është mbajtur nga data 21-24 mars. Në të janë prezantuar 16 botime të ASHAK-ut si pjesë e një prezantimi të botuesve kryesorë të Kosovës organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës.

Ka vazhduar komunikimi me biblioteka të akademive të ndryshme dhe me institucione kosovare e të vendeve të rajonit dhe më gjerë për të zgjeruar bashkëpunimin dhe këmbimin e botimeve.

Disa nga botimet e reja të ASHAK-ut u janë dërguar këtyre akademive: Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë, Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kroacisë, Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi, Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Bosnje e Hercegovinës, Akademisë së Shkencave të Bullgarisë, Akademisë së Shkencave të Hungarisë, Akademisë së Shkencave të Zvicrës, Akademisë së Shkencave të Austrisë.

Me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë dhe Qendrën për Studime Albanistike të Shqipërisë janë këmbyer shumica e botimeve të reja. Disa nga botimet e reja u janë dërguar anëtareve të jashtëm të ASHAK-ut, Bibliotekës Universitare dhe Bibliotekës së Qytetit të Strasburgut, Departamentit të Gjuhësisë së Universiteti Shtetëror të Pragës (pjesë

e të cilit është një katedër e re për studime të gjuhës dhe kulturës shqiptare).

Deri në gjysmën e vitit DBA u ka dërguar, sipas kërkesave, botimet e ASHAK-ut rreth 20 bibliotekave dhe institucioneve të ndryshme në Kosovë, Shqipëri dhe Luginë të Preshevës.

Ka vazhduar dërgimi i botimeve të ASHAK-ut për Bibliotekën e Kongresit Amerikan (BKA) përmes agjencisë Botimpex nga Tirana, e kontraktuar për identifikimin dhe mbledhjen e botimeve të reja në gjuhën shqipe në vendet e rajonit.

Në dhjetor është zhvendosur salla e leximit nga zyra 201 në 203 dhe në të janë vendosur rreth 80 rafte të reja.

Në mungesë të personelit të kualifikuar nuk ka pasur aktivitete që lidhen drejtpërsëdrejti me arkivimin. Megjithatë ka vazhduar vendosja e materialit arkivor në sallën e dedikuar për arkiv përmes një procedure të pranim-dorëzimit ndërmjet DBA-së dhe departamenteve përkatëse. ASHAK-u ka shpallur konkursin për një zyrtar të arkivit, është bërë përzgjedhja e kandidatit dhe pritet të fillojë punën gjatë muajit shkurt.

Shënim plotësues: Shënimet e SHPAT-së janë marrë nga drejtorët e departamenteve përkatëse.

Sekretare e Akademisë
Lendita Pula, d. v.

RAPORTI I PERFORMANCËS FINANCIARE PËR VITIN 2019

Mjetet e ndara dhe të aprovuara, sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2019, për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, kanë qenë në vlerë prej **1,356,427.00 €** si total në të gjitha kategoritë ekonomike. Buxheti me ndryshime gjatë vitit, sipas kategorive ekonomike, pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

Buxheti fillestar sipas Ligjit të Buxhetit është i pasqyruar si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investimet kapitale	Subvencionet dhe transferet	Gjithsej
884.484.00	404,943.00	5,000.00	62,000.00	0.00	1,356,427.00

Buxheti përfundimtar i alokuar është i pasqyruar si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investimet kapitale	Subvencionet dhe transferet	Gjithsej
821,599.04	404,943.00	2,750.00	62,000.00	0.00	1,291,292.04

Po ashtu në fund të vitit 2019 Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim për shkurtime të mjeteve buxhetore (Vendimi nr.02/115 i datës 5.11.2019, kursime në kategorinë paga e mëditje 62.884,96 € dhe në kategorinë e shpenzimeve komunale 2.250,00 €). Buxheti përfundimtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës për vitin 2019, pas ndryshimeve të shkaktuara nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, ishte në vlerë totale prej 1.291.292,04 €, nga të cilat në kategorinë paga e mëditje janë 821.599,04 €, në kategorinë mallra e shërbime 404.943,00 €, në kategorinë shpenzime komunale 2.750,00 € dhe në kategorinë e shpenzimeve kapitale 62.000,00 €.

BUXHETI I APROVUAR ME LIGJIN E BUXHETIT PËR VITIN 2019 ALOKIMI DHE REALIZIMI PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR

Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar 2019 (A)	Buxheti me Vendimin e Qeverisë (B)	Alokimet Janar – Dhjetor (C)	Realizimet Janar – Dhjetor (D)	% (D/C)
Paga dhe mëditje	884,484.00	821,599.04	821,599.04	821,599.04	100%
Mallra dhe shërbime	404,943.00	404,943.00	404,943.00	391,497.43	96.68%
Shpenzime komunale	5,000.00	2,750.00	2,750.00	2,738.25	99.57%
Investimet kapitale	62,000.00	62,000.00	62,000.00	51,790.00	83.53 %
Gjithsej	1,56,427.00	1,291,292.04	1,291,292.04	1,267,624.72	98.17%

Vlera fillestare sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2019 ka qenë 1.356.427,00 €, kurse buxheti i alokuar në të gjitha kategoritë ekonomike në fund të vitit 2019 ka qenë në vlerë totale prej 1.291.292,04 €.

Alokimet e mjeteve nga buxheti i konsoliduar i Kosovës sipas Planit të rrjedhës së parësë për periudhën janar – dhjetor 2019

Mjetet e alokuara në periudhën janar – dhjetor kanë qenë në vlerë prej **1.291.292,04 €**, ose e shprehur në përqindje 95.19% krahasuar me Ligjin e buxhetit për vitin 2019.

	janar- shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Gjithsej
Paga dhe mëditje	613,173.77	67,265.81	71,564.05	69,595.81	821.599.04
Mallra dhe shërbime	378,000.00	20,000.00	4,943.00	2,000.00	404,943.00
Shpenzime komunale	4,200.00	400.00	- 2.050.00	200.00	2,750.00
Shpenzimet kapitale	62,000.00	0.00	0.00	0.00	62,000.00
Gjithsej	1,057,373.37	87,665.81	74,457.05	71,795.81	1,291,292.04

REALIZIMI I BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2019

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit vjetor ka qenë **1.267.624,72 €**, shprehur në përqindje 98.17% i buxhetit të alokuar.

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim:

Kategoritë ekonomike	Alokimet Janar – Dhjetor (A)	Realizimi Janar – Dhjetor (B)	Ndryshimi (C)	% (B/A)
Paga dhe mëditje	821,599.04	821,599.04	0.00	100%
Mallra dhe shërbime	404,943.00	391,497.43	13.445.57	96.68%
Shpenzime komunale	2,750.00	2,738.25	11.75	99.57%
Shpenzimet kapitale	62,000.00	51,790.00	10.210.00	83.53%
Gjithsej	1,291,292.04	1,267,624.72	23.667,32	98.17%

Paga dhe mëditje

Mjetet e alokuara për paga dhe mëditje për vitin 2019 janë në vlerë prej **821.599,04 €**, shprehur në përqindje 92.89% i buxhetit të miratuar, ndërsa numri i aprovuar për personelin e ASHAK-ut është 55.

Alokimi

Kategoria ekonomike	janar - shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Gjithsej	%
Paga dhe mëditje	613,173.37	67,265.81	71,564.05	69,595.81	821,599.04	100.00%

Realizimi

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
Janar	55	67,660.35	67,660.5	67,660.5	0.00
Shkurt	55	67,738.09	67,738.09	67,738.09	0.00
Mars	55	67,738.09	67,738.09	67,738.09	0.00
Prill	55	67,738.09	67,738.09	67,738.09	0.00
Maj	55	68,187.18	68,187.18	68,187.18	0.00
Qershor	55	68,851.58	68,851.58	68,851.58	0.00
Korrik	55	71,387.05	71,387.05	71,387.05	0.00
Gusht	55	67,007.13	67,007.13	67,007.13	0.00
Shtator	55	66,865.81	66,865.81	66,865.81	0.00
Tetor	55	67,265.81	67,265.81	67,265.81	0.00
Nëntor	55	71,564.05	71,564.05	71,564.05	0.00
Dhjetor	55	69,595.81	69,595.81	69,595.81	0.00
Gjithsej	55	821,599.04	821,599.04	821,599.04	0.00

Mallra dhe shërbime

Mjetet e alokuar për mallra dhe shërbime për vitin 2019 janë në vlerë prej 404,943.00 €. Alokimi i mjeteve për mallra dhe shërbime për periudhën janar-dhjetor 2019 përbën 100.00 % të buxhetit të aprovuar.

Alokimi

Kategoria ekonomike	Janar - shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Gjithsej	%
Mallra dhe Shërbime	378,000.00	20,000.00	4,943.00	2,000.00	404,943.00	100%

Realizimi

Nr.	Muaji	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Zotim Obligimet e hapura (C)	Ndryshimi (A-B)
1	Janar	32,078.58	32,078.58	4,068.79	805,21	27,204.58
2	Shkurt	32,078.58	32,078.58	25,554.23	49,487.03	-42,962.67
3	Mars	70,000.00	70,000.00	50,517.15	-49,065.98	68548,.73
4	Prill	60,000.00	60,000.00	23,139.84	-1,226.25	38,086.41
5	Maj	40,000.00	40,000.00	51,624.92	0.00	-11,624.92
6	Qershor	38,000.00	38,000.00	37,367.04	0.00	632,96
7	Korrik	35,000.00	35,000.00	55,219.65	0.00	-20.219.65
8	Gusht	10,842.84	10,824.84	5,648.90	0.00	5,193.94
9	Shtator	60,000.00	60,000.00	15,389.19	0.00	44,610.81
10	Tetor	20,000.00	20,000.00	28,422.60	0.00	-8,422.60
11	Nëntor	4,943.00	4,943.00	27,926.31	0.00	-22,983.31
12	Dhjetor	2,000.00	2,000.00	66,618.81	0.00	-64,618.81
	Total	404,943.00	404,943.00	391,497.43	0.00	13.445,57

Shpenzimet për shërbimet komunale

Buxheti për shpenzime komunale për vitin 2019 është 5.000,00 €. Alokimi i mjeteve për shpenzime komunale për periudhën janar-dhjetor 2019 përbën 55% të buxhetit të aprovuar.

Alokimi

Kategoria ekonomike	janar-shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Gjithsej	%
Shpenzime komunale	4,200.00	400.00	-2.050.00	200,00	2.750,00	55%

Realizimi ¹

Nr.	Muaji	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
1	Janar	310.95	310.95	209.92	101.03
2	Shkurt	310.95	310.95	210.94	100.01
3	Mars	700.00	700.00	228.74	471.26
4	Prill	500.00	500.00	214.84	285.16
5	Maj	400.00	400.00	232.71	167.29
6	Qershor	500.00	500.00	237.88	262.12
7	Korrik	600.00	600.00	200.70	399.30
8	Gusht	400.00	400.00	0.00	400.00
9	Shtator	478.10	478.10	460.33	17.77
10	Tetor	400.00	400.00	248.47	151.53
11	Nëntor	-2.050.00	-2.050.00	253.66	-2303.66
12	Dhjetor	200.00	200	240.06	-40.06
	Gjithsej	2.750,00	2.750,00	2,738.25	11.75

Shpenzimet kapitale

Buxheti për shpenzime kapitale për vitin 2019 është 62.000,00 €. Alokimi i mjeteve për shpenzime kapitale për periudhën janar-dhjetor 2019 përbën 100% të buxhetit të aprovuar.

Kategoria ekonomike	Janar-Shator	Alokimi	Realizimi	Mjetet e lira	%
Shpenzimet kapitale	62.000,00	62.000,00	51.790,00	10.210,00	83,53 %
Gjithsej	62.000,00	62.000,00	51.790,00	10.210,00	83,53 %

Donacionet – Grantet e donatorëve

Alokimi

Emri i donatorëve	Totali i grantit	Alokimi	Realizimi	Mjetet e lira	%
Salbatring International	4,636.99	4,636.99	0.00	4,636.99	0.00 %
Salbatring International	4,000.00	4,000.00	0.00	4,000.00	0.00 %
Gjithsej	8,636.99	8,636.99	0.00	8,636.99	0.00 %

¹ Shpenzimet e komunalive nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, shpenzimet tjera komunale i mbulon Ministria e Administratës Publike

Përpos mjeteve nga Fondi i Buxhetit i Republikës së Kosovës, ASHAK, ka pasur donacionin e bartur nga viti 2018 të pranuar nga Salbatring Internacional në vlerë totale prej 8.636,99 euro, fond i cili për vitin 2019 ka qenë i ndarë në kategorinë e mallrave e shërbimeve për blerjen e librave në kodin 13510 në vlerë prej 4.636,99 € dhe në kategorinë e subvencioneve për ndarjen e çmimit stimulues - kodin 22200 në vlerë prej 4000,00 €.

Emri i donatorëve	Totali i grantit	Alokimi	Realizimi	Mjetet e lira	%
IZUM Slloveni	5,500.00	5,349.50	5,349.50	150,60	97.26 %
Gjithsej	5,500.00	5,349.50	5,349.50	150,60	97.26 %

ASHAK ka pasur donacionin e fituar në vitin 2019, të pranuar nga IZUM Sllovenia, në vlerë totale prej 5.500,00, fond i cili për vitin 2019 ka qenë i ndarë në kategorinë paga e mëditje për pagesën e zyrtares së bibliotekës për digjitalizimin e saj.

ASHAK ka realizuar edhe të hyra jotatimore në vlerë prej 10.026,65 € nga shitja e botimeve, të cilat janë depozituar drejtpërsëdrejti në llogarinë e Vetme të Thesarit për përdorim sipas paraqitjes së nevojave për paranë publike.

Realizimi i buxhetit në shkallën 98,17% tregon performancë jashtëzakonisht të mirë.

PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2020

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTE

1. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Botimi i veprës së plotë të albanologut austriak Norbert Jokl po i afrohet përmbylljes. Deri tani kanë dalë tri vëllime: Studim për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip /Studien zur Albanischen Etimologie und Wortbildung, (2011) përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli; Studime historiko-krahasuese për gjuhën shqipe / Historisch-Vergleichende untersuchungen über das Albanische (2017) përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli dhe Heiner Eichner nga Akademia Austriake dhe Gjurmime linguistike historike-kulturore në fushë të shqipes / Linguistisch-Kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen (2019) përkthyer nga Skënder Gashi dhe përgatitur nga Rexhep Ismajli e Heiner Eichner. Kontakti me Akademinë e Shkencave të Austrisë, me të cilën kemi bashkëpunuar deri tani, do të ndihmojë të vazhdohet projekti me mbledhjen, sistemin dhe botimin e kontributeve të tjera të Joklit, që do të përmbyllet edhe me një vëllim me studime, i cili do pak kohë për t’u përkthyer.

2. Korpusi i shqipes së folur në Kosovë.
- Projekti i krijimit të korpusit të folur të shqipes në Kosovë, që nënkupton

mbledhjen e materialeve gjuhësore të folura nëpër të gjitha viset e Kosovës dhe që u shërben studiuesve në fushë të gjuhësisë në radhë të parë, por edhe në fusha të tjera, si antropologjia e sociologjia, është iniciuar nga fundi i vitit 2017 dhe është inkuadruar në programin e vitit 2018. Krahas materialit të regjistruar, korpusi përfshin të dhënat (brendafolëse) të responentëve si: moshë, gjinia, shkollimi, profesioni, njohja e gjuhëve të tjera, lëvizja nga vendbanimi dhe kontaktet me të folme të tjera. Ekziston dhe një program i detajuar i dorëzuar që kur u planifikua programi i punës së Seksionit për vitin 2018. Korpusi shërben për matje kuantitative në fushën e fonetikës e të fonologjisë, të morfologjisë e të sintaksës si dhe të leksikut e të sociolinguistikës. Materialet e mbledhura klasifikohen sipas zonave, statuseve shoqërore, moshës, shkollimit, gjinisë dhe mund të transkriptohen për lehtësim studimi. Deri tash, në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës dhe me Universitetin e Humboldt (Berlin), ka pasur trajnim të kuadrit që po angazhohet në këtë projekt. Janë realizuar mbi 300 intervista, të cilat janë transkriptuar në Berlin. Ndërkohë është kompletuar tërë zona e Mitrovicës dhe ajo e Shtimes. Për vitin 2020 pritet vazhdimi i punës, mbledhja dhe transkriptimi i zonave që nuk arrijnë të realizohen brenda vitit 2019.

3. Leksikonët e termave të gjuhësisë. - Krijimi i fjalorëve (leksikonëve) me vështirësi enciklopedik të gjuhësisë, duke e pasur në rend të parë gjuhësinë shqiptare, do të ndihmonte për normëzimin e terminologjisë së gjuhësisë në gjuhën shqipe, thuhej në fillim në prezantimin e këtij projekti të inkuadruar në programin e punës për vitin 2018. Rëndësia e tij do të ishte, para së gjithash, shpjegimi dhe interpretimi i termave të gjuhësisë. Duke i pasur brenda vetes termat e fushave të ndryshme të gjuhësisë, leksikoni do të shërbente si mjet i rëndësishëm për studentët, studiuesit dhe të interesuarit e tjerë. Realizohet sipas fushave: a. fonetikë, b. studime sociolinguistike dhe gjuhësi e tekstit, c. gramatikë. Fjalorët e fushave të veçanta janë autorialë, ndaj edhe botohen veç e veç për çdo fushë. Bartës të projektit janë Rexhep Ismajli dhe Bardh Rugova. Në këtë fazë ka përfunduar dhe është dorëzuar për botim Leksikoni i termave të fonetikës i hartuar nga Bardh Rugova. Në kohën e aprovimit të këtij Programi ky leksikon do të ketë dalë nga shtypi. Fjalori i studimeve sociolinguistike dhe funksionale është në proces të hartimit. Është bërë gati regjistri i afër 1500 termave. Leksikoni pritet të finalizohet dhe të shkojë në shtyp brenda vitit 2020.

4. Këshilli NdërkademiK për Gjuhën Shqipe. – Edhe pse veprimtaria e 4.Këshillit NdërkademiK për Gjuhën Shqipe ka mbetur pjesë e programit të bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH dhe është përfshirë në

Protokollin për Zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor për periudhën 2018/2020, në të cilin kërkohet: Përgatitja për botim e akteve të veprimtarisë së Këshillit NdërkademiK për Gjuhën Shqipe dhe vijimi i punës së mëparshme, ky Këshill faktikisht e ka përmbyllur aktivitetin. Edhe përbërja e tij nuk është e plotë, sepse një pjesë e anëtarëve nuk jetojnë më. Mbledhja, sistemimi dhe përgatitja për shtyp e materialeve të Këshillit NdërkademiK për Gjuhën Shqipe është paraparë në programin e punës për vitin 2019.

5. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. – Skanimi, digjitalizimi i materialeve dhe puna rreth korpusit ka kërkuar angazhime të gjera, me specialistë të fushave dhe kompletimin e kushteve teknike. Tashmë janë kapërcyer disa nga vështirësitë rreth aftësimit teknik e profesional të Qendrës Leksikografike Enciklopedike, para së gjithash me sigurimin e skanerit me performanca të sofistikuar dhe vënien e tij në punë. Por gjatë vitit 2018 nuk janë angazhuar kuadrot që merreshin me drejtimin e punëve, të cilëve u skadoi kontrata në fund të 2017-tës. As për vitin 2019 nuk është vazhduar puna dhe nuk është pranuar kuadri që do ta çojë më tutje këtë projekt afatgjatë. Mbetet të zgjidhet kjo çështje për vitin 2020 dhe të merret vendimi për vazhdimin e projektit dhe të bëhen planifikimet buxhetore për angazhimin e kuadrit profesional para fillimit të vitit 2020.

TUBIME SHKENCORE

1. Poezia shqipe, fillimi i shekullit XXI, konferencë shkencore. – Në tetor të vitit 2018 Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, realizoi Konferencën shkencore Romani shqiptar, fillimi i shekullit XXI, që u vlerësua e suksesshme dhe solli kontribute të rëndësishme që u përfshinë në një vëllim të veçantë (botimi është në shtyp në kohën e hartimit të këtij Programi). Duket e natyrshme që kjo përvojë të pasqyrohet edhe në një konferencë të ngjashme, gjithnjë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, duke vënë në spikamë kësaj here poezinë shqiptare të njëzet vjetëve të para të shekullit XXI. Ashtu si dhe me romanin, diskutimi do të përfshijë autorët e rinj të paraqitur në këto vite, por edhe autorët e para kësaj periudhe që kanë ardhur me krijime të reja në këtë periudhë. Konferenca do të mbledhë kritikë e studiues të letërsisë për trajtim të shumanshëm të poezisë shqiptare dhe parashihet të mbahet në gjysmën e dytë të muajit qershor 2020. Një këshill organizues që do të propozohet nga Seksioni do të hartojë programin e Konferencës dhe listën e të ftuarve. Do të parashihet edhe një botim me kumtesat e paraqitura.

2. Studimet albanologjike në Francë, konferencë shkencore, në bashkëpunim me Seksionin e Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut. - Në vazhdimësi të tri konferencave,

Studimet albanistike në Amerikë, që u mbajt në vitin 2015 dhe Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, e realizuar gjatë 2017-tës, si dhe të konferencës shkencore Studimet albanistike në Itali, e Studimet albanistike në Itali, e planifikuar për muajin tetor 2019, në vitin 2020 propozohet konferenca shkencore Studimet albanologjike në Francë, si pjesë e programeve të dy seksioneve të ASHAK-ut. Në një arsyetim të grupit iniciues R. Ismajli, E. Basha, M. Kullashi thuhet se synohet të bëhet një pasqyrë sadopak e plotë për studimet shqiptare në botën frankofone dhe me këtë t'u jepet një shtysë zhvillimeve të mëtejme dhe përdëgjimit të këtyre kontakteve në të gjitha rrafshet e veprimtarisë kulturore-intelektuale. Nga kontaktet që kemi me Akademinë Frënge synojmë gjithashtu që edhe ajo të jetë pjesë e këtij organizimi. Konferenca parashihet të mbahet në muajin tetor-nëntor 2020. Materialet e saj do të përmbledhen në një botim që do të parashihet me programin e punës për vitin 2021. Planifikohet të ketë deri në 40 pjesëmarrës. Një projektion buxhetor do t'i bashkëngjitet këtij programi.

BOTIME

1 Studimet albanistike në Itali, materialet e konferencës shkencore, e paraparë të mbahet në tetor 2019. Dy konferencat, Studimet albanistike në Amerikë, 2015 dhe Studimet për shqipen në vendet ku flitet

gjermanisht, 2017, u kurorëzua me botime të kumtesave të paraqitura dhe me materiale të tjera të konferencave. Edhe me këtë rast parashihet që Konferenca shkencore Studimet albanistike në Itali, me interes jo vetëm për praninë e arbëreshëve, për kulturën, letërsinë dhe studimet albanologjike dhe albanistike, por edhe për rezultatet e shumë studiuesve italianë të gjuhës shqipe në radhë të parë, si dhe të letërsisë, antropologjisë dhe kulturës shqiptare në përgjithësi, do të sjellë kontribute që do të tubohen dhe do të pasqyrohen në një vëllim përafërsisht sa këta të dy konferencave të përmendura. Për nevojën e kalkulimeve buxhetore, edhe pse Konferenca do të mbahet në tetor 2019, mbështetur në përvojën e dy konferencave para kësaj, pritet një dorëshkrim prej rreth 600 faqesh në formatin standard të botimeve të ASHAK-ut.

2. Leksikoni i termave të sociolinguistikës. - Leksikoni i termave të fonetikës, si pjesë e projektit Leksikonët e termave të gjuhësisë, tashmë ka përfunduar, është recensionuar, miratuar për shtyp dhe është dorëzuar. Në kohën e diskutimit të këtij programi në Kuvendin e ASHAK-ut ai do të ketë dalë nga shtypi. Është duke u përgatitur dhe pritet të finalizohet brenda vitit 2020 Leksikoni i termave të studimeve sociolinguistike dhe funksionale. Janë hartuar regjistrat e mbi 1500 termave. Autorë të Leksikonit janë Rexhep Ismajli dhe Bardh Rugova me bashkëpunëtorë. Pritet një vëllim rreth 600 faqesh i cili

do të jetë i gatshëm për shtyp nga fundi i vitit 2020.

3. Kujtim Shala, Sinekdoka. – Sinekdoka është dorëshkrim me tekste për fenomenet letrare shqipe, për autorë e për vepra. Siç e thotë edhe titulli, Sinekdoka jep pamjen e përqendruar të letërsisë shqipe, të lidhur me fenomene tipike, me autorë përfaqësues dhe me vepra themelore të traditës e të modernitetit letrar shqiptar. Dorëshkrimi është dorëzuar dhe ka 400 faqe, i ndarë në tri pjesë: Histori letrare (Histori letrare shqipe; Histori e letërsi; Njohja letrare), Sinekdoka (Ligjërata e Katedrales;... Letërsi e kode; Oriental apo oksidental; Kënga e cjamin...) dhe Letërsia (Fishta: norma e forma; Kuteli; Shkrimtaria; Mekuli; Kadare; Pllumi: dëshmi e letërsi).

4. Rexhep Ismajli, Dokumente dhe korrespondenca të veprimtarëve shqiptarë me A. von Kral, të ruajtura në Arkivin e Shtetit në Vjenë nga periudha 1896 deri më 1912 (titull pune). Projekt për mbledhjen, tejshkrimin, përkthimin dhe përgatitjen për botim të materialeve arkivore për historinë e proceseve të njësimit të alfabetit të shqipes sipas arkivit të Shtetit në Vjenë. - Ky projekt është menduar të përmbledhë dokumentacionin e rëndësishëm austro-hungarez që lidhet me veprimtarinë e konsullit August von Kral në Manastir e Shkodër lidhur me veprimtarinë kulturore, politike sidomos në fushën e alfabetit, të gjuhës dhe të shtypit. Pasqyrimi më i

qartë kërkon që në ndërlidhje me këtë të përfshihet dhe një pjesë e dokumentacionit të konsujve të tjerë (Ippen, Ranzi e sidomos Zwiedinek), sepse kështu shpërfaqen dhe orientimet e ndryshme brenda trupit diplomatik austro-hungarez – në lëvizje në dekadat 1890-1910.

Dokumentacioni në pjesën më të madhe është skanuar, një pjesë është lexuar dhe pjesa tjetër është në proces e sipër. Brenda vitit 2019 duhet të kryhet seleksionimi i materialeve, tejshkrimi i letrave dorëshkrim shqip me alfabetë të ndryshme dhe leximi e tejshkrimi i letrave dorëshkrim gjermanisht, frëngjisht e italisht. Gjatë pjesës së parë të vitit 2020 duhet përkthyer shqip materialet nga gjuhët e tjera dhe të bëhen gati shënimet për botim. Parashikohet që dorëshkrimi të jetë gati deri në korrik 2020 dhe të përmbajë 350-400 faqe materiale shqip dhe një numër faksimilesh. Duhet të angazhohet përkthimi nga gjermanishtja, ndërkohë që atë nga frëngjishtja e italishtja e bën përgatitësi i veprës.

5. Ali Aliu, Studime letrare (titull pune) me rastin e 85-vjetorit të lindjes. – Mbështetur në praktikën e ASHAK-ut për të shënuar 80-vjetorin e lindjes së anëtarëve të vet dhe duke marrë parasysh se një gjë e tillë nuk është realizuar në rastin e akademik Ali Aliut, Seksioni vendosi që me rastin e 85-vjetorit të lindjes së kritikut, studiuesit të letërsisë, akademikut Ali Aliu t'i botohet një përmbledhje studimesh dhe artikujsh të zgjedhur mbi letërsinë. Akademik Ali Aliu mbush 85 vjet më

2019 dhe libri do të botohej në fund të këtij vitin ose në muajt e parë të vitit 2020. Për këtë botim është emëruar redaksia e përbërë nga: Zejnullah Rrahmani, Sabri Hamiti dhe Kujtim Shala.

6. Brian D. Joseph, Studime të zgjedhura për gjuhën shqipe (titull pune). - B. Joseph (1951), profesor i gjuhësisë në Ohio State University është nga studiuesit e shquar në fushën e gjuhësisë historike, specialist i greqishtes, i gjuhësisë ballkanike, i njohur për studimet morfologjike. Interesimet e tij lidhen me studimin e ndryshimit gjuhësor që në fazat indoevropiane e deri te ndikimi i kontakteve brenda hapësirës ballkanike. Është fokusuar edhe në studimet për sanskritishten, gjithnjë e më shumë për shqipen, por edhe për çështje të përgjithshme të teorisë morfologjike dhe të lidhjeve të gjuhësisë dhe të strukturave gjuhësore me strukturat shoqërore. Me gjuhën shqipe B. Joseph merret qysh prej fillimeve kur kishte bërë studimet për sinkroninë dhe diakroninë e infinitivit në gjuhët e Ballkanit. Kanë rënë në sy interesimet e tij për arbëreshët e Greqisë, por edhe për çështje të ndryshme të shqipes në përgjithësi. Në këto studime ai ka ndjekur gjurmët e albanologut Eric. P. Hamp, ndërsa për ne ato kanë rëndësi edhe për shkak se vijnë nga njëri prej autoriteteve të gjuhësisë historike aktualisht. Propozohet botimi i një përzgjedhjeje të gjerë në kuadër të serisë së botimeve të traditës albanistike. Parashihet një vëllim rreth 400 faqesh

në formatin e botimeve të ASHAK-ut. Në planifikimin buxhetor duhet të parashihet edhe përkthimi i dorëshkrimit nga anglishtja në shqip.

7. Skënder Gashi, Shtresime gjuhësore në leksikon e në toponiminë e Kosovës. Dorëshkrimi i Skënder Gashit ka më shumë se dy vite që është dorëzuar në Seksion. Në vitin e kaluar nuk ishte inkuadruar në Program për shkak se mungonte vlerësimi. Kësaj here ai është dhënë në recension me vendimin e Seksionit (Bardh Rugova dhe Mehmet Halimi) dhe sipas mendimit të recensentëve dorëshkrimi rekomandohet për botim. Bëhet fjalë për një përmbledhje prej 21 artikujve që trajtojnë tema të ndryshme të emrave të vendbanimeve, por edhe të njerëzve apo të emërtimeve të tjera në truallin e sotëm të Kosovës. Dorëshkrimi ka rreth 530 faqe.

8. "Studime" nr. 27. – Numri 26 i revistës së Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, me kryeredaktor Zejnullah Rrahmanin, në kohën e hartimit të këtij programi është në proces të shtypit. Redaksia bën përgatitjet për numrin e radhës, me kontribute, studime shkencore e artikuj nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë, në shqip dhe në gjuhë të tjera, recensione, kronika, paraqitje botimesh të reja, i cili do të dorëzohet në fund të vitit 2019. Janë propozuar një cikël ligjëratash tematike të anëtarëve të Seksionit apo të kolegëve të fushës së studimit nga institucionet tjera. Mund të planifikohen gjithsej 4 ligjërata në vit.

Sekretari i Seksionit
Akademik Eqrem Basha, d.v.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

PROJEKTE

1 Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës - Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale, faza III e projektit afatmesëm.

Udhëheqës i projektit, akademik Hivzi Islami.

Pas përfundimit të punës së fazës së parë dhe botimit të rezultateve të punës hulumtuese-shkencore doli dhe botimi për qendrat urbane të Kosovs, vëllimi I. Gjatë vitit 2018 dhe pjesës së parë të vitit 2019 një numër i madh bashkëpunëtorësh (ekspertë nga shkencat gjeohapësinore, sociologë, urbanistë, planerë, ekonomistë, demografë, historianë, etnologë, administratorë komunalë etj.) vazhdoi intensivisht punën në mbledhjen e të dhënave empirike, të vjelura në terren për karakteristika të ndryshme gjeografike, mjedisore, historike, arkeologjike, demografike, ekonomike, kulturore etj. për vendbanimet rurale të Kosovës dhe përgatitjen e botimit, ndërsa redaksia punoi në sistemimin e materialit dhe përgatitjen për botim. U mbajtën dhe disa Workshop-e (punëtori) në vitin 2018 dhe një në vitin 2019. Puna e fazës së dytë do të rezultojë me përgatitjen për botim të

vëllimit të dytë “Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës - Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale. Vendbanimet rurale. Vëllimi II. Ky vëllimi përshinë vendbanimet rurale nga shkronja A-LL.

Në vitin 2020 do të vazhdojë puna në fazën e tretë për vjeljen e të dhënave sa më të plota për vendbanimet rurale të Kosovës nga shkronja M-LL në tërë kompleksitetin e tyre nga shkronja M-ZH si zëra të veçantë. Është hartuar tashmë modeli në formë të udhëzimit - pyetësorit si një nga instrumentet kryesore të hulumtimeve në terren për sigurimin e të dhënave burimore dhe origjinale shkencore-enciklopedike mbi vendbanimet rurale. Të dhënat nga Pyetësi me 50 pyetje dhe nënpyetje shfrytëzohen vetëm për qëllime shkencore.

Në fazën e tretë do të mblidhen të dhënat relevante për dimensionin fizik-hapësinor (pozita, topografia, relievi, hidrologjia, klima, gjeologjia, pedologjia etj.), komponentët demografikë, çfarë janë lëvizja e numrit të popullsisë dhe të ekonomive familjare, rrjedhat migruese dhe proceset shpopulluese, që kanë marrë përmasa dramatike në fshatin tonë, pastaj për veçoritë sociale, ekonomike, kulturore, infrastrukturore, për elementet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, të dhënat për dhunën dhe krimet që i shkaktoi regjimi fashistoid serb i Millosheviqit (shpërnguljet e detyrueshme masive, dhunimet, vrasjet, masakrat dhe dëmet e mëdha

materiale) në vitet e luftës 1998-1999 të vendbanimeve rurale, e kaluara dhe e tashmja e tyre. Të dhënat e vjelura, sikurse për vëllimin II, do të jenë nga “dora e parë”, pra nga terreni përmes pyetësorit-udhëzuesit, ndërsa autorët do të jenë kryesisht nga komunitatet dhe vendbanimet që u përkasin dhe i njohin rrethanat konkrete dhe tablonë e gjithëmbarshme të vendbanimeve rurale. Autorët janë pothuajse të njëjtit - kuadro me grada shkencore që punojnë dhe veprojnë në institucione të ndryshme të këtyre komunave e vendbanimeve dhe të Republikës, gjithnjë nën udhëheqjen e redaksisë qendrore të projektit. Tekstet e autorëve domosdoshmërisht do të kalojnë nëpër disa redaktuara të ekspertëve të gjeohapësirave, do të plotësohen dhe harmonizohen për t’iu përshtatur modelit të publikimit, gjithnjë në përputhje me kriteret shkencore-enciklopedike. Nga redaksia, sikurse në dy vëllimet e mëparshme, do të plotësohet veçanërisht pjesa fizike-hapësinore.

Në punën e fazës së tretë të Leksikonit një problem në vete në grumbullimin e të dhënave do të paraqesin vendbanimet rurale në komunitatet e Veriut të Kosovës, por edhe në komunitatet në jug të lumit Ibër të banuara me popullatë shumicë serbe dhe të administruara nga serbët. Prandaj bashkëpunëtorët do të detyrohen t’i mbledhin të dhënat nga literatura, burimet dhe dokumentacioni serb. Jemi të vetëdijshëm për mangësitë në gjithëpërfshirjen e të dhënave dhe fakteve fizike-hapësinore,

popullative dhe funksionale për vendbanimet rurale në këto pjesë të Republikës së Kosovës. Puna që do të përfundojë do të kurorëzohet me botimin e vëllimit të tretë për vendbanimet rurale.

Për shkak të ndryshimit të kriterëve dhe qasjes metodologjike, të dhënat e regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2011 nuk janë të krahasueshme me të dhënat e regjistrimeve të mëparshme (1948-1991), sepse në këtë regjistrim është zbatuar kriteri "popullsi e pranishme" (gjendja faktike), ndërsa në regjistrimet e mëparshme është zbatuar kriteri "popullsi e përhershme" apo rezidenciale. Nga ky dallim ka rezultuar rëndom rritja më e vogël e numrit të popullsisë në shumë vendbanime në regjistrimin e fundit, ngase nuk janë përfshirë personat të cilët në momentin e regjistrimit kanë munguar më shumë se një vit, ndërsa persona të tillë ka mjaft.

Pjesa tekstuale e vëllimit III, sikurse edhe e dy vëllimeve të mëparshme, përcillet me material ilustrues, çfarë janë fotot për objekte të ndryshme gjeohapësinore, të trashëgimisë natyrore e kulturore dhe elementet fizionomike e funksionale, hartat, planet dhe skicat e ndryshme.

Përfundimi i punës në projekt dhe nxjerrja në dritë e tri vëllimeve do të plotësojë mungesën e informatave dhe njohurive për dinamikën e jetës dhe zhvillimit të vendbanimeve të Kosovës,

të kaluarën dhe të tashmen e tyre, me një qasje dhe metodologji bashkëkohore shkencore. Dalja në dritë e këtyre botimeve pa dyshim do të përmbushë një nevojë të kahershme për gjeoshkencat, shkencat sociale dhe opinionin e gjerë lexues dhe shfrytëzues dhe do të jetë një trashëgimi e madhe për shkencën dhe kulturën tonë. Arsyetimi i hollësishëm i projektit dhe i të gjitha fazave të tij është dhënë në të gjitha instancat e Akademisë në mesin e vitit 2016.

2. Lidhja e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1879-1881). - Projekt dy vjeçar.

Projekti është i përfshirë në Protokollin e bashkëpunimit ASHAK-ASHSH.

Bartës i projektit është akademik Jusuf Bajraktari.

Lidhja e Prizrenit është një ngjarje madhore në historinë tonë kombëtare, e cila shënon lindjen në mënyrë të institucionalizuar të kombit modern shqiptar. Ajo ka lënë gjurmë të thella në historinë tonë kombëtare, me të gjithë aktivitetin e saj multidimensional, kulturor, politik, ushtarak dhe institucional. Ajo arriti të krijonte të parën qeveri kombëtare gjithëshqiptare, të parën ushtri kombëtare gjithëshqiptare. Ishte organizata politike me përfaqësim nga të gjitha trevat shqiptare. Veprimtaria e saj në mbrojtje të trojeve që Kongresi i Berlinit kishte vendosur t'i shkëputeshin Shqipërisë ka lënë gjurmë

të thella në identitetin dhe në memorien historike shqiptare. Ajo gjithashtu ka pasur ndikim të madh në marrëdhëniet ndërkombëtare të kohës dhe veçanërisht në krijimin e një mendimi dhe qëndrimi të ri të Fuqive të Mëdha për sa i përket çështjes shqiptare. Gjatë kohës së saj dhe pas saj, çështja shqiptare do të merrte një dimension gjithnjë e më të madh ndërkombëtar dhe do të ishte gjithnjë e më tepër e pranishme në planet dhe politikat e Fuqive të Mëdha. Dokumentet austro-hungareze kanë një vlerë të madhe, sepse e pasqyrojnë me imtësi të gjithë veprimtarinë e Lidhjes dhe, më gjerë akoma, të shqiptarëve në këto vite. Gjithashtu ato pasqyrojnë edhe qëndrimin e vetë Austro-Hungarisë dhe të vendeve të tjera ndaj çështjes shqiptare. Projekti hulumtues është projekt i përbashkët me Institutin e Historisë të Tiranës. Ekipi hulumtues në fazën e parë ka hulumtuar dokumentacionin që gjendet në Arkivin e IHT-së.

Është evidentuar, seleksionuar dhe përzgjedhur për përkthim korpusi i dokumenteve që bën fjalë kryesisht për periudhën 1879-1880. Gjatë vitit 2019 do të vazhdohet puna në grumbullimin e dokumenteve edhe në arkivat tjera, të cilat do të ndahen e sistemohen në vëllimet përkatëse. Në fund të vitit ose në tremujorin e vitit të ardhshëm do të mbahet punëtoria përmbyllëse ku do të përcaktohet mënyra e botimit të rezultateve të projektit.

TUBIME SHKENCORE

1 Konferencë shkencore “30-vjetori i miratimit të Deklaratës Kushtetuese dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës”. Bartës i aktivitetit akademik Jusuf Bajraktari.

Qëllimi i kësaj Konference është të prezantojë tre dekada pas rëndësinë e këtyre dy akteve kryesore burimore kushtetuese me cilat filloi jo vetëm konstitucionalizimi i subjektivitetit juridik të Kosovës dhe pozita e saj kushtetuese, por edhe të analizojë dhe trajtojë nga perspektiva aktuale edhe ndikimin e këtyre akteve në lindjen e Republikës së Kosovës si në rrafshin kushtetues e juridik, ashtu edhe në atë politik e historik.

Nga perspektiva e viteve në histori, sigursht që tri dekada janë periudhë e shkurtër në kalendarin e gjatë të historisë e të popujve. Por kur kihen parasysh ngjarjet që e përbëjnë historinë e re të popullit të Kosovës, siç janë miratimi i Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës të 7 Shtatorit 1990 si dhe efektet e shumëfishta që ato krijuan, së bashku me aktet e tjera që derivuan si rezultat i tyre, patjetër që konsiderohen si zhvillimet kryesore të cilat i dhanë kahjen përfundimtare pothuajse të gjitha zhvillimeve që kanë ndodhur brenda këtyre tridhjet viteve.

Do të provohet që në mënyrë shkencore kronologjike të prezantohet mozaiku i zhvillimeve të shumta të kohës të cilat rezultuan me miratimin e

këtyre akteve kushtetuese si dhe do të analizohen parimet themelore e vlerat kryesore kushtetuese të cilat ishin materializuar në këto akte dhe karakteristikat e tyre, për t'u krahasuar gjithashtu edhe me të drejtën kushtetuese pozitive të Republikës së Kosovës. Po ashtu në kuadër të trajtesave profesionale dhe kumtesave shkencore të kësaj Konference do të vihet në pah edhe roli që kishte në atë kohë Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës përballë proceseve të lartcekura.

Ndërsa nga punimet e kësaj Konference dhe përmbledhjes së konkluzioneve të saj do të përfitojnë komuniteti akademik dhe profesional i së drejtës kushtetuese, institucionet shtetërore të Kosovës, si dhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

Planifikohet të marrin pjesë dhjetë panelistë, njëqind (100) pjesëmarrës nga radhët e institucioneve shkencore, akademike dhe institucioneve të tjera, si dhe pesë mysafirë të jashtëm.

Koha e mbajtjes: qershor-korrik 2020.

2. Konferencë shkencore ndërkombëtare "Roli i këmbimit të dhuratave në konstituimin e lidhjeve sociale". -

Bartës të aktivitetit, anëtar korrespondent Muhamedin Kullashi dhe akademik Anton K. Berishaj.

Tema e dhuratës është njëra nga temat karakteristike të mendimit filozofik,

sociologjik e antropologjik bashkëkohor, ndonse kjo dukuri hulumtohet më shumë në shoqëritë paramoderne të së kaluarës dhe në shoqëritë e ashtuquajtura "primitive" (fisnore) të së tashmes. Bronislav Malinowski, Marcel Maussi, Lévi-Straussi, Jacques Derrida e Georges Bataille zhvilluan hulumtime të thella për këtë temë, që duket tejet e veçantë, ndonëse hedh dritë në pikat thelbësore të një shoqërie dhe të një qytetërimi. Kështu, Maussi në "Ese mbi dhuratën" cek se dhurata u përket të gjitha trajtave të jetës shoqërore, gjësendeve si dhe personave, realiteteve dhe mënyrave të qeniesimit; ajo është një "fakt social total".

Paul Ricoeur (1913-2005), njëri nga mendimtarët e shquar të fenomenologjisë e hermeneutikës ka trajtuar në hulumtimet e veta temën e dhuratës përmes ndriçimit të atyre përvojave të pranimit, në historinë e njerëzimit, që nuk implikojnë dhunën dhe luftën.

Shqyrtimin e teorive bashkëkohore filozofike, sociologjike e juridike, që trajtojnë raportet ndërindividuale e ndërgrupore nga aspekti i pranimit të ndërsjellë (dashuria dhe afektiviteti, të drejtat juridike dhe respekti shoqëror), Ricoeur i thellon duke u mbështetur veçanërisht në hulumtimet antropologjike mbi dhuratën, mbi praktikën shoqërore të këmbimit të dhuratave si moment i një politike të pranimit reciprok simbolik. Kjo e shpie

Ricoerin në një analizë kritike të teorive mbi dhuratën te Marcel Mauss, Lévi-Strauss dhe Marcel Hénaff. Thënë shkurtazi, Ricouer mendon se koncepti i filozofit e antropologut Marcel Hénaff ofron jo vetëm një konceptim më të thellë mbi dhuratën se parardhësit e tij, por edhe një vepër vendimtare (Le prix de la vérité, Çmimi i së vërtetës, e botuar me 2002 nga Seuil në Paris) në kërkimet mbi pranimin e ndërsjellë. Hénaff e zhvendos theksin e debatit antropologjik mbi dhuratën prej relacionit midis dhënësit dhe marrësit të dhuratës kah reciprociteti i këmbimit midis protagonistëve, duke e emërtuar këtë operacion të përbashkët me shprehjen pranim i ndërsjellë. Është fjala për një tip të raporteve ndërnjerëzore që nuk i takojnë as rendit të këmbimit të të mirave materiale (rendit ekonomik) e as nuk janë shprehje e ndihmës altruiste (rendit etik), por shprehjeve simbolike të reciprocitetit. Hénaff shkoqit krijimin dhe mbajtjen e lidhjeve mes njerëzve përmes një procedure simbolike të pranimit publik e reciprok të ndividëve e grupeve si të ngjashëm me veten. Dhënia e dhuratës është sfidë dhe ngashnjim që i drejtohen tjetrit për të hyrë në një relacion, që përmban miqësinë e respektin e ndërsjellë. Në këtë relacion gjendet edhe domethënia e tretë e fjalës «reconnaissance», mirënjohja ndaj një gjesti a veprimi bujar. Përmes një studimi krahasues ai zhvillon një interpretim origjinal të fenomenit të dhuratës. Hénaff bën një dallim të përvijuar midis rregullimit të lidhjes

shoqërore me dhuratë dhe rregullimit ekonomik të këmbimit të mallrave, të pasurive dhe të profitit. Sipas tij, është fjala për dy rende të ndryshme të marrëdhënieve midis njerëzve përnga karakteri dhe qëllimësia e tyre. Këto dy rende nuk i kundërvihen doemos njërit-tjetrit; ato bashkëjetojnë në të gjitha shoqëritë gjatë historisë së njerëzimit. Persiatjet filozofike e antropologjike mbi dhuratën bëjnë të ditur për rreziqet që i kërcënohen qytetërimit të sotëm nëse lejon të përsundohet tërësisht nga logjika e ekonomisë së mallit e parasë. Ato nxisin kultivimin e një hapësire edhe për “gjërat” që nuk mund të blehen me para: miqësia, simpatia, respekti, përkushtimi ndaj një ideali, aftësia e ëndrrimit, etj.

Konferenca ka për qëllim që duke marrë parasysh hulumtimet e deritashme mbi aspekte të ndryshme të temës së dhuratës dhe dhurimit të tematizojë çështje e probleme që vënë në pah karakterin sfidues të kësaj çështje për shoqëritë e sotme dhe për relacionet midis tyre. Në këtë konferencë do të ftoheshin, përveç studiuesëve të vendit, edhe disa studues nga rajoni dhe disa qendra tjera.

Propozojmë që konferenca të mbahet në muajin maj 2020.

3. Konferencë shkencore “Studimet albanologjike në Francë”, në bashkëpunim me Seksionin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të ASHAK-ut. - Në vazhdimësi të tri konferencave,

Studimet albanistike në Amerikë, që u mbajt në vitin 2015 dhe Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, e realizuar gjatë 2017-tës, si dhe të konferencës shkencore Studimet albanistike në Itali, e planifikuar për muajin tetor 2019, në vitin 2020 propozohet konferenca shkencore Studimet albanologjike në Francë si pjesë e programeve të dy seksioneve të ASHAK-ut. Në një arsyetim të grupit iniciues, R. Ismajli, E. Basha, M. Kullashi thuhet se synohet të bëhet një pasqyrë sadopak e plotë për studimet shqiptare në botën frankofone dhe me këtë t'u jepet një shtysë zhvillimeve të mëtejme dhe përdëgjimit të këtyre kontakteve në të gjitha rrafshet e veprimtarisë kulturore-intelektuale. Nga kontaktet që kemi me Akademinë Frënge synojmë gjithashtu që edhe ajo të jetë pjesë e këtij organizimi. Konferenca parashihet të mbahet në muajin tetor-nëntor 2020. Materialet e saj do të përmbliidhen në një botim që do të parashihet me programin e punës për vitin 2021. Planifikohet të ketë deri në 40 pjesëmarrës. Një projektion buxhetor do t'i bashkëngjitet këtij programi.

4. Tryezë shkencore “Zhvillimi i qëndrueshëm dhe realiteti i Kosovës”.

Bartëse e aktivitetit është anëtare korrespondente Justina Shiroka – Pula.

Kosova po vazhdon të ballafaqohet me sfida të reja në rritjen ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm. Zhvillimi i

shpejtë shoqëror dhe ekonomik, rritja e numrit të popullsisë, globalizimi i ekonomisë, problemet mjedisore e kanë sjell në përdorim një koncept të ri të organizimit shoqëror dhe ekonomik, të njohur si zhvillimi i qëndrueshëm.

Zhvillimi i qëndrueshëm është pjesë e gjithë aktivitetit të vendeve të zhvilluara nga e gjithë bota nëpërmjet të cilit koncept harmonizohen nevojat ekonomike, mjedisore dhe shoqërore për qytetarët e tyre.

Kështu, edhe Kosova duhet që sa më shpejt të hartojë një strategji për zhvillim të qëndrueshëm, që e rregullon zhvillimin e qëndrueshëm si proces, i cili përfshin ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik, mirëqenies shoqërore dhe mjedisit të sigurt.

Tryeza ka për qëllim të sensibilizojë institucionet e shtetit, të krijojë një bazë si dhe procesin e identifikimit të potencialeve të vendit si mundësi për një ekonomi të qëndrueshme. Në këtë tryezë do të prezantohen dhe diskutohen potencialet e Kosovës dhe mundësitë e shfrytëzimit të potencialeve aktuale për nevojat e ekonomisë. Njëkohësisht, duke analizuar dhe trajtuar perspektivën aktuale dhe orientimet e përvojave të shteteve në tranzicion, përkatësisht trendin e rritjes ekonomike të vendeve në rajon, në tryezën njëditore parashihet të marrin pjesë me kumtesa rreth dhjetë panelistë, prej tyre katër nga jashtë Kosova si dhe mysafirë nga

institucionet shkencore, akademike dhe shoqëria civile. Për pjesëmarrësit jashtë Kosovës do të mbulohen shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe të qëndrimit për dy ditë.

Koha e mbajtjes, maj 2020.

BOTIME

1. Leksikoni “Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës” (Tablloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale), vëllimi III, Vendbanimet rurale – shkronjat M – ZH. Grup autorësh.

Pas përfundimit të fazës së parë dhe fazës së dytë të punës në hartimin e Leksikonit për vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës, u nxorr në dritë vëllimi I, qendrat urbane, ndërsa është bërë gati për botim vëllimi II, vendbanimet rurale të Kosovës – shkronjat A - LL. Në vëllimin e parë trajtohen qendrat urbane dhe të urbanizuara (gjithsej 38), ndërsa vëllimi i dytë përmban vendbanimet rurale, shkronjat A-LL. Përfundimi i punës në fazën e tretë do të ketë si produkt botimin e vëllimit III, shkronjat M-ZH për vendbanimet rurale të Kosovës. Vendbanimet më të mëdha rurale për nga numri dhe funksioni, si dhe vendbanimet pranëqytetëse dhe suburbane prezantohen parimisht në vëllim pak më të madh. Këto të fundit do të përcillen me material ilustrues çfarë janë fotot për objekte të ndryshme gjeohapësinore, të trashëgimisë natyrore e kulturore dhe

elementet fizionomike e funksionale, hartat, planet dhe skicat e ndryshme.

Vëllimi III – shkronjat M-ZH, do të përmbajë të dhënat dhe faktet për këto dimensione të vendbanimeve rurale të Kosovës:

I. Dimensionin fizik-hapësinor (pozita gjeografike, veçoritë gjeologjike dhe pedologjike, morfologjia e terrenit, shtrirja zonale dhe hipsometrike, karakteristikat klimatike e hidrologjike, resurset natyrore, biodiversiteti etj.);

II. Zhvillimin demografik (lëvizja e numrit të popullsisë dhe të ekonomive familjare, rrjedhat migruese dhe proceset shpopulluese që kanë marrë përmasa dramatike në fshatin tonë, pastaj veçoritë sociale, ekonomike, kulturore, infrastrukture, elementet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, të dhënat për numrin e viktimave, etj);

III. Dimensionin funksional (tipi i vendbanimit sipas aktivitetit socioekonomik, ekonomia, kryesisht agrare, shfrytëzimi i reitancave, objektet shoqërore e publike: shkollat, shëndetësia, objektet fetare dhe infrastrukture (rrugët, elektrifikimi, ujësjellësi, kanalizimi, ndriçimi i rrugëve, trashëgimia natyrore dhe kulturore-historike etj.).

IV. Pasojat e luftës nga forcat agresore serbe (shpërnguljet e detyrueshme masive, masakrat, vrasjet, dhunimet dhe dëmet e mëdha materiale në vitet e luftës 1998-1999 të vendbanimeve

rurale etj.), si dhe rindërtimi i vendbanimeve pas luftës.

Të dhënat e vjelura, sikurse për vëllimin II, do të jenë nga “dora e parë”, pra nga terreni përmes pyetësorit-udhëzuesit, ndërsa autorët do të jenë kryesisht nga komunat dhe vendbanimet që u përkasin dhe i njohin rrethanat konkrete dhe tablon e gjithmbarshme të vendbanimeve rurale çfarë janë krijimi, dinamika e jetës dhe rrjedhat zhvillimore të vendbanimeve të Kosovës, të kaluarën dhe të tashmen e tyre. Problem në vete paraqet mbledhja e materialit në vendbanimet e banuara me serbë, të kontrolluara nga pushteti lokal serb. Tekstet e shkruara nga autorët domosdoshmërisht do të kalojnë nëpër disa redaktura nga ekspertët e shkencave gjeohapësinore, do të plotësohen dhe harmonizohen për t’iu përshtatur modelit të publikimit të konceptuar qysh në paraqitjen e projektit në vitin 2016, me arsyetimet e hollësishme, por edhe në Programin e punës për vitin 2020 – faza e tretë.

Dalja në dritë e këtij botimi, si dhe e dy botimeve të tjera, pa dyshim do të përmbushin një nevojë të kahershme për gjeoshkencat, shkencat sociale dhe opinionin e gjerë dhe do të jetë një trashëgimi e madhe për shkencën dhe kulturën tonë.

Botimi do t’i ketë rreth 40 tabakë shtypi dhe do të printohet në 1000 kopje.

2. Arsim Bajrami, “Shtetndëtimi i Kosovës 1990 – 2020, sfidat dhe perspektiva”.

Qëllimi i këtij botimi, në radhë të parë, është të paraqesë ciklet e zhvillimit të një procesi 30-vjeçar në Kosovë, duke ndriçuar dhe analizuar rrjedhën e ngjarjeve dhe të zhvillimeve politike e kushtetuese me qëllim të pasqyrimin të procesit të lindjes së shtetit së bashku me specifikat e zhvillimit konstitucional dhe, në radhë të dytë, të ofrojë një pasqyrë dhe analizë për sfidat në rrafshin e brendshëm, atë të konsolidimit të institucioneve dhe jetën e demokracisë kushtetuese e parlamentare, si dhe në rrafshin e jashtëm sfidat e fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtar, raportet e ndërvarura me shtetet fqinjë, procesin e integriteteve evropiane dhe detyrimet ndërkombëtare të pranuara gjatë kësaj periudhe.

Botimi, pos tjerash, do të pasqyrojë edhe krizat institucionale dhe politike gjatë viteve, prej shpalljes së pavarësisë e deri në ditët e sotme si dëshmi e mungesës së vetëdijes së duhur për mbrojtjen e vlerave fundamentale të shtetit që nga sovraniteti i popullit e deri te respektimi i lirive dhe të drejtave të qytetarëve pa asnjë diskriminim. Në këtë kontekst synohet të realizohet një studim me qëllim të analizimit të zbatimit dhe funksionalitetit të kushtetutës. I gjithë studimi për këtë pjesë do të realizohet duke përdorur në

mënyrë rigoroze qasjet shkencore metodologjike.

Botimi do t'i ketë rreth 40-45 tabakë shtypi .

3. Justina Pula, “Modelet dhe teknikat në vendimmarrje”.

Qëllimi i hartimit të këtij botimi është analiza e përgjithshme e menaxhimit të bizneseve në kushtet bashkëkohore dhe mjaft dinamike, që paraqet një sfidë të veçantë në punën e menaxherëve. Menaxhimi i suksesshëm i ndërmarrjes nënkupton aftësinë e këtyre menaxherëve që të marrin vendime kualitative. Prandaj vendimmarrja konsiderohet si funksion kritik i menaxhmentit. Ky libër do të shtjellojë përkufizimin e menaxhmentit si arritje e qëllimeve të organizatës, ndërsa vendimmarrjen si instrument apo mënyrë për të arritur.

Analiza e biznesit në kushtet bashkëkohore i mundëson lexuesit që në mënyrë shumë të shpejtë të absorbojë teorinë dhe konceptet e vendosjes menaxheriale, si dhe një sërë metodash kuantitative.

Temat e përfshira në këtë libër janë zgjedhur me kujdes në mënyrë që të jenë lehtë të shfrytëzueshme në sqarimin, analizimin, diagnostifikimin e problemeve dhe në aplikimin e metodave e teknikave të ndryshme për zgjidhjen e suksesshme të tyre. Botimi “Modelet dhe teknikat në vendimmarrje” përfshin tema të cilat

janë të aplikueshme në shumë çështje dhe probleme me të cilat përballen njerëzit në organizata jo vetëm në fushën e biznesit, por edhe në institucionet shoqërore dhe politike.

Libri do të jetë i përpiluar në mbështetje të një qasjeje integrative dhe interdisiplinare. Qasja integrative nënkupton shtjellimin e aspekteve teorike të vendimmarrjes dhe modeleve e metodave të ndryshme bashkëkohore, kryesisht kuantitative, që sot aplikohen në zgjidhjen e problemeve praktike në biznes. Qasja interdisiplinare kushtëzohet edhe nga vetë interdisiplinariteti i shkencës mbi vendosjen dhe menaxhmentin. Në këtë kontekst shfrytëzohen të arriturat shkencore nga fusha të ndryshme si psikologjia, sociologjia, shkencat organizative, matematika, statistika etj.

Rastet studimore janë të inkuorporuara direkt në tekst, të adaptuara nga literatura bashkëkohore e vendosjes dhe udhëheqjes. Rastet studimore janë probleme aktuale edhe pse aty-këtu shfrytëzohen shembuj imagjinarë, mirëpo gjithmonë duke përshkruar situata që i përgjigjen jetës reale në biznesin bashkëkohor. Qëllimi kryesor i rasteve studimore është që të zhvillohen aftësitë analitike të lexuesit për zgjidhjen e problemeve praktike që autorët i konsiderojnë fundamentale për udhëheje të suksesshme.

“Përmbledhje termash”- është dhënë në fund të librit dhe paraqet një përmbledhje termash më të shpeshtë

në fushën e vendimmarrjes. Kësisoj bëhet sqarimi i gjerë i termave përkatës që do t'i ndihmojnë lexuesit në konsultimin e literaturës bashkëkohore të vendimmarrjes.

Kjo vepër mendohet të përmbledhet në rreth 200-250 faqe, përkatësisht në rreth 15-17 tabakë shtypi.

4. Muhamedin Kullashi, "Kthesa e dramës moderne (XIX-XX), Ibseni dhe Strindbergu. Filozofi e teatrit".

Filozofia evropiane ka kultivuar gjatë gjithë historisë së saj, raporte të ngushta me artin teatror. Koha e lulëzimit të teatrit në Greqinë antike gërshetohet ngusht me zhvillimin e hovshëm të mendimit filozofik, me parasokratikët dhe me Platonin e Aristotelin në veçanti. Vepra e Aristotelit Poetika u bë tekst themelor jo vetëm për zhanrin e tragjedisë, por edhe si persiatje vendimtare për artin e teatrit, me diversitetin e zhanreve të tij. Lidhmëritë e ngushta të filozofisë me teatrin u realizuan gjatë shekujve edhe në saxe të faktit se filozofë të mëdhenj të epokave të ndryshme ishin po ashtu edhe autorë të veprave teatrore: në antikitetin greko-romak (Seneka, etj.), në Rilindje (Makiaveli, etj.), në modernitet (Diderot-ja, Voltaire-, etj.), në bashkëkohësi (Sartre, Camus etj.). Një aspekt i këtij gërshetimi të ngushtë u shpërfaq me lindjen e estetikës si disiplinë filozofike mbi artet. Në fakt fjala teatër etimologjikisht do të thotë «vend nga i cili shikohet», ngase folja greke

theaomai thotë të shikosh, të sodisësh. Brenda etimologjisë së fjalës, kësisoj, është ruajtur lidhja midis filozofisë dhe teatrit.

Kritikë të shquar të teatrit bashkëkohor (francezë, gjermanë e italianë) shpesh kanë theksuar në hulumtimet e tyre se mbarimi i shekullit XIX shënon një ndryshim apo transformim të dramës moderne. Qoftë në analizat e tyre të përgjithshme mbi këtë periudhë të historisë së dramës, qoftë në shqyrtimet e tyre të veprave të veçanta të Ibsenit e Strindbergut, megjithë dallimeve midis kritikëve në interpretimin e kësaj «ngjarjeje» që i takon dramës moderne si dhe dallimeve midis dramaturgëve, veprat e të cilëve merren në shqyrtim, më së shpeshti i hasim termat «ndryshimi», «përmbysja» ose «transformimi» me të cilat emërtohej ajo ngjarje.

Në këtë dorëshkrim, me qëllim të ndriçimit të këtij problemi, jemi orvatur të qëmtojmë dhe ballafaqojmë disa interpretime me peshë në mendimin bashkëkohor mbi teatrin, e njëherësh kemi zhvilluar analiza të disa veprave të Henrik Ibsenit dhe August Strindbergut. Përzgjedhja e këtyre dy dramaturgëve të mëdhenj për zbërthimin e disa aspekteve të kthesës së dramës moderne nuk është as e rastësishme e as arbitrare. Veç tjerash kemi trajtuar çështjen e përmbysjes që sjellin në krijimtarinë teatrore Ibseni dhe Strindbergu; çështjen e dramaturgjise së subjektivitetit të këta autorë; ndikimin e filozofisë së Kierkegaard-it

dhe Nietzsche-s te këta autorë; aspektet filozofike të dialogëve dhe situatave; teatri ekspresionist dhe teatri intim, teatri i ëndrrës si teatër i ri te Strindbergu, çështja e dramës së jetës etj. Dorëshkrimi ka 260 faqe.

5. Frashër Demaj, "Pozita gjeografike, politike dhe popullsia shqiptare në dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe 1912-1918".

Në këtë dorëshkrim trajtohet qëndrimi i diplomacisë britanike ndaj shtetit shqiptar gjatë viteve 1912-1918. Aty përfshihet deri në detaje funksionimi i Shqipërisë që nga pozita gjeostrategjike, fuqia e kufizuar politike dhe ushtarake, popullsia e veriut dhe e jugut, roli dhe ndikimi i fesë në shtetin e sapoformuar shqiptar si dhe pretendimet e shteteve ballkanike ndaj territorit të Shqipërisë.

Botimi do të ketë rreth 200-210 faqe, rreth 13 tabakë autori dhe planifikohet të përfshihet në planin buxhetor të vitit 2020.

6. "Hasan Prishtina në dokumentet arkivore" - grup autorësh.

Vëllimi i parë i projektit është përgatitur për botim. Në këtë botim do të përfshihen dokumente arkivore të hulumtuara në vitet e fundit. Në këto dokumente përfshihet veprimtaria politike dhe kombëtare e Hasan Prishtinës në periudhën nga viti 1910 e

deri në vrasjen e tij më 1933. Vëllimi i parë do të ketë rreth 280-300 faqe, rreth 19 tabakë autori.

7. Revista "Studime shoqërore", nr. 7. - Revistë vjetore që do të botohet gjatë vitit 2020. Në të do të botohen studime dhe artikuj shkencorë, tekste ligjërimesh inauguruese, vështirime, recensione, kritika e të tjera nga disiplinat e shkencave shoqërore.

Sekretare e Seksionit,
Anëtare korrespondente
Justina Shiroka - Pula, d.v.

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE

1. Vazhdimi i realizimit të projektit "Hulumtim mbi mundësitë e rishfrytëzueshmërisë së brezeve të reja frekuencore UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela në territorin e Kosovës" (projekt dyvjeçar 2019-2020). Bartësi i projektit është Myzafer Limani. Shpenzimet e parapara për këtë aktivitet janë të miratuara me planin e përgjithshëm buxhetor të projektit. Ky projekt është në kuadër të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve. Objektivat kryesore të projektit janë:

1) Vlerësimi eksperimental i shfrytëzueshmërisë së brezeve frekuencore UHF, VHF dhe milimetrike në Republikën e Kosovës si dhe

ndërtimi i bazës së të dhënave përkatëse;

II) Modelimi i interferencës dhe zhvillimi i pragjeve përkatëse të interferencës për shfrytëzimin e këtyre si përdorues sekondar (pa licencë);

III) Analiza softuerike e bashkekzistencës së rrjeteve heterogjene kognitive pa tela në këto breze;

IV). Realizimi i simulimeve numerike përmes platformave të përshtatshme softuerike për vlerësimin e performancës së mekanizmave për bashkekzistencën e teknologjive të ndryshme pa tela në brezin e matur frekuencor;

V) Nxjerrja e përfundimeve për skenarët më të përshtatshëm për bashkekzistencën e teknologjive të ndryshme pa tela në brezin e matur frekuencor;

VI) Njoftimi i komunitetit shkencor ndërkombëtar dhe autoriteteve rregullative në Kosovë për performancën dhe mundësinë e shtrirjes së rrjeteve kognitive heterogjene pa tela për rishfrytëzimin e brezit të licencuar frekuencor.

2. Vazhdimi i projektit “Modifikimi i sipërfaqes së qymyrit me shtresa të holla organike” (projekt dyvjeçar 2019-2020 në kuadër të kimisë së materialeve). Bartës i projektit është Fetah Podvorica. Shpenzimet e

parapara për këtë aktivitet janë të miratuara me planin e përgjithshëm buxhetor të projektit. Objektivat kryesore të projektit janë:

I. Veshja e sipërfaqes së qymyrit me grupe alkile gjatë reaksionit në mes alkilhalogjenureve dhe radikaleve arile të krijuara me anë të reduktimit të kripërave arildiazonium.

II). Vërtetimi i pranisë së shtresave të holla me grupe alkile në sipërfaqe të qymyrit me anë të metodave të ndryshme të analizës së sipërfaqeve. Këto metoda do të shërbejnë, njëkohësisht, për të gjetur kushtet optimale të formimit të këtyre shtresave si: lloji i molekulës së alkil halegjenuarit, lloji i kripës së arildiazoniumit, raporti i përqendrimeve të tyre, kohëzgjatja e modifikimit, përdorimi i ndonjë mjeti reduktues etj.

III) Përdorimi i qymyrit të modifikuar në sipërfaqe me grupet alkile për përgatitjen e membranave asimetrike heterogjene qymyr i modifikuar - acetat celuloze. Veshja e sipërfaqes së qymyrit do të bëhet me grupe të ndryshme alkile të cilat dallojnë si në përbërje kimike për shkak se ato mund të përmbajnë edhe grupe funksionale specifike po ashtu edhe në gjatësi të vargut karbonik.

IV) Testimi i efikasitetit të membranave asimetrike heterogjene qymyr i modifikuar – acetat celuloze.

V) Optimizimi i performancës së këtyre membranave të cilat përmbajnë qymyrin e modifikuar me shtresa të holla alkile.

VI) Përgatitja e shtresave të përziera organike me grupe alkile dhe arile të lidhura në sipërfaqe të qymyrit duke përdorur si gjenerator të radikaleve alkile prej alkil halogjeneve, kripërave të aril diazoniumeve, radikale të arile të cilave lidhen edhe vetë për sipërfaqe të qymyrit. Në këtë mënyrë do të përgatiten filma organikë që shfaqin në të njëjtën kohë vetitë e grupeve alkile dhe arile. Me këtë hap synojmë që të krahasojmë performancat e përgjithshme të llojeve të ndryshme të membranave duke u bazuar në qymyrin e modifikuar me shtresa të holla organike që përmbajnë vetëm grupe arile, alkile ose shtresa të përziera alkile dhe arile.

TUBIME SHKENCORE

1. Organizimi i tryezës shkencore

“Mundësitë e rishfrytëzueshmërisë së brezeve të reja frekuencore UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela”. - Me kalimin nga transmetimet televizive analoge në ato digjitale, një brez i konsiderueshëm i frekuencave është bërë i disponueshëm për shfrytëzim. Brezi frekuencor i alokuar për transmetime televizive është VHF 30-300 MHz dhe UHF 300-1000 MHz, përveç frekuencave që janë të rezervuara për shërbimet emergjente si dhe mikrofonave që përdoren në ngjarje të

ndryshme shoqërore. Ky spektër është shumë i përshtatshëm për rishfrytëzim për shkak të karaktersistikave shumë të mira të përhapjes së valëve gjatë komunikimeve pa tela, me ç'rast mundësohet mbulueshmëri shumë e madhe, si dhe për shkak se infrastruktura e nevojshme për këto komunikime është minimale, e që është ideale për zona rurale dhe vende të pazhvilluara si Kosova. Brez tjetër i rëndësisë së veçantë dhe me potencial për t'u shfrytëzuar për nevoja të komunikimeve brezgjera pa tela është edhe brezi i valëve milimetrike (30-100 GHz). Ky brez deri vonë është konsideruar i papërshtatshëm për këto lloje të komunikimeve për shkak të karakteristikave të dobëta të shpërndarjes së sinjalit, por me zhvillimin e hovshëm të sistemeve të antenave me shumë elementë dhe komunikimeve MIMO shumica e humbjeve të sinjalit mund të kompenzohen përmes antenave direksionale me përforcim të madh.

Një ndër sfidat kryesore në shfrytëzimin e këtyre brezeve, sidomos atij të licencuar nga autoritetet e vendit, do të jetë zbutja e interferencës që mund t'i shkaktohet shfrytëzuesve primarë të licencuar, p.sh. stacioneve televizive. Për tejkalimin e këtij problemi, pajisjet duhet në vazhdimësi të “ndëgjojnë” kanalën, në mënyrë që të detektojnë praninë e shfrytëzuesve primarë dhe në rast të detektimit duhet të ndalojnë funksionimin në atë kanal. Ekzistojnë tri metoda kryesore për të bërë të mundur këtë veprim nga shfrytëzuesit dytësorë:

informacionet e sinjalizimit, “dëgjimi” i spektrit dhe databaza e pozitës së shfrytëzuesve. Me përdorimin e informacioneve të sinjalizimit si metodë kontrolluese, shfrytëzuesit dytësorë do të fillojnë transmetimin vetëm nëse paraprakisht kanë pranuar një sinjal se kanali është i lirë. E meta e kësaj metode është se shkakton tejngarkesë gjatë transmetimit të sinjalizimit. Me metodën e “dëgjimit” shfrytëzuesi dytësorë do të “dëgjojë” dhe do të mundohet të detektojë prezencën e shfrytëzuesit primar, bazuar në energjinë e sinjaleve të pranuar. Vështirësia qëndron në faktin se përveç energjisë së sinjalit të detektuar duhet të dinë paraprakisht edhe disa karakteristika tjera të tij, siç janë gjerësia e brezit dhe modulimi i përdorur. Metoda e tretë bazohet në shfrytëzimin e databazave dhe përcaktimin e pozitës së shfrytëzuesve. Shfrytëzuesit duhet të komunikojnë me databaza të cilat kanë informacione lidhur me shfrytëzimin e spektrit në vendin dhe kohën e kërkuar. Databaza pastaj do të përgjigjet me listën e frekuencave të disponueshme si dhe karakteristikat e sinjalit (parametrat) në mënyrë që të realizohet transmetimi nga shfrytëzuesi dytësor. Problemi me këtë metodë paraqitet në rastet kur shfrytëzuesit dytësorë gjenden brenda në ndonjë objekt, ku pozicioni gjeografik i tyre nuk mund të bëhet i qartë për shkak të dobësisë së sinjalit.

Qëllimi i tryezës shkencore që do të organizohet në përfundim të projektit është prezantimi i rezultateve të

fituara, përfundimet dhe vlerësimet e rezultateve të publikuara si dhe idetë e reja për punën e mëtutjeshme. Në tryezë do të marrin pjesë ekipi i realizimit të projektit si dhe të gjitha palët e interesuara (ASHAK, FIEK, ARKEP, PTK, IPKO, RTP, etj.).

Tryeza propozohet të mbahet në tetor 2020. Organizator: Myzafer Limani dhe Këshilli organizativ i caktuar nga seksioni i shkencave të natyrës të ASHAK-ut në përbërje prof. Myzafer Limani, anëtare korrespondente të ASHAK-ut, akad. Isuf KRASNIQI, prof. Qami Haxhibeqiri, anëtar korrespondent i ASHAK-ut. Shpenzimet e parapara për këtë aktivitet janë të miratuara me planin e përgjithshëm buxhetor të projektit.

2 Organizimi i tryezës shkencore
 “Integriteti, etika dhe besueshmëria në institucionet kërkimore shkencore”. - Puna në institucionet kërkimore shkencore dhe komuniteti i shkencëtarëve si pjesë e tyre janë të lidhur me një sërë vlerash, traditash dhe standardesh që përfshijnë ndershmërinë, integritetin, objektivitetin, besueshmërinë dhe kolegjalitetin. Këto vlera, si edhe vlerat dhe praktikat e veçanta të disiplinave specifike shkencore duhet të reflektohen në punën tyre në vazhdimësi. Arsimi, shkenca dhe përhapja e njohurive në shoqërinë kosovare tradicionalisht kanë gëzuar një pozitë të dalluar dhe kjo shoqëri ka mirëpritur kontributet krijuese dhe inovatore të shkencëtarëve në të gjitha

fushat. Sot fushat shkencore janë gjithnjë e më të ndërthurura me çështje sociale, filozofike, ekonomike dhe politike, prandaj prej shkencëtarëve pritet që të bëhen më të përgjegjshëm ndaj shoqërisë. Ky moment është shumë i rëndësishëm që shkencëtarët individualë dhe institucionet e tyre përkatëse të rivlerësojnë vlerat dhe praktikat profesionale që udhëheqin kërkimet e tyre, si dhe përpjekjet e tyre për kryerjen e punës me integritet.

Besimi i shoqërisë dhe mbështetja e kërkimit shkencor bazohet kryesisht në besimin e publikut në integritetin e kërkuesve individualë dhe institucioneve të tyre. Niveli i besimit që karakterizon shkencën dhe marrëdhëniet e tij me shoqërinë ka kontribuar në një periudhë të diskutimeve mediale të pashembullta. Por ky besim i diskutueshëm imponon dialogun e hapur dhe të sqartë, së pari nga bashkësia shkencore për të ilustruar dhe transmetuar vlerat që lidhen me sjelljen shkencore etike. Prandaj është detyrë e të gjithë shkencëtarëve dhe e institucioneve shkencore që të krijojnë dhe edukojnë një mjedis kërkimor që promovon standarde të larta etike, kontribuon në zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe ruan besimin e publikut në kërkimet shkencore.

Për shkencëtarin individual, integriteti mishëron mbi të gjitha një angazhim për ndershmërinë intelektuale, përgjegjësinë personale dhe për një

varg praktikash që karakterizojnë sjelljen e përgjegjshme të hulumtimit. Në këto praktika përfshihen: ndershmëria intelektuale në propozimin, kryerjen dhe raportimin e hulumtimit; saktësia në përfaqësimin e kontributeve në propozimet dhe raportet e kërkimit; drejtësia në vlerësimin e punës së kolegëve; kolegjaliteti në ndërveprimet shkencore, në komunikim dhe në ndarjen e burimeve dhe transparencë në konfliktet e interesit ose konfliktet potenciale të interesit.

Shkencëtarët punojnë brenda strukturave komplekse organizative. Faktorët që nxisin sjelljen e përgjegjshme mund të ushtrojnë ndikimet e tyre në nivelin e individit; në nivelin e grupit të punës (p.sh., grupi hulumtues) dhe në nivelin e vetë institucionit kërkimor. Këto nivele të ndryshme organizative janë të ndërvarura në kryerjen e hulumtimit. Institucionet duhet të krijojnë një mjedis që nxit sjelljen e përgjegjshme, integritetin dhe besueshmërinë në shkencëtarët individualë, në institucionet gjegjëse duke rishikuar periodikisht strukturat, proceset, politikat dhe procedurat me të cilat udhëhiqen.

Qëllimet e tryezës së propozuar janë: njohja dhe identifikimi i sfidave etike me të cilat ballafaqohen të gjitha institucionet kërkimore shkencore; sqarimi i pritjeve dhe standardeve të sjelljes; pritjet dhe standardet e sjelljes; ndërtimi i vetëdijes së përbashkët për

këto çështje dhe siguri i një kornize për diskutim dhe veprim në mënyrë që të ngritet vetëdija jonë e përbashkët për këto çështje.

Tryeza propozohet të organizohet në prill 2020. Organizator: Të gjitha seksionet e ASHAK-ut dhe Këshilli organizativ i caktuar nga Kryesia e ASHAK në përbërje prof. Myzafer Limani, anëtare korrespondente e ASHAK-ut, prof. Fetah Podvorica, anëtar korrespondent i ASHAK-ut dhe anëtarët e seksioneve tjera që i propozon Kryesia. Shpenzimet e parapara për këtë aktivitet përreth 60 pjesëmarrës dhe publikimi i materialeve të konferencës në përmbledhje të punimeve kapin shumë rreth 3200 euro.

3. Organizimi i simpoziumit shkencor “Energjia e pastër dhe zhvillimi i qëndrueshëm”. - Simpoziumi do të organizohet në muajin qershor 2020.

Energjia është faktori kryesor për jetën dhe mirëqenien e njeriut dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të një vendi. Zhvillimi i hovshëm tekniko-teknologjik ka mundur shtimin e potencialeve për shfrytëzim të burimeve konvencionale dhe atyre jokonvencionale të energjisë. Megjithatë, shfrytëzimi i madh i disa prej këtyre resurseve ka bërë që të krijohet ndotja në shkallë të gjerë e mjedisit në kuadër të planetit për shkak të emitimit të madh të CO₂ dhe të mbetjeve tjera kimike. Prandaj së fundmi janë shtuar në shkallë të gjerë

kërkesat për energji të pastër dhe të mjaftueshme në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i secilit vend duke kërkuar shtimin e shfrytëzimit të energjive të rigjenerueshme, të energjisë në periudhën afatshkurtër dhe sidomos atë afatmesme.

Qëllimi i simpoziumit është që të trajtohen të gjitha aspektet e shfrytëzimit të potencialeve energjetike të vendit tonë dhe të rajonit në kuadër të kërkesave globale për energji të pastër.

Në kuadër të simpoziumit do të ketë fokusim në burimet energjetike të vendit tonë dhe shfrytëzimin sa më efikas të tyre në pajtim me kërkesat për energji të pastër.

Organizator: Seksioni i Shkencave të Natyrës dhe ai i Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut dhe Këshilli organizativ i caktuar nga seksioni në përbërje: akad. Nexhat Daci, akad. Isuf Krasniqi, akad. Fejzullah Krasniqi dhe prof. Justina Pula, anëtare korrespondente e ASHAK-ut. Shpenzimet e parapara për këtë aktivitet të rreth 70 pjesëmarrësve dhe publikimi i materialeve të simpoziumit në përmbledhje të punimeve kapin shumë rreth 3700 euro.

BOTIME

1.Revista “Resarch - Kërkime”, nr. 25. Aktualisht është në proces nxjerrja e numrit 24 të kësaj reviste, përkatësisht redaksia është në procesimin e punimeve të pranuar. Numri 25 i saj

mendohet të botohet në gjysmën e parë të vitit 2020. Punimet në revistën “Resarch - Kërkime” do të botohen në gjuhën angleze me një rezymë në gjuhën shqipe. Në këtë revistë botohen punimet origjinale shkencore të cilat i përkasin Seksionit të Shkencave të Natyrës.

Sekretari i Seksionit,
Anëtar korrespondent
Fetah Podvorica, d.v.

gurë, etj. Për ekspozitën do të përgatitet edhe botimi i katalogut.

Sekretari i Seksionit,
Anëtar korrespondent Luan Mulliqi,
d.v.

SEKSIONI I ARTEVE

BOTIME

1. Akademik Rauf Dhomi, “ Vepra pianistike” - 60 tituj. - Botimi i veprave pianistike konsiderohet i rëndësishëm në trashëgiminë artistike kombëtare. Dorëshkrimi është i gatshëm dhe përmban rreth 100 tabakë autori.

EKSPOZITA

1. Ekspozitë personale me veprat e akademik Rexhep Ferrit me titull “Afër dhe larg”. Ekspozita do të organizohet në mjediset e Akademisë. Në të do të përfshihen rreth 50 punime të reja të krijimtarisë së autorit në tri vitet e fundit. Për ekspozitën do të përgatitet edhe botimi i katalogut.

2. Ekspozitë personale e anëtarit korrespondent Luan Mulliqi në Podgoricë. Ekspozita do të përfshijë rreth 60 vepra artistike të cikleve të ndryshme të punuara në dru, bronz,

PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS



PROCESVERBAL

Nga mbledhja XCVI e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës mbajtur më 21 shkurt 2019, në orën 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Bardh Rugova, Fetah Podvorica, Gjyljeta Mushkolaj, Justina Pula, Kujtim Shala, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Muhamedin Kullashi, Myzafer Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Xhevdet Xhafa.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Nexhat Daci.

Kuvendi miratoi këtë

rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCV të Kuvendit të Akademisë;

2. Miratimi i Raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2018;

3. Miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2018;

4. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes XCV i Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Kuvendi shqyrtoi Raportin e punës të ASHAK-ut për vitin 2018, me radhë sipas seksioneve. Kryetari Daci tha se materialet janë ndarë me kohë dhe tani do ta shqyrtojmë Raportin e punës sipas radhës duke filluar nga Kuvendi, Kryesia, seksionet dhe Shërbimi profesional, administrativ e teknik.

Gjatë shqyrtimit të raportit të punës të Kryesisë së ASHAK-ut diskutuan S. Hamiti, M. Dushi, H. Islami, N. Daci, M. Kraja, Z. Ballata.

S. Hamiti paraqiti disa vërejtje për përmbajtjen e Raportit, duke thënë se duhet t'i jepet rëndësi formulimeve, meqë Raporti është dokument i punës njëvjeçare, botohet në Vjetari dhe propozoi që në perspektivë duhet të ndryshohet përmbajtja e tij. Ai po ashtu tha se promovimi i të gjitha botimeve të Akademisë duhet të pasqyrohet në Kronikën vjetore të Akademisë.

M. Dushi, diskutoi për projektet e Akademisë, dy prej tyre të Seksionit të

Shkencave të Natyrës: “Kadastr i ndotësve të ujërave efluentë në recipientë dhe trajtimi i tyre (me biosorbentë dhe osmozë reverse)” dhe “Parametrat e jashtëm projektues të klimës për disa qytete të Kosovës”, si dhe një i Seksionit të Shkencave Shoqërore “Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës (Tablloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale)”. Qendrat urbane.

Pas fjalës së M. Dushit, kryetari Daci në fjalën e tij tha se diskutimi i M. Dushit nuk ka të bëjë me rendin e ditës dhe nuk do të duhej të përfshihej në procesverbal, por duke qenë se kemi konsideratë ndaj akademik Dushit, kësaj radhe e dëgjuam diskutimin e tij, por herëve të tjera do t’i përmbahemi vetëm rendit të ditës. Ai më pas tha se propozimet për projekte i kanë kaluar të gjitha procedurat e rregullta nëpër seksione, Kryesi dhe Kuvend dhe janë miratuar në pajtim me aktet normative të ASHAK-ut.

M. Dushi më pas u paraqit edhe një herë për diskutim dhe tha se ky është Kuvend pune dhe këtu diskutohet ecuria e punës së Akademisë e këtu hyjnë edhe projektet për të cilat u diskutua.

Në vazhdim diskutoi H. Islami, i cili duke u ndërlidhur me diskutimet e paraflësve, paraqiti sqarimet e detajuara për projektin “Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës (Tablloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale)” - Qendrat urbane, i cili i

ka kaluar të gjitha procedurat e rregullta të miratimit nëpër instancat e Akademisë.

Më pas filloi shqyrtimi i Raportit të punës së seksioneve. M. Kraja propozoi që në të ardhmen Raporti i punës së ASHAK-ut të diskutohet fillimisht nëpër seksione e më pas në Kryesi, sepse kur seksionet e kanë raportin e përgjithshëm, e kanë të mundur të bëjnë vërejtje dhe sugjerime dhe të eliminohen paqartësitë para se Raporti të paraqitet në Kuvend. Ai më pas paraqiti disa vërejtje për Raportin e punës së Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe në Seksionin e Arteve. Pas diskutimit të M. Krajës, J.Pula dhe L. Mulliqi thanë se pajtohen me vërejtjet dhe se do ta plotësojnë Raportin të cilin do t’ia dërgojnë sekretares së Akademisë.

Për Raportin e punës diskutoi edhe Z. Ballata, i cili propozoi që pikat e propozuara duhet të precizohen dhe të realizohen sipas planit.

Raporti i punës së ASHAK-ut për vitin 2018 u miratua me plotësimet që u propozuan. Raporti është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe do të botohet në Vjetari 2018.

Më pas u shqyrtua Raporti financiar i Akademisë për vitin 2018.

M. Kraja në diskutimin e tij tha se Raporti financiar si i tillë është vështirë të diskutohet, meqë nuk ka parametra krahasues, kjo për arsye se planifikimi i

buxhetit nuk ka kaluar nëpër seksione. Ai propozoi që në të ardhmen planifikimi i buxhetit të kalojë nëpër seksione e jo vetëm në Kryesi, sepse kur seksionet marrin pjesë në planifikimin e buxhetit mund të caktohen më mirë prioritetet. Me propozimin u pajtua edhe kryetari Daci, i cili njëherësh njoftoi se Kryesia ka vendosur që tani e tutje edhe propozimet për Programin e punës për vitin vijues të shoqërohen me vlera financiare. L. Mulliqi në diskutimin e tij tha se pajtohet me propozimin e M. Krajës. Ai tha se duhet të bëhet një parallogari nga të gjitha seksionet, sepse që nga fillimi i vitit sekretarja shkencore ka kërkuar nga sekretarët e seksioneve shënimet për të filluar procedurat e tenderimit për botimin e librave dhe asnjëri nuk i ka paraqitur shënimet e plota. Edhe vitin që shkoi ka qenë kërkesa që pikat e Programit të punës të shoqërohen me vlera financiare, por kjo kërkesë nuk është përmbushur në tërësi dhe nëse vazhdohet në këtë formë nuk mund të kemi planifikim të mirë të buxhetit dhe nuk mund të kemi edhe realizim të mirë të aktiviteteve.

Pas diskutimeve Kuvendi miratoi Raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2018, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe do të botohet në Vjetari 2018.

Mbledhja u mbyll në orën 12:30.

Procesmbajtëse
Lendita Pula

Kryetari i Akademisë
Akademik Nexhat Daci

PROCESVERBAL

Nga mbledhja XCVII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës mbajtur më 6 qershor 2019, në orën 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Ekrem Murteza, Eqrem Basha, Fejzullah Krasniqi, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Bardh Rugova, Edi Shukriu, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Justina Pula, Kujtim Shala, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Muhamedin Kullashi, Myzafer Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Xhevdet Xhafa.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë akademik Nexhat Daci.

Para miratimit të rendit të ditës Kryetari Daci kërkoi nga L. Pula të parqesë shënimet për prezencën e anëtarëve të Akademisë. L. Pula e njoftoi Kuvendin se në sallë janë të

pranishëm 34 anëtarë të Akademisë, nga 37 sa janë gjithsej. Akademikët Isa Mustafa dhe Zeqirja Ballata mungojnë dhe për këtë kanë njoftuar paraprakisht.

Për akademik R. Qosja, në bazë të Statutit të Akademisë, neni 29, paragrafi 14, ajo tha se është vendosur në mbledhjet paraprake të mos përfshihet në kuorum, ndërsa për akademikët I. Mustafa dhe Z. Ballata i mbetet Kuvendit të vendosë. Nëse nuk vendoset ndryshe, kuorumi mbetet 19. Pra 19 vota duhet t'i fitojë kandidati për t'u zgjedhur në pozitën e kryetarit të Akademisë.

Kuvendi konstatoi që kuorumi mbetet 19.

Më pas Kuvendi miratoi këtë

rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCVI të Kuvendit të Akademisë;
2. Caktimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë;
3. Votimi për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë dhe shpallja e rezulttit të votimit;
4. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Para miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, M. Dushi kërkoi që procesverbali të shtyhet për miratim në një mbledhje të radhës. Ai tha se për procesverbalin ka mjaft për të diskutuar dhe meqë kjo mbledhje është zgjedhore të mos zgjatet me diskutime të tjera.

Kryetari Daci kërkoi qëndrimin e Kuvendit. Diskutuan S. Hamiti, Z. Rrahmani, H. Islami dhe pas diskutimeve ai konstatoi që rendi i ditës i miratuar në fillim të mbledhjes mbetet i njëjtë, ashtu siç është paraqitur në materialet e mbledhjes, pa ndryshime, ndërsa M. Dushi për çështje pune mund të diskutojë në një mbledhje tjetër.

Procesverbali i mbledhjes XCVI i Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Kryetari Daci propozoi Feriz Krasniqin, kryetar, dhe Eqrem Bashën e Luan Mulliqin, anëtarë të Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë.

Propozimi u miratua njëzëri nga Kuvendi.

Ad. 3.-

Para fillimit të procesit të votimit L. Pula, me kërkesë të kryetarit Daci, e njoftoi Kuvendin se sipas Rregullores

për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, në votimin e parë votohet për të dy kandidatët. Nëse në votimin e parë asnjëri nga kandidatët nuk e fiton numrin e nevojshëm të votave, votimi përsëritet për kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave apo për kandidatët që kanë numër të njëjtë të votave.

Më pas u shpërndanë fletëvotimet.

Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë votuan 34 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 26 fletëvotime të vlefshme dhe 8 fletëvotime të pavlefshme.

1. Akademik Anton K. Berishaj mori 14 vota;
2. Akademik Mehmet Kraja mori 12 vota.

Pas votimit të parë Kryetari Daci, noftoi se votimi duhet të përsëritet edhe një herë. Para nisjes së votimit të dytë diskutuan A. Aliu dhe L. Mulliqi. A. Aliu propozoi që para se të shkohet në votimin e dytë të hapet një debat i diskutimit për pasqyrën dhe mënyrën e votimit, rezultatet dhe për kandidatët, ndërsa L. Mulliqi në fjalën e tij tha se në votimin e dytë është mirë të votohet, të mos ketë vota të pavlefshme dhe të ketë rezultat pozitiv.

Kryetari Daci tha se e vlerëson propozimin e A. Aliut, por procesi ka filluar dhe nuk mund të pranohen diskutimet. Diskutoi edhe R. Ismajli, i cili tha se në raste të tilla nuk mund të ketë diskutime, procesi ka filluar dhe le të vazhdojnë procedurat.

Pas diskutimeve u ndanë fletëvotimet për votimin e dytë.

Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë: votuan 34 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 28 fletëvotime të vlefshme dhe 6 fletëvotime të pavlefshme.

1. Akademik Anton K. Berishaj mori 14 vota;
2. Akademik Mehmet Kraja mori 14 vota.

Pas shpalljes së rezultatit të votimit kryetari Daci tha se zgjedhjet nuk patën sukses dhe tani do të vazhdojmë me procedurat ligjore.

Ai më pas kërkoi nga L. Pula sqarimet ligjore. L. Pula e njoftoi Kuvendin se në bazë të akteve normative të ASHAK-ut zgjedhja e kryetarit të Akademisë konsiderohet e dështuar. Tani i mbetet Kryesisë që brenda javës që vjen të marrë vendim për veprimet e radhës.

Seanca zgjedhore e radhës duhet të thirret gjithnjë së paku 30 ditë përpara.

Në fund diskutoi H. Islami. Ai tha se Kuvendi nuk rezultoi pozitivisht, por procesi ishte demokratik, gjëra të tilla ndodhin dhe janë normale. Ai tha se Akademia e ka Kryesinë legjitime dhe puna nuk ndalet. Sipas akteve normative të ASHAK-ut, kryetarit aktual më 26 korrik i ndërpritet ushtrimi i funksionit udhëheqës dhe atë pas datës 26 korrik e deri në zgjedhjen e kryetarit e zëvendëson nënkryetari i Akademisë.

Mbledhja u mbyll në orën 12:10

Procesmbajtëse
Lendita Pula

Kryetari i Akademisë
Akademik Nexhat Daci

PROCESVERBAL

Nga mbledhja XCVIII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës mbajtur më 27 qershor 2019, në orën 11:00, në mjediset e Akademisë, ku merrnin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Eqrem Basha, Fejzullah Krasniqi, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Edi Shukriu,

Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Justina Pula, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Muhamedin Kullashi, Myzafere Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Xhevdet Xhafa.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Nexhat Daci.

Më pas Kuvendi miratoi këtë

rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCVII i Kuvendit të Akademisë;
2. Miratimi i Programit të punës të ASHAK-ut për vitin 2020 dhe
3. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes XCVII i Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Kryetari Daci në fjalën e tij tha se Programi i punës u është ndarë me kohë të gjithë anëtarëve të Akademisë bashkë me materialet e mbledhjes dhe tani jemi këtu për ta shqyrtuar dhe miratuar atë.

Ai më pas tha se gjatë shqyrtimit të programit të punës me radhë sipas seksioneve, sekretarët e seksioneve janë të lirë të japin sqarime nëse e konsiderojnë të nevojshme, edhe pse, siç tha ai, secili seksion e ka shqyrtuar dhe miratuar programin e punës së tij në mbledhjet e rregullta.

Kuvendi njëzëri e miratoi Programin e punës së Akademisë për vitin 2020, i cili i bashkëlidhet këtij procesverballi dhe do të botohet në Vjetari 2019.

Ad. 3.-

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës kryetari Daci pasi mori konfirmimin nga Kuvendi se nuk ka asgjë për të diskutuar e shpalli të mbyllur me sukses mbledhjen e Kuvendit.

Pas fjalës së kryetarit fjalën e mori M. Dushi, i cili tha se do të diskutojë për procesverballin e mbledhjes XCVI dhe e filloi diskutimin. Me këtë rast reaguan H. Islami, A. Aliu, R. Ismajli, J. Bajraktari, të cilët thanë se procesverballi i mbledhjes XCVI është miratuar unanimisht nga Kuvendi sipas rregullit në mbledhjen XCVII dhe kjo çështje konsiderohet e mbyllur.

Më pas kryetari Daci tha se kjo mbledhje filloi sipas rregullit, rendi i ditës u miratua unanimisht dhe në kuadër të pikës së fundit Çështje vijuese, Kuvendi u deklarua unanimisht se nuk ka asgjë për të diskutuar,

prandaj mbledhja konsiderohet e përfunduar.

M. Dushi vazhdoi diskutimin, por disa anëtarë të Akademisë e lëshuan sallën. Kryetari Daci, pasi kërkoi edhe një herë nga M. Dushi të ndërprejë diskutimin, tha se mbledhja ka përfunduar dhe bashkë me nënkryetarin Bajraktari e lëshuan mbledhjen.

Mbledhja u mbyll në orën 11:55.

Procesmbajtëse
Lendita Pula

Kryetari i Akademisë
Akademik Nexhat Daci

PROCESVERBAL

Nga mbledhja XCIX e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës mbajtur më 3 tetor 2019, në orën 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Ekrem Murtezai, Eqrem Basha, Fejzullah Krasniqi, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Bardh Rugova, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Justina Pula, Kujtim Shala Luan Mulliqi, Mehmet Halimi,

Muhamedin Kullashi, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Xhevdet Xhafa.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi nënkryetari i Akademisë, akademik Jusuf Bajraktari, i cili në bazë të shënimeve që u morën, konstatoi se në sallë janë të pranishëm 33 anëtarë të Akademisë. Ai njoftoi se përveç akademik Rexhep Qosjes, i cili nuk përfshihet në kuorum, mungojnë edhe akademik Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrespondente Edi Shukriu dhe Myzafer Limani dhe se të tretë kanë njoftuar me kohë se nuk mund të jenë prezentë sot.

Ai propozoi që Kuvendi të marrë vendim për mospërfshirjen në kuorum të anëtarëve të lartpërmendur dhe kërkoi nga sekretarja e Akademisë të paraqesë bazën ligjore.

L. Pula e njoftoi Kuvendin se Statuti i Akademisë, neni 29, paragrafi 14, përcakton se: "Kuvendi në mbledhjen përkatëse mund të vendosë që në kuorum të mos përfshihen anëtarët të cilët për shkak të sëmundjes së gjatë ose për ndonjë arsye tjetër janë të penguar të marrin pjesë në punën e Akademisë".

Bazuar në Statutin e Akademisë, J. Bajraktari më pas propozoi që, akademik Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrespondente Edi Shukriu e

Myzafer Limani të mos përfshihen në kuorum.

Propozimi u miratua nga Kuvendi.

Nënkryetari më pas para fillimit të shqyrtimit të pikave të rendit të ditës kërkoi edhe një herë nga sekeratrja e Akademisë sqarimet përkatëse.

L. Pula tha se pas vendimit të Kuvendit që në këtë mbledhje të mos përfshihen në kuorum katër anëtarë të Akademisë, konstatohet se kuorumi për sot është 17, pra për kryetar të Akademisë konsiderohet i zgjedhur kandidati që fiton 17 vota.

Nëse për funksionin e caktuar asnjëri nga kandidatët nuk fiton mbi gjysmën e numrit të votave (17), votimi përsëritet për kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave ose për kandidatët që kanë numër të njëjtë të votave.

Kuvendi miratoi këtë

rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes XCVIII i Kuvendit të Akademisë;
2. Caktimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë;
3. Votimi për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë dhe shpallja e rezultatit të votimit;

4. Çështje vijuese.

Akademik Mehmet Kraja u zgjodh kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes XCVIII i të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje. Pas miratimit të procesverbalit M. Dushi e kërkoi fjalën, por nënkryetari tha se rendi i ditës dhe procesverbali u miratuan me shumicën e votave të Kuvendit dhe tani do t'i përbahemi rendit të ditës, meqë kjo seancë ka karakter jo vetëm zgjedhor, por edhe solemn.

Kryetari i zgjedhur e fillon mandatin menjëherë dhe e ushtron atë deri në zgjedhjet për Kryesinë e re, deri në fund të vitit 2021.

Mbledhja u mbyll në orën 11:45.

Procesmbajtëse
Lendita Pula

Ad. 2.-

Nënkryetari i Akademisë
Akademik Jusuf Bajraktari

Kuvendi caktoi Komisionin e zgjedhjeve me këtë përbërje: Feriz Krasniqi, Justina Pula dhe Luan Mulliqi.

Ad. 3.-

Më pas u shpërndanë fletëvotimet.

Pas votimit me vota të fshehta Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë: votuan 33 anëtarë të ASHAK-ut. U gjetën 31 fletëvotime të vlefshme dhe 2 fletëvotime të pavlefshme.

1. Akademik Isuf Krasniqi mori 8 vota.

2. Akademik Mehmet Kraja mori 23 vota.

KRONIKA E VITIT 2019

KUMTESË E SEKSIONIT TË SHKENCAVE SHOQËRORE DHE E SEKSIONIT TË ARTEVE TË ASHAK-UT LIDHUR ME DISKURSIN RRETH SOVRANITETIT DHE INTEGRITETIT TERRITORIAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Më 11 shkurt 2019 Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Seksioni i Arteve i ASHAK-ut paraqitën kumtesën për opinion si më poshtë:

“Në vigjilje të shënimit të njëmbëdhjetëvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe njëzetvjetorit të operacioneve të NATO-s dhe çlirimit të Kosovës, shprehim shqetësime serioze lidhur me diskursin politik, veçanërisht nga bartës të përgjegjësive institucionale, përkitazi me fazën e fundit të procesit të dialogut mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Janë të papranueshme mungesa e platformës unike shtetërore dhe qëndrimet kontraverze e përçarëse ndërmjet bartësve të institucioneve kryesore të Kosovës.

Duke vlerësuar maksimalisht kontributin e SHBA-së, BE-së dhe miqve të tjerë në konsolidimin e shtetësisë së Kosovës, shprehim bindjen se ata do të vazhdojnë të mbështesin pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës. Kjo përkrahje posaçërisht është e nevojshme në kohën e letërkëmbimeve diplomatike ku për interesa vetjake po trumbetohet për

gjoja gatishmërinë për të “bërë kompromise të dhimbshme për marrëveshjen historike midis Kosovës e Serbisë”, ndërsa neglizhohen pasojat e rrezikshme për fillimin e serishëm të konflikteve dhe gjakderdhjeve të reja në Ballkan dhe më gjerë. Ky ndryshim eventual i kursit do të ishte kthim prapa i përpjekjeve njëzetvjeçare ndërkombëtare për krijimin e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe në Evropë.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës për më shumë se katër dekada të ekzistimit të saj në asnjë rast nuk ka qëndruar indiferente ndaj zhvillimeve të mëdha shoqërore dhe politike. Akademia e ka shprehur publikisht mendimin shkencor për shumë çështje në momentet kyçe të zhvillimeve shoqërore dhe politike: nga Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990 dhe gjatë gjithë viteve të 90-ta, pas luftës është shprehur disa herë për statusin e Kosovës, për bisedat e Vjenës 2005-2007, për Mitrovicën dhe Veriun e vendit, për Kushtetutën, për Planin e Ahtisarit, për decentralizimin, për Luginën e Preshevës, për trashëgiminë kulturore, për regjistrimin e popullsisë, për procesin e anëtarësimit në UNESCO, për sjelljen e SANU-s ndaj Kosovës dhe shqiptarëve etj. Për të gjitha këto çështje Akademia ka shprehur qëndrime publike, ka mbajtur disa tryeza dhe konferenca shkencore, ka botuar studime, monografi dhe libra shkencorë.

Diskursi i tensionuar për ndryshimin e kufijve midis Kosovës dhe Serbisë si ide dhe plan i vjetër serb në formë të “korrigjimit”, “shkëmbimit” dhe “ndarjes” së Kosovës është me pasoja shumë të dëmshme për pavarësinë, sovranitetin shtetëror dhe integritetin territorial të Kosovës dhe interesave të saj.

Andaj:

1. Republika e Kosovës fazën përfundimtare të dialogut me Republikën e Serbisë duhet ta zhvillojë brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor në fuqi dhe në mbështetje të kompetencave kushtetuese të institucioneve shtetërore.

2. Republika e Kosovës fazën vijuese përfundimtare të dialogut duhet ta zhvillojë në zbatim të obligimeve të pranuar ndërkombëtare konform Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, A/RES/64/298 të 9 shtatorit 2010 me të cilën pranohet Opinioni këshillues i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi përputhshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës me të Drejtën Ndërkombëtare, me të cilën është hapur rruga për të hyrë në dialogun ndërshtetëror me Republikën e Serbisë, të ndihmuar nga Bashkimi Evropian.

3. Republika e Kosovës, mund të zhvillojë fazën përfundimtare të dialogut përballë Serbisë a palëve të treta vetëm si shtet i pavarur, sovran, i njohur ndërkombëtarisht nga 115

shtete dhe i konfirmuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (Ligjshmëria e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës më 22 korrik 2010) nën kornizat kushtetuese:

3.1. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm siç përcaktohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

3.2. Rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovrane e institucioneve shtetërore, e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

3.3. Plani i Ahtisarit është platforma e vetme për rregullimin e të drejtave dhe të garancive për komunitetet, i integruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ofron gamë të gjerë të drejtash të veçanta për komunitetin serb, i cili tejkalon standardet ndërkombëtare për të drejtat e minoriteteve (komuniteteve).

3.4. Asociacioni i komunave me shumicë serbe në Kosovë mund të themelohet në përputhje të plotë me Aktgjykimin në rastin nr. KO130/15, të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në mënyrë që të ruhet karakteri unitar i Republikës së Kosovës, si dhe funksionaliteti i shtetit.

4. Republika e Kosovës nuk duhet të lejojë a të pranojë të negociohet çfarëdo ndryshimi i kufijve midis Kosovës dhe Serbisë në formë të

“korrigjimit”, të “shkëmbimit” dhe të “ndarjes” së Kosovës, sepse kjo do të kishte pasoja të pariparueshme për shtetësinë dhe subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. Veçanërisht kur kihet parasysh fakti që Dokumenti i Presidentit Marti Ahtisari dhe dokumentet e tjera, si: Kushtetuta e KSA të Kosovës e vitit 1974, Deklarata e Pavarësisë e 17 shkurtit 2008, Kushtetuta e Republikës e vitit 2008 dhe Mendimi Këshillues i lartpërmendur i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, harta e KFOR-it që i përcakton qartë kufijtë e Kosovës, të kornizuar në 10.905 km², të cilat i referohen tërësisë aktuale territoriale në të cilën janë të përcaktuar kufijtë e Kosovës.

5. Çdo ndarje territoriale-etnike e Kosovës jashtë kufijve të përcaktuar qartë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës do të rrezikonte mosekzistimin e saj si shtet i pavarur dhe sovran, sikundër që copëtimi i Luginës së Preshevës do ta fshinte atë si entitet. Çdo diskutim për çështjen e kufijve do të rrezikonte presionin aktual të Bashkimit Evropian ndaj Republikës së Serbisë për decentralizimin e pushtetit në favor të autonomisë lokale e cila direkt do të ndikonte në zhvillimin e Luginës së Preshevës.

6. Republika e Kosovës në fazën vijuese përfundimtare të dialogut duhet ta shfrytëzojë si mundësi të papërsëritshme për avancimin e pozitës kushtetuese dhe të drejtave legjitime të shqiptarëve të Preshevës,

Bujanocit dhe të Medvegjës, paralelisht me ato të serbëve të Kosovës mbi bazën e parimit të reciprocitetit.

7. Një konsensus politik e kombëtar është i domosdoshëm në mënyrë që procesi i dialogut të përmbyllet me sukses të plotë dhe në përputhje me interesat e Republikës së Kosovës.

8. Republika e Kosovës fazën përfundimtare të dialogut duhet ta zhvillojë në koordinim dhe në bashkërendim të ngushtë me aleatët perëndimorë, si SHBA-në dhe BE-në, në mënyrë që përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave kombëtare në këtë proces të jetë vijimësi e kontributit të partnerëve strategjikë sikurse në fazën e luftës për liri, për shtet, për paqe, për siguri dhe për stabilitet rajonal.

Me këtë rast kërkojmë nga Presidenti, Kryeministri e në veçanti nga deputetët e Parlamentit të Kosovës të qëndrojnë të palëkundshëm në mbrojtjen e tërësisë dhe të sovranitetit territorial të Republikës së Kosovës”.

KUMTESË PËR MEDIA E KRYETARIT TË ASHAK-UT, AKADEMIK NEXHAT DACIT

Në lidhje me kumtesën e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe të Seksionit të Arteve të ASHAK-ut për diskursin rreth sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës duam të sqarojmë si më poshtë:

Qëndrimet e ASHAK-ut nënshkruhen nga kryetari i ASHAK-ut apo me

autorizim të tij nënshkruhen edhe nga nënkryetari dhe sekretari shkencor.

Në këtë rast qëndrimet janë nënshkruar nga sekretarët e dy seksioneve, anëtarja korrespondente znj. Justina Pula në emër të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe anëtar i korrespondent z. Luan Mulliqi në emër të Seksionit të Arteve.

Prandaj qëndrimet e paraqitura në kumtesën e publikuar janë qëndrime të këtyre dy seksioneve dhe jo qëndrime të ASHAK-ut.

NDAHET NGA JETA AKADEMIK IDRIZ AJETI

Më 13 shkurt 2019 në Prishtinë, në moshën 102-vjeçare, ndërroi jetë albanologu, gjuhëtari e intelektual, pedagogu dhe veprimtari i palodhshëm në zhvillimet tona shoqërore, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe kryetar i saj në dy mandate, anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Idriz Ajeti. Dijetar e erudit, personalitet shkencor pa kontributet e të cilit studimet albanologjike në Kosovë e më gjerë nuk do të ishin këto që janë sot, akademik Ajeti ishte dhe mbetet njëra nga figurat më të ndritshme të historisë sonë të re.



Lindi në Tupallë të Jabllanicës së Epërme me 27 janar 1917. Shkollën fillore e kreu në Banjë të Sijarinës, të mesmen në Shkup më 1938. Po atë vit u regjistrua në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Zagrebit, në Degën e Romanistikës. Studimet i mbaroi pas lufte më 1949 në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Beogradit. Deri në vitin 1953 ishte profesor i gjuhës shqipe në Gjimnazin e Prishtinës. Në vitet 1953-1960 punoi lektor në Degën e Albanologjisë në Beograd. Në vitin 1958 u doktorua me temën “Zhvillimi historik i së folmes gege të shqiptarëve të Zarës së Dalmacisë”. Nga viti 1960 ka dhënë mësim në Degën e Gjuhës e të Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Filozofisë të Prishtinës, një herë docent, pastaj profesor inordinar dhe nga viti 1968 profesor ordinar. Fushat kryesore të interesimit të tij shkencor kanë qenë studimet e dialekteve nga pikëpamja diakronike, raportet e shqipes me gjuhët fqinje në rrafshin e studimeve ballkanologjike, trajtimi i dokumenteve të hershme gjuhësore, shkruar me alfabet arabo-turk etj. Është marrë dhe me çështje të gjuhës së sotme shqipe dhe ka organizuar takime e konsulta gjuhësore për të kërkuar zgjidhjet e përhershme rreth njësisimit të gjuhës shqipe. Prof. Ajeti ka

merita të veçanta në proceset e standardizimit të shqipes.

Veprimtaria e tij shkencore është e gjerë dhe e gjithanshme. Ka botuar: Pamje historike e ligjërimet shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX (1960), Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra (1961), Hymje në historinë e gjuhës shqipe (1963), Ortografia e gjuhës shqipe (bashkautor) (1964), Historia e gjuhës shqipe (Morfologjia historike), (1969), Probleme të historisë së gjuhës shqipe (1971), (zgjodhi e mbarështroi), Studije iz istorije albanskog jezika (1982), Studime gjuhësore në fushë të shqipes I (1982), II (1985), III, IV (1989), Shqiptarët dhe gjuha e tyre (1994). Në Prishtinë, Tiranë e gjetiu janë botuar vëllime me studime të zgjedhura të tij. Ka hartuar tekste shkollore për nxënës të shkollave të mesme e studentë të Degës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe.

Në vitet 1997-2002 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës botoi veprën e tij të plotë në pesë vëllime.

Në bibliografinë e tij gjejmë qindra artikuj, studime, kumtesa të mbajtura në konferenca shkencore, seminare, takime kombëtare e ndërkombëtare të botuara në revista e periodikë në shqip, por edhe në gjermanisht, frëngjisht apo në gjuhë të tjera.

Me nismën e tij, si shef i Departamentit të Gjuhës Shqipe pas hapjes së

Fakultetit në Prishtinë (1960), u nxor revista shkencore “Gjurmime albanologjike” (1962) e më 1974 u organizua Seminari i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare për të Huaj.

Gjatë vitit 1969-1971 ishte drejtor i Institutit Albanologjik, më 1971-73 dekan i Fakultetit Filozofik, në vitet 1973-75 rektor i Universitetit të Prishtinës.

Anëtar i ASHAK-ut u zgjodh me gjeneratën e parë të akademikëve dhe menjëherë mori titullin akademik, ndërsa në vitin 1979 u zgjodh kryetar i saj deri më 1981. Më 1996 ai do të rizgjidhet kryetar dhe do ta drejtojë Akademinë deri më 1999.

Prania e Idriz Ajetit në jetën shkencore e kulturore, si dhe në të gjitha zhvillimet shoqërore, ka qenë e dukshme dhe thelbësore. Puna e tij është shtrirë edhe në fushën e të drejtave të njeriut dhe në veprimtarinë shoqërore. Akademik Idriz Ajeti ka qenë Kryetar i Parlamentit të Kosovës në njërën nga periudhat më të vështira të saj si dhe pjesëmarrës i Konferencës së Rambujesë.

Me vdekjen e Akademik Idriz Ajetit Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka humbur autoritetin nga më të mëdhenjtë të punës shkencor te ne, profesorin, veprimtarin, njeriun e urtë dhe të dijshtëm.

Mbledhja komemorative u mbajt në mjediset e Akademisë më 13 shkurt në orën 13:00.

Mbledhjen e hapi akademik Nexhat Daci, kryetar i ASHAK-ut, ndërsa për jetën dhe veprën e akademik Ajetit foli akademik Rexhep Ismajli.

Pas mbledhjes komemorative u bënë homazhe nga një numër i madh i qytetarëve.

Akademik Ajeti u varros në varrezat e Prishtinës. Atje fjalën lamtumirëse e mbajti akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar i ASHAK-ut.

NDAHET NGA JETA ANËTARI I JASHTËM I AKADEMISË PROFESOR ERIC PRATT HAMP

Në mëngjesin e hershëm të datës 18 shkurt 2019 nga profesor Victor Friedman nga Çikago erdhi lajmi i hidhur për shuarjen e albanologut më të madh amerikan dhe njërit nga gjuhëtarët e shquar të botës në fushën e studimeve krahasuese. Lajmin e kishte transmetuar te profesor Friedman e bija e të ndjerit, Juli.

Eric Pratt Hamp ka lindur në nëntor 1920 në Londër, ndërsa nga 1925 ka jetuar dhe vepruar në SHBA. Pas studimeve të shkëlqyera të rregullta dhe doktrale në Harvard, kohën më të madhe punoi në Universitetin e Chicago-s, ku e përfundoi punën si profesor emeritus. Gjuhëtar me renome ndërkombëtare, studiues nga më të shquarit në fushën e gjuhësisë

krahasimtare-historike, indoeuropeist, ballkanolog, keltolog, romanist-rumanist, armenist, sllavist, gjithsesi albanolog me kontakte shumë të hershme me botën shqiptare në Kosovë, në Malin e Zi, në Maqedoni, me botën arbëreshe në Itali dhe me botën arbërore në Greqi, me studiuesit dhe intelektualët e shquar në diasporë, pas viteve '90 dhe në Shqipëri, me lidhje të forta të miqësisë intelektuale gjithandej nëpër Ballkan e në botë.

Me shuarjen e profesor Eric Pratt Hamp-it familja dhe miqtë kanë humbur më të dashurin e tyre, ndërsa studimet albanistike kanë humbur një nga shtyllat e tyre më të mëdha ndërkombëtare, bota shkencore ka humbur studiuesin e shquar të fushave të gjuhësisë krahasimtare, keltologjia njërën nga studiuesit më të veçantë, ballkanistika në përgjithësi ka humbur njërën prej ideuesve gjithnjë të rinj, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës humbi një nga anëtarët dhe mbështetësit e saj të shquar.

ANËTAR KORRESPONDENT ARSIM BAJRAMI QËNDRON NË SALZBURG

Me ftesë të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve (EASA), anëtar korrespondent Arsim Bajrami mori pjesë në mbledhjen e rregullt të Asamblesë së Përgjithshme të EASA-s, në Salzburg, më 1-4 mars. Në këtë mbledhje profesor Bajrami u zgjodh anëtar i rregullt i Komisionit për akte normative.

ASHAK-u paraqitet me botimet e veta në Panairin e Parisit dhe në Panairin e Leibzingut Panairi ndërkombëtar i librit "Salon du Livre de Paris", një nga ngjarjet më të madha të kësaj natyre në Evropë, është mbajtur në Paris nga data 15 deri 19 mars. Sikurse në vitet e mëhershme, ASHAK ka autorizuar Shoqatën e Botuesve të Kosovës që të prezantojë botimet e Akademisë. Botimet e ASHAK-ut janë prezantuar në një stendë të përbashkët me botuesit kryesorë të Kosovës.

Panairi i Leibzingut. - Në vitin 2019 Kosova ka marrë pjesë për herë të parë në Panairin e Librit në Leipzig, që njihet edhe si Panairi i Autorëve të Evropës Lindore dhe Juglindore. Panairi është mbajtur nga data 21-24 mars. Në të janë prezantuar disa botime të ASHAK-ut, si pjesë e një prezantimi të botuesve kryesorë të Kosovës organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës.

PROF. FETAH PODVORICA U ZGJODH ANËTAR KORRESPONDENT I ASHAL TË DIJONIT TË FRANCËS

Prof. Fetah Podvorica, anëtar korrespondent i ASHAK-ut, më 10 prill 2019, në Akademinë e Shkencave e të Arteve dhe të Letërsisë të Dijonit të Francës (themeluar më 1740) mbajti ligjëratën inauguruese "Modification des surfaces de matériaux avec des groupes organiques et dégradation de polluants organiques persistants par voie électrochimique".

Pas ligjëratës dhe debatit me publikun, prof. Podvoricës iu dorëzua nga kryetari i kësaj Akademie, akademik Christian Tavernier, certifikata e pranimit anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave e Arteve dhe të Letërsisë të Dijonit të Francës.

PËRURORHET LIBRI I AKADEMIK SABRI HAMITI "TESTAMENTI"

Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës më 11 prill 2019 është promovuar libri i Sabri Hamitit "Testamenti", botuar nga SGJL i ASHAK-ut më 2018. Për këtë botim dhe për vëllimin me poezi Kukata e Sokratit folën Ali Aliu, Rexhep Ismajli, Nusret Krasniqi dhe Muhamet Hamiti. Testamenti ishte promovuar edhe në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë në dhjetor 2018, ku kishin folur Floresha Dado, Bashkim Kuçuku, Nysret Krasniqi, Dhurata Shehri, Kastriot Gjika dhe Mark Marku.

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS DHE AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E MALIT TË ZI NËN SHKRUAJNË MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Malit të Zi, më 7 maj 2019, në mjediset e Akademisë në Prishtinë nënshkruan Marrëveshjen dhe Protokollin për Bashkëpunim. Këto dy dokumente janë nënshkruar nga udhëheqësit e të dy institucioneve të larta shkencore, kryetari i ASHAK-ut akademik Nexhat

Daci dhe kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi akademik Dragan K. Vukçević. Me nënshkrimin e këtyre dokumenteve synohet rritja e bashkëpunimit dhe e bashkëveprimit në të gjitha fushat shkencore të interesit të përbashkët si dhe përcaktimi i fushave fundamentale të kërkimeve akademike për të cilat palët janë të interesuara të bashkëpunojnë në të ardhmen.



Udhëheqësit e të dy institucioneve janë zotuar të punojnë për zbatimin e pikave të kësaj Marrëveshje dhe të Protokollit për Bashkëpunim, të cilat janë dokumentet e para të këtij lloji të nënshkruara nga përfaqësuesit e këtyre dy akademive.

ASHAK-U MERR PJESË NË PANAIRIN E LIBRIT "SHKUPI 2019"

Nga data 7 deri 14 maj 2019 u organizua në Shkup Panairi i 31-të i librit "Shkupi 2019"

Në këtë panair morën pjesë rreth 70 shtëpi botuese, institucione shkencore dhe arsimore nga Maqedonia e Veriut, Kosova, Shqipëria, Serbia, si dhe ambasadat e disa vendeve të

akredituara në Maqedoninë e Veriut. ASHAK-u mori pjesë me rreth 150 botime.

ANËTARE KORRESPONDENTE MYZAFERE LIMANI MERR PJESË NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË ALLEA-S

Më 8-10 maj, anëtare korrespondente Myzafer Limani ka marrë pjesë në aktivitetet e Asamblesë së Përgjithshme të ALLEA-s në Bern të Zvicrës në:

- Konferencën e punës për delegatët nga të gjitha akademitë evropiane, anëtare të ALLEA-s, solemnitetin e kremtimit të 25-vjetorit të ALLEA-s dhe solemnitetin e ndarjes së çmimit vjetor Madame de Staël (8 maj);
- Simpoziumin shkencor ALLEA 2019: Shkenca dhe shoqëria në ditën e sotme në Evropë (9 maj);
- Vizita njëditore shkencore në institucionet shkencore dhe kulturore të Bazelit (10 maj).

ANËTARËT E KOMISIONIT PËR EDUKIMIN DHE MJETET E INFORMIMIT PUBLIK TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË VIZITË NË ASHAK

Më 14 maj 2019 anëtarët e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit të Shqipërisë vizituan ASHAK-un të udhëhequr nga znj. Fatjona Dhimitri, kryetare e

Komisionit. Delegacioni u shoqërua nga z. Ismail Kurteshi, kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi në Kuvendin e Kosovës dhe u prit nga Kryesia e ASHAK-ut e udhëhequr nga akademik Nexhat Daci, kryetar i ASHAK-ut.



Kryetari Daci informoi mysafirët për punën shkencore, funksionimin dhe aktivitetet e ASHAK-ut. Në një atmosferë të përzemërt vëllazërore u shkëmbyen informata rreth aktivitetit, punës shkencore si dhe funksionimit të ASHAK-ut dhe takimi shërbeu si një mundësi e mirë për të marrë dhe shkëmbyer përvojat pozitive. Të dy palët shprehën gatishmërinë të vazhdojnë bashkëpunimin vëllazëror dhe institucional edhe në të ardhmen.

ANËTARI KORRESPONDENT I ASHAK-UT FETAH PODVORICA QËNDRON NË AKADEMINË E SHKENCave DHE TË ARTEVE TË MALIT TË ZI

Prej datës 16 deri më 18 maj 2019, anëtari korrespondent i ASHAK-ut Fetah Podvorica mori pjesë në konferencën me titull “Approaching 20?? year” të organizuar në Podgoricë

nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Malit të Zi në bashkëpunim me Akademinë Botërore të Shkencave dhe Arteve (WAAS) dhe Akademinë Evropiane të Shkencave dhe Arteve (EASA).

Në kuadër të konferencës prof. Podvorica paraqiti punimin me titull “Advanced Oxidation Processes for the degradation of Persistent Organic Pollutants”. Punimi i prof. Podvoricës do të publikohet në botimin e përmbledhjeve të punimeve që do të nxirret ndërkohë nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Malit të Zi.

ANËTAR KORRESPONDENT FETAH PODVORICA MERR PJESË NË KONFERENCËN E PESTË TË ORGANIZUAR NGA “LEOPOLDINA” NË LONDËR MË 28-30 MAJ 2019

ASHAK-u ka marrë pjesë nga viti 2014 në konferencat shkencore për Ballkanin Perëndimor të organizuara nga Akademia Gjermane e Shkencave Leopoldina.

Me nismën e kancelares gjermane znj. Angela Merkel është mbajtur në Berlin, më 28 gusht 2014, Samiti i parë i procesit të Ballkanit Perëndimor në nivel të shefave të shteteve dhe të Qeverive të këtyre vendeve. Synim kryesor i këtij tubimi ishte përkrahja e integritetit të rajonit në BE, si dhe rritja e bashkëpunimit rajonal sidomos në aspektin e edukimit, të shkencës dhe inovacion. Më pastaj qeveria gjermane e ka ngarkuar Akademinë e Shkencave

Gjermane Leopoldina që të udhëheqë dialogun në kuadër të shkencës, edukimit dhe shoqërisë, të përfshirë në procesin e Ballkanit Perëndimor. Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe të këtij projekti, Leopoldina ka ftuar bartësit kryesorë kombëtarë dhe shtetërorë të edukimit dhe të shkencës së këtyre vendeve në një platformë të re, që quhet “Konferenca e përbashkët shkencore e procesit të Berlinit”.

Konferenca e parë e këtij formati është mbajtur prej 15-17 korrik 2015 në Halle dhe Berlin. Në këtë konferencë kanë marrë pjesë nga Kosova akademik Nexhat Daci nga ASHAK dhe prof. Fetah Podvorica, prorektor për shkencë i Universitetit të Prishtinës. Në kuadër të konferencës delegacioni i Kosovës ka qenë aktiv në debatet e organizuara, duke bërë prezantimin e problemeve kryesore të vendit në sektorin e arsimit të lartë dhe të shkencës, si dhe në hartimin e konkluzioneve të konferencës. Pikat kryesore të kësaj konference, që janë prezantuar në dy deklaratat e publikuara edhe në gjuhën shqipe, kanë qenë: i) Rritja e fondeve për arsimin e lartë dhe për shkencë deri në 3% në nivel të BPV; ii) Krijimi i sistemeve që përmbajnë standarde të unifikuara të vlerësimit të cilësisë; iii) Krijimi i sistemeve të qëndrueshme të hulumtimit shkencor; iv) Zvogëlimi i “ikjes së trurit” dhe krijimi i rrethanave të favorshme për “kthimin e trurit”; v) Krijimi i një këshilli ose fondacioni për t’iu ndihmuar shkencëtarëve shumë të talentuar të vendeve të Ballkanit Perëndimor etj.

Këto konkluzione janë prezantuar nga ana e “Leopoldinës” para pjesëmarrësve të Samitit të dytë të procesit të Ballkanit Perëndimor të mbajtur më 27 gusht 2015 në Vjenë.

Konferenca e dytë e organizuar prej Leopoldinës është mbajtur prej 22 deri më 25 maj 2016 në Vjenë. Në të kanë marrë pjesë akademik Nexhat Daci si përfaqësues i ASHAK-ut dhe rektori i UP-së prof. Marjan Demaj. Mes tjerash në këtë konferencë është diskutuar për mënyrat më efikase të vlerësimit të cilësisë në sektorin e shkencës dhe të arsimit të lartë, pastaj për krijimin e sistemeve autonome financiare për financim të aktiviteteve shkencore dhe për mënyrën e përfshirjes së shkencëtarëve nga diaspora në ngritjen e nivelit të hulumtimeve shkencore në këto vende. Konkluzione e kësaj konference janë paraqitur nga “Leopoldina” në samitin e tretë të vendeve të Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Paris me 4 korrik 2016.

. Konferenca e tretë e organizuar nga Leopoldina është mbajtur prej 14 deri më 16 qershor 2017 në Paris. Në të kanë marrë pjesë akademik Nexhat Daci, si përfaqësues i ASHAK-ut, rektori i UP-së prof. Marjan Demaj dhe prof. Fetah Podvorica në cilësinë e shkencëtarit të shquar të UP-së. Pjesa më e madhe në këtë konferencë i është kushtuar themelimit të fondit për shkencë për ndihmë të shkencëtarëve të rinj të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Delegacioni nga Kosova ka kundërshtuar fuqishëm emrin e fondit

“Nikola Tesla” të propozuar nga një grup punues, që kishte përgatitur materialin për konferencën në takimin e mbajtur në Beograd. Falë këmbënguljes së delegacionit të Kosovës dhe të përfaqësuesve të Akademisë së Shqipërisë dhe Akademisë Austriake të Shkencave, si dhe të përfaqësuesve të Universiteti të Tetovës dhe të Podgoricës është arritur që emri i fondit të jetë “Fondi për shkencë për Ballkanin Perëndimor”, ndërsa në kuadër të tij pastaj të krijohen fonde të veçanta të shkencave të natyrës, shkencave teknike, shoqërore etj. U propozua që selia e Fondit të jetë në Trieshtë të Italisë. Konkluzionet e konferencës së tretë janë paraqitur nga “Leopoldina” në Samitin e katërt të vendeve të Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Trieshtë të Italisë me 12 korrik 2017.

Konferenca e katërt e organizuar nga “Leopoldina” është mbajtur prej 30 maj deri më 1 qershor 2018 në Romë. Në të kanë marr pjesë akademik Nexhat Daci, kryetar i ASHAK-ut, rektori i UP-së prof. Marjan Demaj, prof. Fetah Podvorica dhe prof. Besnik Krasniqi nga Fakulteti Ekonomik, në cilësinë e shkencëtarëve të shquar të UP-së. Në këtë konferencë është diskutuar për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të rajonit të bazuar në dije, edukim, kërkim shkencor dhe inovacion. Po ashtu është diskutuar për konvergjencën dhe kohezionin në rajon, i cili përfshin shumë aspekte si atë shoqëror, institucional, shkencor etj. Është kërkuar që të krijohen këshillat nacionale për Procesin e Berlinit në

shkencë dhe edukim në vendet e Ballkanit Perëndimor. Konkluzionet e konferencës së katërt janë paraqitur nga “Leopoldina” në Samitin e pestë të vendeve të Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Londër me 10 korrik 2018.

Konferenca e pestë e organizuar nga “Leopoldina” është mbajtur prej 28-30 maj 2019 në Londër. Në të kanë marrë pjesë përfaqësues i ASHAK-ut prof. Fetah Podvorica dhe rektori i UP-së prof. Marjan Demaj. Në konferencë, ndër të tjera, është potencuar roli që mund të luajnë akademitë e shkencave të rajonit në vendosjen e kontakteve me shkencëtarët e këtyre vendeve, të cilët punojnë jashtë vendit. Si model në këtë aspekt është potencuar Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Sllovenisë. Konferenca e gjashtë do të mbahet në mesin e vitit të ardhshëm në Poznan të Polonisë.

ASHAK-U MERR PJESË NË PANAIRIN E LIBRIT "PRISHTINA 2019"

Nga data 5-9 qershor ASHAK-u ka marrë pjesë në panairin tradicional të librit në Prishtinë, "Prishtina 2019." Edhe kësaj here ASHAK-u ka pasur prezantim të suksesshëm. Interesimi i vizitorëve ka qene i kënaqshëm.

PËRURIMI I BOTIMEVE TË ASHAK-UT NË INSTITUTIN PËR KOHËN E RE DHE HULUMTIM TË HISTORISË BASHKËKOHORE TË AKADEMISË AUSTRIAKE TË SHKENCAVE NË VJENË

Më 12 qershor 2019 në Institutin për Kohën e re dhe Hulumtimin e Historisë

Bashkëkohore (Institut für Neuzeit und Zeitgeschichtsforschung
Forschungsbereich Balkanforschung)
të Akademisë Austriake të Shkencave,
në Sektorin e hulumtimeve për
Ballkanin, u përruan tri botime të
Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë
të ASHAK-ut: Wilfried Fiedler,
Gramatikë e krahasuar e gjuhëve të
Ballkanit I. Krahasim morfologjik-
tipologjik i shqipes me gjuhët e tjera të
Ballkanit/ Vergleichende Grammatik
der Balkansprachen.

Morphosyntaktisch-typologischer
Vergleich des Albanischen mit den
anderen Balkansprachen, Prishtinë
2018; Studimet albanistike në vendet
ku flitet gjermanisht /Albanistische
Forschungen in den deutschsprachigen
Ländern, Aktet e Konferencës
ndërkombëtare shkencore të mbajtur
në Prishtinë me organizim të ASHAK-ut
dhe ASHSH-së, Prishtinë 2018, dhe
Norbert Jokl, Gjurmime linguistike-
historike-kulturore në fushën e shqipes
/Linguistisch-kulturhistorische
Untersuchungen aus dem Bereich des
Albanischen (1923), gjermanisht e
shqip me përkthim të Skender Gashit,
Prishtinë 2018. Promovimin e drejtoi O.
Schmitt, ndërsa për botimet folën R.
Ismajli, W. Fiedler, H. Eichner dhe E.
Basha. Në fund u zhvillua një diskutim i
gjerë.

KONCERT SOLEMN VEPRASH MUZIKORE E POETIKE TË AUTORËVE MBARËKOMBËTARË E TË HUAJ

Për nder të 20-vjetorit të çlirimit të
Kosovës, më 14 qershor 2019

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e
Kosovës organizoi koncert solemn
veprash muzikore e poetike të
autorëve mbarëkombëtarë e të huaj.



Intepretuan: Çun Lajçi, Armando Likaj,
Blerim Grubi, Ariana Grubi, Shpend
Ballata, Lirika Pula - Kasapolli, Sihana
Badivuku, Zana Badivuku - Basha dhe
Melos Buza.

PËRURONEN ANTOLOGJITË POETË AKADEMIKË DHE POETË TREGIMTARË AKADEMIKË

Organizuar nga Akademia Maqedone,
më 20 gusht 2019 është bërë përrurimi i
antologjive Poetë akademikë, anëtarë
të Akademisë së Shkencave dhe të
Arteve të Maqedonisë, botuar në shqip
nga ASHAK dhe Poetë tregimtarë
akademikë, anëtarë të Akademisë së
Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,
botuar në maqedonisht nga ASHAM.

Në përrurim nga ASHAK-u morën pjesë
akademikët: Ali Aliu, Mehmet Kraja dhe
Eqrem Basha.

AKADEMIK JUSUF BAJRAKTARI QËNDRON NË TIRANË

Më 8-9 shtator 2019, me ftesë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akademik Jusuf Bajraktari ka marrë pjesë në mbledhjen e Komitetit organizativ "Shqiptarët dhe koalicioni antifashist në Luftën e Dytë Botërore" kushtuar 75-vjetorit të LANÇ-së.

ANËTARE KORRESPONDENTE GJYLJETA MUSHKOLAJ MERR PJESË NË SIMPOZIUMIN E PËRBASHKËT TË ORGANIZUAR NGA AKADEMIA FRANCEZE E SHKENCave DHE AKADEMIA GJERMANE E SHKENCave

Më 10-11 shtator anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj mori pjesë në Simpoziumin e përbashkët të organizuar nga Akademia Franceze e Shkencave dhe Akademia Gjermane e Shkencave Leopoldina me temë: Shkenca dhe të drejtat e njeriut të Komiteteve të Akademive Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Simpoziumi i 8-të i të drejtave të njeriut dhe shkencës është bashkorganizuar nga Komisionet për të drejtat e njeriut të Akademisë Franceze të Shkencave dhe të Akademisë Gjermane të Shkencave Leopoldina me temë: "Të drejtat e njeriut dhe edukimi shkencor" më 10 dhe 11 shtator 2019 në Institut de France.

Kjo ngjarje ishte pjesë e një serie simpoziumesh të organizuar nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut të Akademisë Kombëtare të Shkencave të Leopoldinës. Simpoziumi i 8-të me radhë ishte përqendruar në të drejtën

në arsim, bazuar në Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara të vitit 1948. Qëllim i simpoziumit ishte që të vë në epiqendër të vëmendjes së akademive të shkencave rëndësinë e arsimit për të drejtat e njeriut, për të edukuar një audiencë të gjerë, përfshirë studentët dhe nxënësit e shkollave të mesme, për të luftuar kundër diskriminimit të të gjitha natyrave. Koordinatorë shkencorë të simpoziumit ishin profesorët Jean Iliopoulos dhe Édouard Brézin, bashkëkryetarët e Komitetit për Mbrojtjen e të Drejtave të Shkencëtarëve të Akademisë së Shkencave të Francës (CODHOS) dhe profesor Hans-Peter Zenner, kryetar i Komitetit për të Drejtat e Njeriut të Akademisë Kombëtare të Shkencave të Gjermanisë Leopoldina

NDAHET NGA JETA ALBANOLOGU GJERMAN VILFRID FIDLER, ANËTAR I JASHTËM I ASHAK-UT

Ka ndërruar jetë në moshën 86-vjeçare Vilfrid Fidler (Wilfried Fiedler), gjuhëtar i shquar gjerman, njëri nga albanologët më të rëndësishëm të kohës sonë.



I lindur në Oberfrohnna, Kemnic (Gjermani) në vitin 1933, prof. Fidler do të njihet herët me shqipen dhe me kulturën shqiptare dhe do t'ia

përkushtojë gjithë jetën thesareve të saj. Në vitet 1951-1955 ndoqi studimet për sllavistikë dhe për filologji të tjera të Europës Lindore dhe Juglindore në Universitetin e Humboldt në Berlin. Pas vitit 1955 ishte bashkëpunëtor shkencor në Akademinë e Shkencave në Berlin. Bashkë me Erih Stokmanin mori pjesë në ekspeditën në Shqipëri. Nga viti 1959 ishte mësimdhënës për gjuhën, letërsinë dhe folklorin shqiptar në Berlin. Më 1959 qëndroi për qëllime hulumtimi në Shqipëri. Më 1961 doktoroi në fushën e ballkanologjisë në Universitetin e Humboldt. Ishte bashkëpunëtor shkencor në Komisionin e gjuhësisë (1963-1967) dhe në Institutin për Gjuhët dhe Kulturën Romane në Akademinë e Shkencave të Gjermanisë në Berlin (1967-1968). Bashkë me Oda Buholcin (Buchholz) drejtoi grupin hulumtues për ballkanistikë në kuadër të Institutit Qendror të Gjuhësisë të Akademisë së Shkencave në Republikën Demokratike të Gjermanisë në Berlin (1968-1988). Më 1988 mbrojti tezën e habilitacionit në fushën e albanologjisë në Universitetin e Humboldt. Prej vitit 1989 dhe deri më 1998 ishte profesor i albanologjisë në Universitetin "Ludwig-Maximilian" në Munihi. Më 1991 u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK).

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, duke konsideruar humbjen e tij të pazëvendësueshme, u shpreh ngushëllimet më të sinqerta anëtarëve të familjes Fiedler, miqve dhe

dashamirëve të tij të shumtë në të gjitha trojet shqiptare.

Mbledhja komemorative u mbajt në mjediset e ASHAK-ut më 16 shtator 2019. Mbledhjen e hapi akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar i ASHAK-ut, ndërsa për jetën dhe veprën e profesor Fidlerit foli akademik Rexhep Ismajli.

PËRURORHET LEKSIKONI I VENDBANIMEVE, VËLLIMI II, VENDBANIMET RURALE A-LL



Më 24 shtator 2019 në mjediset e Akademisë u bë përurimi i Leksikonit të vendbanimeve, vëllimi II, vendbanimet rurale A-LL, në 736 faqe, i ilustruar me foto për objekte të ndryshme gjeohapësinore, të trashëgimisë natyrore e kulturore dhe elemente fizionomike e funksionale. Për botimin folën Sekretarja e Seksionit të Shkencave Shoqërore, profesoresha Justina Shiroka - Pula, kryeredaktori akademik Hivzi Islami dhe recensenti akademik Anton K. Berishaj.

Në përurim morën pjesë anëtarë të Akademisë, ekspertë nga gjeoshkencat dhe shumë të interesuar të tjerë. Në hartimin e këtij botimi u angazhuan

dhjetra ekspertë të shkencave gjeohapësinore, sociologë, urbanistë, planerë, ekonomistë, demografë, historianë, etnologë etj. Botimi përmban të dhëna, fakte dhe informata relevante nga terreni për dimensionin fizik-hapësinor, demografik, funksional, historik, kulturor, ekonomik, gjeopolitik, pastaj të dhënat për dhunën, krimet dhe dëmet materiale që i shkaktoi regjimi fashistoid e gjenocidal i Serbisë etj.

Botimi pa dyshim do të përmbushë një nevojë të kahershme për gjeoshkencat, shkencat sociale dhe opinionin e gjerë lexues dhe do të jetë një trashëgimi e madhe për shkencën dhe kulturën tonë.

Botimi do të shpërndahet në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, në librari dhe biblioteka dhe mund të blihet edhe në librarinë e Akademisë.

ANËTAR KORRESPONDENT FETAH PODVORICA QËNDRON NË FRANCË

Me ftesë të Universitetit të Saclay-it, anëtar i korrespondent Fetah Podvorica më 25-29 shtator mori pjesë në konferencën “Greffage de molecules organiques”, në Qendrën e Energjisë Atomike në Saclay të Francës. Në cilësinë e anëtarit të ASHAK profesor Podvorica mbajti ligjëratën me titull “La greffage des molécules organiques par le détournement de la réactivité des radicaux aryles”.

ZGJIDHET KRYETARI I ASHAK-UT

Në bazë të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (Ligji nr. 05/L-038), neni 15, Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, neni 29, paragrafi 11 dhe neni 31, paragrafi 5, nënparagrafi 5.3, si dhe në bazë të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, neni 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 dhe neni 12, Kuvendi i Akademisë në mbledhjen e datës 3 tetor 2019 mbajti seancën zgjedhore për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë.



Kuvendi zgjodhi akademik Mehmet Krajën kryetar të Akademisë.

ASHAK-U I DËRGON LETËR AKADEMISË SUEDEZE NË STOKHOLM

Në dijeni: Jurisë për ndarjen e Çmimit Nobel për Letërsi

Më 10 tetor ASHAK-u reagon për ndarjen Çmimit Nobel për Letërsi kësisoj:

“Të nderuar titullarë dhe anëtarë të Akademisë,

Me indinjatë të thellë morëm lajmin e shëmtuar se laureat i Çmimit Nobel për Letërsi për vitin 2019 është shkrimtari Peter Handke, një eksponent i shquar i ideve fashiste të nënshtrimit dhe robërimit të popujve dhe mbështetës i pasionuar i Milosheviqit dhe i luftërave të tij gjenocidale në Ballkan, përfshirë edhe Kosovën. Si Akademi e një shteti të sapokrijuar mbi vlerat perëndimore të lirisë së popujve dhe institucion që edhe vetë ka vuajtur segregacionin dhe aparthejdin e një regjimi të urryer dhe luftën e tij shfarosëse nuk kemi besuar se kaq shpejt do të përballemi me humbjen e kujtesës dhe amnistinë morale të atyre që mbështetë me aq pasion një vrasës të popujve, siç bëri laureati i juaj Peter Handke. Mospajtimi i thellë me angazhimet politike dhe deklaratimet publike të Handkes, bashkë me mbështetjen e pakursyer të mbarë botës progresive, përfshirë edhe Suedinë, bëri që sot popull ynë të njohë lirinë dhe jetën e dinjitetshme.

Peter Handke nuk ishte në anën e drejtë të historisë së popujve të Ballkanit dhe as të Kosovës; nuk ishte në anën e ndritshme të ideve, por gjeti strehë në anën e errët të ngjarjeve tragjike të Ballkanit. Si rrallë ndokush tjetër, ai mori pjesë në varrimin e Milosheviqit dhe deklaroi: “Nuk e di të vërtetën. Por unë shoh. Unë ndjej. Unë mbaj mend. Andaj jam këtu sot, pranë Jugosllavisë, pranë Serbisë dhe pranë Slobodan Milosheviqit”. Më herët, në

maj të vitit 1999, ai u deklarua kundër bombardimeve të NATO-s, duke thënë se Aleanca Veriatlantike nuk është duke parandaluar Aushvicin e ri, por është duke e krijuar atë. Ai sulmoi pa dallim të gjithë ata që mbështetën ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, qofshin politikanë apo dijetarë të shquar të mbarë botës. Ende sot trazojnë Ballkanin aq shumë viktime pa varre, të cilat kërkojnë prehje dhe drejtësi.

Ideja se angazhimet dhe bindjet politike duhet ndarë nga vepra e një shkrimtari nuk funksionon në rastin e Peter Handkes. Përkundrazi, idetë e tij agresive u afishuan aq shumë teksta synonin të luhatnin fundamentin e vlerave të civilizimit dhe humanitetit.

Të zhgënjyer thellësisht me ndarjen e sivjetshme të Çmimit Nobel, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës kërkon të anulohet ky vendim i Akademisë Suedeze si akt mirëkuptimi e solidariteti me të gjithë popujt e botës që luftojnë për liri dhe vlera demokratike.

Me respekt,

Mehmet Kraja

Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

ASHAK-U PARAQITET ME BOTIMET E VETA NË PANAIRIN E FRANKFURTIT

Nga data 16 deri 20 tetor është mbajtur Panairi Ndërkombëtar i Librit në Frankfurt, më i madhi i këtij lloji në Evropë. ASHAK-u është paraqitur në këtë panair me 20 botime. Nën përkujdesjen e Shoqatës së Botuesve të Kosovës, botimet e ASHAK-ut janë prezantuar në një stendë të përbashkët me botuesit kryesorë të Kosovës.

MBAHET KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE: “STUDIMET ALBANISTIKE NË ITALI”

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me datë 22 dhe 23 tetor organizoi Konferencën shkencore ndërkombëtare “Studimet albanistike në Itali” në të cilën morën pjesë me kontributet e tyre shkencore rreth 50 referues nga Kosova, Shqipëria, Italia, SHBA-ja, Franca, Polonia, Bullgaria, etj. Këshilli organizues, të cilit i priu akademik Rexhep Ismajli, ftoi emra të njohur të këtyre studimeve dhe hartoi një program të pasur të konferencës, e cila u zhvillua në dy ditë, në gjashtë seanca.



Në vazhdimësi të dy konferencave të rëndësishme shkencore “Studimet albanistike në Amerikë”, që u mbajt në vitin 2015 dhe “Studimet për shqipen në vendet ku flitet gjermanisht”, e realizuar gjatë 2017-tës, të organizuara nga ASHAK, pothuaj me distancë të njëjtë kohore që planifikuar edhe konferenca shkencore për studimet albanistike në Itali me shumë interes jo vetëm për praninë e arbëreshëve, për kulturën, letërsinë dhe studimet albanologjike dhe albanistike, por edhe për rezultatet e shumë studiuesve italianë të gjuhës shqipe në radhë të parë, por edhe të letërsisë, antropologjisë dhe kulturës shqiptare në përgjithësi. Italia është vendi me më së shumti qendra studimi të shqipes, katedra universitare që kanë përgatitur kuadro, pedagogë e studiues dhe që kanë realizuar projekte të rëndësishme studimi. Rezultatet që u arritën në dy konferencat e përmendura më lart, interesimi i madh i atyre që morën pjesë dhe rëndësia e kontributeve që u sollën shtojnë bindjen se edhe ky aktivitet, jo më pak i rëndësishëm se dy të parët, do të sjellë kontribute nga fusha të ndryshme të studimeve albanologjike dhe albanistike dhe do të finalizohet me botimin e materialeve, referateve, kumtesave dhe diskutimeve që do të zhvillohen gjatë dy ditëve të konferencës.

HAPET EKSPOZITA RETROSPEKTIVE E AKADEMIK AGIM ÇAVDARBASHËS



Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, organizuar nga Seksioni i Arteve, me 25 tetor 2019, në orën 19.00, u hap ekspozita retrospektive e skulptorit Agim Çavdarbasha (1944-1999). E kuruar nga Eqrem Basha dhe në bashkëpunim me familjen e artistit të ndjerë, si dhe me Fondacionin “Agim Çavdarbasha”, kjo ekspozitë, që lidhet edhe me 20-vjetorin e vdekjes së artistit, paraqet një diagonale të krijimtarisë së tij, e realizuar në periudha të vështira të ekzistencës sonë dhe në kushte të rënda shëndetësore të autorit, i cili, përkundër sëmundjeve të njëpasnjëshme arriti të krijojë një opus që me të drejtë konsiderohet sot se është në themelet e artit modern figurativ shqiptar, duke sjellë vepra që shënojnë kohën më dinamike të zhvillimit të skulpturës dhe të arteve figurative në përgjithësi të ne. Çavdarbasha, përveç se ishte artist i sprovuar në të gjitha materialet e skulpturës: mermer, dru, allçi e bronz, metal e materiale plastike, ishte dhe pedagog dhe themelues i degës së skulpturës në Akademinë e Arteve

(Fakulteti i Arteve) të Universitetit të Prishtinës. Nën kujdesin e tij janë formuar një mori skulptorësh, artistë figurativë që po afirmohen jo vetëm në hapësirat tona kulturore, por edhe gjithandej në arenën ndërkombëtare.

Për meritat e tij të jashtëzakonshme në krijimtarinë artistike në vitin 1994 u zgjodh anëtar korrespondent, ndërsa në vitin 1996 u zgjodh anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Në vitin 1995 ai kishte shpallur atelienë e tij në fshatin Çagllavicë të Prishtinës “Galeri të hapur”, ndërsa në vitin 2004 kjo galeri pësoi në flakët e ngjarjeve të marsit dhe bashkë me të u dogjën dhjetëra skulptura e vizatime të rëndësishme të opusit të tij.

Ekspozitën e hapi anëtar korrespondent Luan Mullqi, ndërsa për veprimtarinë e autorit foli akademik Eqrem Basha, kurator i ekspozitës, i cili në fjalën e tij tha:

“Këtu e njëzet vjet më parë, më saktë më 20 tetor 1999, ne humbëm mikun tonë, skulptorin, pedagogun, artistin e madh Agim Çavdarbasha, në një betejë të madhe e të pashembullt të tij për të mbijetuar e për të krijuar. Duke iu kthyer sot, me këtë ekspozitë retrospektive, ne që s’kemi pushuar ta kujtojmë e vlerësojmë asnjë ditë e asnjë çast, vazhdojmë ta kujtojmë gjithnjë e më qartë sakrificën sublime, ta përcjellim me aq sa mundemi ndër breza shembullin e një krijuesi të rrallë

që vuri peng çdo gjë që kishte në themelet e atij që sot e quajmë arti tij, duke shkruar pak nga pak kurmin e një Feniksi, që bie e ringrihet nga hiri i vet, për të dëshmuar e për të lënë peng mesazhin universal, vazhden e ndritur të artistit jo si të tjerët, të korifeut për të cilin krahasimet me mite e personazhe mitike na duken aq të afërta.

Agim Çavdarbasha, me shumë arsye meriton të cilësohet - jo si të tjerët, sepse më shumë se çdokush tjetër mbajti mbi shpinë padrejtësinë e kësaj jete, më shumë se çdokush tjetër nuk e përfilli vuajtjen kur merrte në duart e mbështjella me fasha çekiçin, duke drejtuar trupin e dërmuar nga ndërhyrjet e bisturive për të atakuar me daltë një copë mermer a një cung arre, për të rrëmbyer sa më shpejt e sa më shumë nga koha që i kishte mbetur...

Jemi përpjekur saherë të përmbledhim veprën e gjerë të një jete të shkurtër që u shua me 55 vjet të gjejmë mbase diçka pa thënë, të tretemi thellësive të lojës magjike të dritës e hijes, të formave të rrumbullakuara dhe brinjve shtrënguese, të masës së butë, që shpërthen prej tyre, plot vullnet për jetë e për frymëmarrje të lirë, tiparet e kontekstualizuara dhe të karakterizuara të dukagjinaseve dhe dukagjinase në biseda të heshtura, kokë më kokë, rreth një softe skamnore, mbi një bankë, kub a mbi gurin e gdhendur para derës së oborrit... Kemi këmbëngulur të gjejmë misterin e

thellësive të errëta në sytë e shpuar në një varg kokash që shohin nga largësia andej nga zhduket nën dhé arkivoli i njeriut të dashur e të çmuar... tek sferat, kafazet, sytë e ënjtur që ia drejtojnë qiellit dhembjen për pëllumbat e varrë, të lëvarur në prehrin e Nënës, Pietës... masa të gjallëruara, brinjë të vrazhdë kafazesh në trupat e shpendëve të gdhendur me tinguj vajtimi të simfonisë së mermerit të shndërruara në vepra monumentale që shënuan një periudhë më se të rëndësishme të zhvillimit të arteve pamore te ne, në të cilën u ngjizën pastaj rrënjët e një gjenerate të re piktorësh e skulptorësh, grafikësh, konceptualistësh që po pushtojnë sot botën duke dhënë mesazhe universale nga një vend i vogël.

Nga periudha e hershme e perforacioneve e deri te fazat e fundit e rrumbullakeve të shtrënguara në brinjë kafazi, gdhendjeve monumentale të trupit dhe portretit të rrahur nga furtunat e historisë, në dru a në mermer, Agim Çavdarbasha eci hap pas hapi. Krijoi forma plastike, zogj, pëllumba, forma abstrakte, portrete me gjurmë asociative në të cilat kërkoi tiparet e veçanta, harmonizoi qëndrimet në pritje, komunikimet e heshtura, gdhendi mermerin, drurin, formësoi mellën, allçinë, metalin, provoi të gjitha materialet që i bindeshin dhe i jepnin satisfaksionin e veprës që sendërtonte idenë dhe idealin e tij.

Do të kishim dashur, patjetër, të paraqisnim me këtë rast, në një vend, një diagonale më gjithpërfshirëse të veprës së tij, duke u nisur nga miniaturat, prekjet e imëta në mell e terakotë, dëshmi të shkathtësisë mjeshtrëse modeluese e deri te veprat monumentale Pieta, Familja, Përqaqimi, Kosova apo Nëna, Sofra, Zogjtë, Sferat, Kafazet... në të gjitha materialet që i zotëronte me po atë ndjesi e afinitet, por e kemi të pamundur, para së gjithash për shkak të vështirësisë së mobilitetit të veprave të mëdha, sidomos të atyre në gurë e në mermer, por edhe për shkak se vepra e Çavdarbashës kishte fatin e autorit, ajo lindte në furtunat e kohës dhe zhdukej nga flakët e urrejtjeve, siç ishin, midis tjerash, edhe ato të vitit 2004 kur atelieja e tij u përfshi nga zjarri dhe mori me vete dhjetëra skulptura në dru, allçi, bronz, qindra vizatime, duke e shterur pothuaj tërësisht fondin e skicave, studimeve, aty ku skulptorët janë më se të veçantë. Pak kohë pasi trupi i tij i përvuajtur gjeti qetësinë e përgjeshme, patëm përmbyllur një shkrim me pak fjalë që mbeten për t'u thënë në çdo përvjetor të humbjes së tij: "Dhembjet dhe shqetësimet e tij janë me ne, mbi tokë. Janë thesari dhe trashëgimia jonë..."

DELEGACIONI I AKADEMISË SË SHKENCave DHE ARTEVE TË KOSOVËS VIZITON AKADEMINË E SHKENCave TË SHQIPËRISË

Më 7 nëntor 2019, në ambientet e Librit Akademik në Akademinë e

Shkencave u zhvillua takimi për intensifikimin e bashkëpunimit të mëtejshëm shkencor midis Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Ky takim u zhvilluar në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes dy akademive, asaj të Kosovës dhe Shqipërisë për periudhën 2018-2020. Kjo marrëveshje përfshin aktivitetet në fushën kërkimore-shkencore e artistike si dhe veprimtari të ndryshme shkencore, simpoziume, konferenca e të tjera.

Gjatë takimit u fol nga përfaqësuesit e dy akademive për vijimin e mëtejshëm të bashkëpunimeve shkencore mes tyre, për botime të përbashkëta shkencore, për zhvillimin e konferencave të cilat nxjerrin në pah problematikat dhe gjithashtu për sesione dhe projekte të cilat do të bëjnë të mundur një pasqyrim më të denjë të punës së akademikëve mes dy vendeve.

Në një intervistë për Agjencinë Telegrafike Shqiptare, kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës Mehmet Kraja tha se "Ky takim u zhvillua për të konkretizuar një fazë të re bashkëpunimi mes dy akademive. Të dyja akademitë kanë një përvojë bashkëpunimi, mes tyre megjithatë kishte dhe faza të ngecjes së këtij bashkëpunimi. Tani ka ardhur një fazë pas reformave, riorganizimit të Akademisë së Shqipërisë dhe të

problemeve tona ku duhet të intensifikohet bashkëpunimi në gjitha fushat. Bashkëpunimi ynë konsiston në shkencat albanologjike, shkencat shoqërore dhe seksionin e arteve që Akademia e Shqipërisë nuk e ka, por dhe këtu gjetëm dhe kërkuam forma bashkëpunimi”.

Gjithashtu për ATSH-në kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Skënder Gjinushi tha se “Kjo është një vizitë e rëndësishme vllazërore dhe patjetër e nevojshme pasi akademia jonë ka qenë në reformim dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka një kryetar të ri tashmë dhe duhet të vendoseshin këto kontakte të reja në nivel kryesish për të vijuar këtë bashkëpunim”.

Gjinushi ndër të tjera u shpreh: “Tani vlerësoj që janë të tëra kapacitetet dhe në riorganizimin e akademisë sonë dhe të Kosovës që të vijojmë të punojmë në të gjitha fushat së bashku. Në fushat e albanologjisë, edhe për ekonominë dhe për problemet e arsimit, edhe për botime dhe veprash madhore si historia e shqiptarëve, enciklopedia, pra probleme të gjuhës shqipe. Të gjitha, pra, këto probleme dy akademitë do i përballojnë së bashku duke rakorduar potencialet madje dhe në fushat e shkencave të natyrës dhe teknike, ku absolutisht ne duhet të jemi plotësues me njëri-tjetrin dhe gjithashtu të kemi dhe projekte të përbashkëta që kanë të bëjnë me zhvillimin e shkencave natyrore dhe teknike”.

Në takim morën pjesë përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, ndër të cilët kryetari i Akademisë së Shkencave të Kosovës Mehmet Kraja, zëvendëskryetari i Akademisë së Kosovës Jusuf Bajraktari dhe sekretarja shkencore e Akademisë së Kosovës Myzaferre Limani. Nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë merrnin pjesë kryetari i akademisë Skënder Gjinushi, zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave Vasil Tole dhe akademikët Floresha Dado dhe Shaban Sinani.

Bazuar në këtë marrëveshje të nënshkruar mes dy akademive shkencore, të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, brenda dy viteve do të realizohen veprimtari rreth çështjes së standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë, botimi i hartës arkeologjike, fjalorë, konferenca të ndryshme shkencore, sesione, projekte, promovime, shkëmbime të botimeve e të tjera.

AKADEMIA E SUEDISË I PËRGJIGJET KRYETARIT TË AKADEMISË AKADEMIK MEHMET KRAJËS

“I nderuar Z. Kraja,

Ju faleminderit për shqetësimin tuaj të singertë. Komiteti i Nobelit i ka vlerësuar qëllimet që qëndrojnë pas veprës letrare të zotëri Handkes në mënyrë tjetër nga ju dhe Komiteti ka arritur në përfundimin se vendimi për dhënien e çmimit për të është në pajtim të plotë me qëllimin e shprehur

në testamentin e Alfred Nobelit. Është e qartë se Handke kuptohet në mënyra të ndryshme. Çmimi Nobel ndahet për arritje. Kur një Handke shpërblehet me çmim, synimi është të vlerësohet vepra e tij e jashtëzakonshme letrare e jo personi. Çmimi Nobel për fizikë ose kimi ndahet për zbulim, pavarësisht nga personi; çmimi në letërsi ndahet për zbulimin dhe zhvillimin e një mënyre të re të shkruarit, pavarësisht nga personi. Vetëm vlerësimi estetik dhe asgjë tjetër përpos këtij vlerësimi është mesazhi që nënkupton ndarjen e këtij çmimi.

Komiteti beson se në një shoqëri të hapur duhet të ketë vend për mendime të ndryshme për autorët dhe se duhet të ketë vend për interpretime të ndryshme dhe të arsyeshme të veprave të tyre letrare. Ne duhet të përpiqemi të respektojmë secilin, pavarësisht nga pikëpamjet krejtësisht të ndryshme për çështje të rëndësishme. Në kuptim të kësaj që u tha gjithashtu besojmë se është e rëndësishë më të lartë në funksion të demokracisë dhe një dialogu të arsyeshëm që ne kemi vendosur të mbështetemi në gjetjet e ligjshme të gjykatave të tilla si Tribunal i Hagës. Gjetjet e Tribunalit për ne janë pjesë thelbësore e të kuptuarit të historisë tragjike të Evropës nga e cila të gjithë shpresojmë se mund të mësojmë.

Ju sigurojmë për respektin dhe konsideratat tona më të larta.

Anders Olsson,
Kryesues i Komitetit të Nobelit”.

PËRURIMI I BOTIMIT "ISHIN KOHË TË VËSHTIRA PËR SKËNDERBEUN, POR AI KISHTE NJË ALEAT, HUNIADIN HUNGAREZ"

Më 25 nëntor në mjediset e ASHAK-ut u përurua botimi "Ishin kohë të vështira për Skënderbeun, por ai kishte një aleat, Huniadin hungarez", i Ministrisë së Jashtme të Hungarisë, hartuar nga një grup autorësh eminentë hungarezë, i cili i dedikohet lidhjeve miqësore gjatë historisë ndërmjet shqiptarëve e hungarezëve.



Fjalën e hapjes e mbajti nënkryetari i Akademisë akademik Jusuf Bajraktari, i cili ndër të tjera theksoi:

“Kam nderin e veçantë që në emër të Akademisë ta deklaroj të hapur promovimin e librit të Akademisë së Shkencave dhe të Ministrisë së Jashtme të Hungarisë të hartuar nga një grup autorësh eminentë hungarezë, i cili i dedikohet lidhjeve miqësore gjatë historisë ndërmjet shqiptarëve e hungarezëve.

Ky botim, siç do të paraqitet më detajisht nga prezantuesit, ngërthen në vete trajtesa të vlefshme të ngjarjeve

dhe të aspekteve që përbëjnë lidhjet e epokave dhe të figurave të shquara nga e kaluara e të dy popujve tanë.

Në këtë vepër prej 340 faqesh, me argumente jepen tablo të veçanta të ndihmës së studiuesve hungarezë, siç është ballkanologu i shquar Lajos Thalloszy për rëndësinë e studimeve albanologjike nga këndvështrimi gjuhësor e historik, në botimin dyvëllimor "Hulumtime ilire-shqiptare"; në spikatjen e rolit të misionarëve të ndryshëm kulturorë dhe fetarë; në studimin e dy figurave dominante të mesjetës në Evropë: Skënderbeut shqiptar dhe të hungarezit Gjon Huniadi, si dy personalitetet më të shquara në luftën kundër osmanëve në shekullin XV.

Një tjetër trajtesë e argumentuar shkencërisht i është kushtuar edhe periudhës më të re të historisë së Kosovës, me autorësi të ambasadorit hungarez në Prishtinë László Márkus. Ai në mënyrë analitike e trajton "Qëndrimin e Hungarisë për pavarësinë e Kosovës" si një domosdoshmëri faktike e pajtimit parimor ndërmjet pozitës dhe opozitës në Hungari më 19 mars 2008.

Këto që u thanë më sipër, si dhe vlerësimet e pesëmbëdhjetë autorëve të nderuar hungarezë në punimet e këtij botimi, janë një vlerë e shtuar për thellimin e njohurive dhe dijeve për historinë për kulturën dhe për begatimin e mëtejme të

marrëdhënieve ndërmjet dy popujve miq - hungarezëve dhe shqiptarëve.

Me këtë rast dua të falënderoj posaçërisht redaktorin e botimit akademik Krisztián Csaplár - Degovics për kontributin e madh me rastin e përgatitjes së suksesshme të këtij edicioni, si dhe ambasadorin Márkus për angazhimet e tij të sinqerta në prezantimin e këtij botimi para opinionit kosovar".

ASHAK-U MERR PJESË NË PANAIRIN E LIBRIT "TIRANA 2019"

Nga data 13 deri në 17 nëntor në Tiranë është mbajtur Panairi i 21-të Ndërkombëtar i Librit "Tirana 2019." ASHAK-u është paraqitur me botimet e veta në mesin e rreth 90 shtëpive botuese, institucioneve shkencore dhe arsimore nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, përfshirë qendrat kulturore të disa nga ambasadat e vendeve të akredituara në Tiranë. ASHAK-u ka pasur prezantim të suksesshëm.

ANËTAR KORRESPONDENT MUHAMEDIN KULLASHI MERR PJESË NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË UNIONIT AKADEMIK NDËRKOMBËTAR (UAI) NË PARIS

I deleguar nga ASHAK-u, anëtari korrespondent Muhamedin Kullashi, më 22 -30 nëntor mori pjesë në konferencat e Unionit Akademik Ndërkombëtar (UAI) dhe në Asamblenë e përgjithshme të

organizuara për nder të shënimit të 100-vjetorit të kësaj organizate.

KRYETARI KRAJA I REAGON AKADEMISË SË SUEDISË / KOMITETIT TË NOBELIT ZOTIT ANDERS OLSSON

Pas përgjigjes nga Akademia Suedeze, kryetari Kraja i shkruan edhe një letër Akademisë Suedeze me këtë përmbajtje:

“I nderuar zotëri,

Me kureshtje e lexova letrën tuaj dhe, ju them të drejtën, mbeta thellësisht i zhgënjyer, jo aq për faktin se ju nuk shfaqni shenja zmbarsje për të kurorëzuar laureat të Çmimit Nobel një mbështetës të gjenocidit, por më shumë për mënyrën si i keqpërdorni parimet për të arsyetuar një dështim të pashembullt.

Duke qenë pjesëtar i një populli që ka vuajtur shumë gjatë historisë, në asnjë rrethanë nuk mund ta pranoj si të mirëqenë idenë e shoqërisë së hapur dhe të mendimit ndryshe, si arsyetim për mbështetjen e pakursyer që i keni dhënë zhbërjes së vlerave humane, përfshirë robërimin e popujve dhe gjenocidin.

Me këtë rast, me rastin e Handkes, unë nuk mund të mos shpreh shqetësimin tim të thellë dhe tronditjen deri në mpirje për tendencën në rritje të Europës, që në Ballkan sërish dhe sërish të relativizojë dhe t'i bëjë të luhatshme vlerat në të cilat ajo tashmë

na ka mësuar të besojmë. Prandaj nuk mund ta besoj se ju, në mbështetje të laureatit tuaj, i relativizoni aq shumë vlerat humane dhe civilizuese, duke u përpjekur të vendosni shenjë e barazimit midis të drejtës për mendim ndryshe dhe mbështetjes së pashembullt të gjenocidit.

Zoti Olsson,

Ju bëni një gabim të tmerrshëm kur përmendni Tribunalin e Hagës në një kontekst të përmbysur: nuk u themeluan tribunalet e këtillë vetëm për të kuptuar historinë tragjike të Europës, siç shpreheni ju, por për t'i parandaluar këto zhvillime tragjike, në mënyrë që ato kurrë më të mos bëhen pjesë e historisë, gjithnjë me idenë se kriminelit dhe mbështetësit e tij, në njërin anë, dhe viktimat në anën tjetër nuk mund të marrin status të barabartë as në histori dhe as në hierarkinë e vlerave civilizuese. Fundja, ju e dini mirë se laureati juaj nuk iu bind verdiktit në tentativë të Tribunalit, në të cilin Millosheviqi nuk u dënua për shkaqe “natyrore”, por u dënua bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, duke u shprehur në varrimin e kriminelit me këto fjalë: ‘Unë nuk e di, por unë kam parë, prandaj unë jam këtu, pranë Serbisë, pranë Jugosllavisë, pranë Milosheviqit...’ Dhe ju e dini fare mirë se çfarë kishte parë dhe çfarë nuk kishte dashur të shihte Handke në Bosnjë dhe në Kosovë. Më anë tjetër, ju besoj se e keni të qartë se Procesi i Nurembergut nuk mund të amnistojë neonazizmin e sotshëm, ashtu sikundër

që verdiktet e shqiptuara ose të pashqiptuara të Tribunalit nuk mund të amnistojnë ringjalljen e sotshme të ideve të Millosheviqit në Ballkan dhe përreth tij, frymëzuesi më i laureuar i të cilave vazhdon të jetë Peter Handke dhe dishepujt e tij. Ish-Jugosllavia për Handken ishte “nostalgji utopike”, kurse për ne që e jetuam kohën e saj ishte burg i popujve dhe Handke shfaqet tepër pretendues kur pandeh se mund ta ruante atë fantazmë të historisë, të cilën nuk e deshën as vetë popujt që e themeluan dhe e përbënin atë.

Duke mos qenë afër zhvillimeve në Ballkan, ju duket se nuk e keni ndërmend të kuptoni se duke mbrojtur Handken, ashtu siç bëni në letrën tuaj, ju mbroni Millosheviqin dhe, duke mbrojtur Millosheviqin, ju mbroni gjenocidin dhe, duke mbrojtur gjenocidin, ju jeni pozicionuar në anën e errtë të historisë, duke ngritur në pedestalin më të lartë një shkelës të egër të vlerave humane.

Përpjekja juaj asnjëherë e suksesshme për të ndarë personin e Handkes nga vepra e tij letrare edhe kësaj here është dëshpëruese: nëse ai bëri një zbulim në letërsi, siç pretendoni ju, për bindjen tonë ky zbulim konsiston pikërisht në arritjen e tij të pashembullt, që bindjet politike t’i kamuflojë si “letërsi e pastër”. Themi kështu, sepse Handke përdori mbështetjen e gjenocidit si afishe propagandistike për të afirmuar letërsinë e tij, gjithnjë duke manipuluar rëndë me vlerat demokratike dhe me

të drejtën për mendim ndryshe. Njohjet përmes letërsisë, ku bën pjesë edhe kontributi juaj i jashtëzakonshëm, i kanë krijuar Peter Handkes sfondin e nevojshëm propagandistik për idetë e tij gjenocidale.

Gjithnjë duke mbetur në të drejtën tonë për të mos u pajtuar me ju, më lejoni që edhe kësaj radhe të shpreh konsiderata e mia.

Me respekt,

Mehmet Kraja,
Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës”.

AKADEMIK JUSUF BAJRAKTARI QËNDRON NË TIRANË

Më 13-16 nëntor 2019, me ftesë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akademik Jusuf Bajraktari ka marrë pjesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare “Shqiptarët dhe Koalicioni Antifashist në Luftën e Dytë Botërore”, kushtuar 75-vjetorit të LANÇ-së.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI MBAN LIGJËRATË NË ZAGREB

Më 19 nëntor akademik Rexhep Ismajli ka mbajtur ligjëratë në Qarkun Linguistik të Kroacisë në Zagreb. Ai para gjuhëtarëve kroatë ka ligjëruara për origjinën e dialekteve të shqipes. Akademik Ismajli dhe anëtari korrespondent Bardh Rugova gjatë

qëndrimit të tyre në Zagreb kanë mbajtur njëherësh cikël ligjëratah në Universitetin e Zagrebit dhe kanë zhvilluar takime me gjuhëtarët akademikë kroatë, Augustin Kovaçec dhe Ranko Matashoviq.

PËRURROHEN BOTIMET E SEKSIONIT TË GJUHËSISË DHE TË LETËRSISË



Më 3 dhjetor 2019 në mjediset e ASHAK-ut u përuruan dy botime të reja të Seksionit: Identiteti i pa/zbuluar i Kujtim Shalës dhe Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë i Bardh Rugovës. Për librin e K. Shalës foli prof. dr. Nysret Krasniqi nga Fakulteti i Filologjisë i UP-së, ndërsa për atë të Bardh Rugovës foli akademik Rexhep Ismajli. Përrurimin e drejtoi akademik Ali Aliu.

REAGIM I ASHAK-UT PËR REZULTATET E PISA-S

Më 4 dhjetor ASHAK-u reagon publikisht për rezultatet e testit PISA

Shpallja e djeshme e rezultateve të PISA-s (Program for International Student Assessment \ Program i Vlerësimit Ndërkombëtar i Nxënësve)

ishte dëshpërim për të gjithë qytetarët e Kosovës, me përjashtim të atyre që do të duhej të mbanin përgjegjësinë objektive për këtë gjendje. Arsimi është njëri nga dështimet tona të mëdha, por moskokëçarja dhe reagimi i vakët institucional në këtë rast e bën situatën edhe më dëshpëruese, duke i dhënë asaj përmasat e një krize shoqërore, përfshirë edhe krizën morale. Kriza në arsim është kriza më e madhe e shoqërisë kosovare që në fillimet e perspektivës së saj, sikundër që është zhgënjim dhe braktisje e pashembullt e idealizmit tonë historik, i mbështetur mbi idetë e iluminizmit dhe emancipimit.

Nxënia e dijeve nuk është dështimi i vetëm në arsim, ai është vetëm një segment i dukshëm dhe i afishuar në një mënyrë të tillë që na bën të turpërohem dhe të skuqemi të gjithë. Mungesat dhe dështimet tona janë shumë më të mëdha dhe kjo situatë na bën me dije se Kosova është e përfshirë prej shumë vitesh në një krizë të mësimit dhe të dijes, e cila si shtet dhe si komb na lë pa të ardhme. Testi i PISA-s nuk është dhe nuk mund të merret si komponent artificial i arsimit, siç pretendojnë institucionet tona. Ai është një indikator që tregon një gjendje dhe nuk është asnjëherë qëllim i vetvetes, që flet qartë se ka ardhur koha për të marrë përgjegjësi, ngase kjo krizë nuk amnistion askënd. Vetëm se një përgjegjësi kaq e gjerë nuk do të thotë se shoqëria jonë nuk i ka të identifikuar bartësit kryesorë të shkatërrimit në arsim dhe se ata nuk janë tashmë anonimë. Ata kanë adresë,

ata i njohim të gjithë; në radhë të parë janë ata që kanë marrë përgjegjësitë politike dhe institucionale për ta qeverisur vendin.

Për të dalë nga kjo gjendje, qeverinë në ardhje e pret një punë e vështirë: të shpallë gjendjen emergjencë kombëtare dhe të marrë masat përkatëse, fillimisht duke i mënjanuar nga strukturat vendimmarrëse të gjithë ata që janë identifikuar si bartës të proceseve negative dhe njëkohësisht duke krijuar mekanizma institucionalë për ta avancuar procesin arsimor. Është krejtësisht e qartë se ata që e kanë shkaktuar këtë krizë nuk mund ta luajnë edhe rolin e shpëtimtarëve.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në kuadër të përgjegjësisë të veta dhe në bashkëpunim me të gjithë subjektet relevante e me njohës të kësaj fushe, brenda një periudhe 6-mujore do të hartojë një dokument gjithëpërfshirës për gjendjen në arsim, duke propozuar edhe masat përkatëse. Akademia do të jetë në dispozicion, për t'u bërë pjesë e rrugëdaljes nga kjo emergjencë kombëtare.

Për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,

Akademik Mehmet Kraja, kryetar

KONCERT FESTIV NGA VEPRIMTARIA E KOMPOZITORIT RAUF DHOMI



Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Arteve, më 16 dhjetor 2019 organizoi koncert festiv nga veprimtaria e kompozitorit Rauf Dhomi.



Në atmosferë festive, në praninë e anëtarëve të Akademisë dhe mysafirëve të shumtë, për më shumë se një orë interpretë dhe instrumentistë të njohur nga Kosova dhe më gjerë dhuruan momente të këndshme.



TAKIM NDËRMJET ASHAK-UT DHE ASHSH-SË

Më 17 dhjetor 2019, kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës akademik Mehmet Kraja bashkë me anëtarët e Kryesisë së Akademisë priti në takim kryetarin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Skënder Gjinushi me bashkëpunëtorë.



Ky takim u zhvillua në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy akademive, të Kosovës dhe të Shqipërisë, që përfshin aktivitetet në fushën kërkimore-shkencore e artistike si dhe veprimtari të ndryshme shkencore, simpoziume, konferenca e të tjera.

Gjatë takimit përfaqësuesit e dy akademive folën për vazhdimin e punës në projektet dhe botimet e përbashkëta shkencore, promovimin e botimeve, pjesëmarrjen në aktivitete shkencore e artistike etj.

U PËRURUA BOTIMI "FIBRACIONET" I ANËTARIT KORRESPONDENT QAMIL HAXHIBEQIRI



Më 18 dhjetor në sallën e Akademisë, në prezencën e anëtarëve të Akademisë, profesorëve universitarë dhe të mysafirëve të shumtë, është bërë përrurimi i librit të anëtarit korrespondent Qamil Haxhibeqiri me titull "Fibracionet". Fjalën e hapjes e mbajti sekretari i Seksionit, anëtar i korrespondent Fetah Podvorica, ndërsa për librin foli profesor dr. Minir Efendia. Në fund të pranishmit i përshëndeti edhe vetë autori, i cili e falënderoi Seksioni e SHN-së dhe Akademinë për mbështetjen dhe njëkohësisht falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në këtë përrurim.

**VJETARI
2019**

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Shfqet Riza

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 8.5 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup

